

**Republika e Shqipërisë
Ministria e Mjedisit**

**Projekti Mbështetje për Minimizimin
e Mbetjeve dhe Promovimin e 3R-ve
në**

Republikën e Shqipërisë

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

Maj 2017

Agjencia Japoneze për Bashkëpunim

Ndërkombëtar

(JICA)

Kokusai Kogyo Co., Ltd. / Ex Research Institute Ltd.

GE
JR
17-061

Përmbajtja

Harta e vendndodhjes
Shkurtime

1	Përmbledhje e projektit	1
1.1	Sfondi i projektit	1
1.2	Kuadri i projektit.....	1
1.3	Zonat e Projektit Pilot	2
1.4	Organizatat e përfshira në projekt.....	2
1.5	Mbetjet e synuara nga projekti.....	2
1.6	Klasifikimi i zonave të qeverive vendore	3
2	Gjendja e arritjeve të qëllimit dhe rezultateve të projektit.....	4
2.1	Tranzicioni i MHP dhe PO.....	4
2.2	Gjendja e arritjeve për rezultatet e pritshme	5
2.2.1	Rezultati 1	5
2.2.2	Rezultati 2	5
2.2.3	Rezultati 3	6
2.2.4	Rezultati 4	6
2.2.5	Rezultati 5	7
2.2.6	Rezultati 6	7
2.2.7	Qëllimi i Projektit.....	8
3	Aktivitetet e zbatuara.....	9
3.1	Regjistrime të aktiviteteve të zbatuara	9
3.2	Arritjet e çdo aktiviteti	11
3.2.1	Aktivitete të përbashkëta.....	11
3.2.2	Aktivitete lidhur me Rezultatin 1	12
3.2.3	Aktivitete lidhur me Rezultatin 2	13
3.2.4	Aktivitete lidhur me Rezultatin 3.....	14
3.2.5	Aktivitete lidhur me Rezultatin 4.....	16
3.2.6	Aktivitete lidhur me Rezultatin 5.....	19
3.2.7	Aktivitete lidhur me Rezultatin 6.....	22
4	Kontributet	26
4.1	Kontributet nga Pala Japoneze	26
4.1.1	Dërgimi i ekspertëve	26

4.1.2	Blerja e bërë e pajisjeve	27
4.2	Kontribute nga pala Shqiptare.....	28
4.2.1	Pajisje dhe zyrë për Projektin.....	28
4.2.2	Burimet njerëzore.....	28
5	Faktorët e jashtëm	30
5.1	Zgjedhja e komunës së mesme për projekt pilot.....	30
5.1.1	Objektivat e vëzhgimit	30
5.1.2	Përzgjedhja e NjQV së synuar	30
5.2	Reforma territoriale dhe zgjedhjet e qeverive vendore	37
6	Kundërmasa për sugjerimet që janë dhënë në vlerësimin përfundimtar	41
7	Rekomandim për arritjen e qëllimit të përgjithshëm	44

Lista e Tabelave

Tabela 1: Tranzicioni i MHP dhe PO.....	4
Tabela 2: Procesverbalet e KPK.....	11
Tabela 3: Lista e trajnimeve të kryera në Japoni.....	12
Tabela 4: Seminaret dhe workshop-et e kryera.....	22
Tabela 5: Hedhja në qarkullim e buletinit.....	23
Tabela 6: Workshop-et e kryera.....	24
Tabela 7: Data e vizitave individuale.....	24
Tabela 8: Lista e anëtarëve të EEJ.....	26
Tabela 9: Programi i Misionit të EEJ.....	26
Tabela 10: Pajisjet e blera në Japoni.....	27
Tabela 11: Pajisjet e blera në Shqipëri.....	27
Tabela 12: Lista e pajisjeve nga pala Shqiptare.....	28
Tabela 13: Lista e Homologëve Shqiptarë.....	28
Tabela 14: Lista e qeverive vendore të synuara.....	32
Tabela 15: Programi i Vëzhgimit në Terren.....	32
Tabela 16: Përmbledhje e Vëzhgimit në Terren për Bashkitë e Mesme dhe Përparësitë e Përzgjedhjes.....	33
Tabela 17: Ndryshimet në bashkitë e PP.....	37
Tabela 18: Pasojat e zgjedhjeve në bashkitë e PP.....	37

Lista e Figurave

Figura 1: Kufijtë e ri të bashkive dhe njësive të tyre administrative pas Reformës Territoriale	39
Figura 2: Kufijtë e qarqeve që përfshijnë bashkitë e reja pas Reformës Territoriale.....	40



Projekti Mbështetje për Minimizimin e Mbetjeve dhe Promovimin e 3R-ve në Republikën e Shqipërisë

Harta e vendndodhjes

Shkurtime

Shkurtime	Shkurtime në shqip	Japonisht	Anglisht	Shqip
AU	Nj.A	行政区	Adiministrative Unit	Njësi Administrative
C/P	Homolog	カウンターパート	Counterpart	Homolog
CA	VK	キャパシティ・アセスメント	Capacity Assessment	Vlerësimi i kapaciteteve
CG	QQ	中央政府	Central Government	Qeveria Qendrore
DF/R	DR/P	最終報告書（案）	Draft Final Report	Draft Raporti Përfundimtar
DG	DIP	局長	Director General	Drejtor i Përgjithshëm
dldp	PZHLD	地方分権と地域開発プログラム	decentralization and local development program	Programi per Zhvillimin Lokal dhe Decentralizimin
F/R	R/P	最終報告書	Final Report	Raporti Përfundimtar
GDP	PBB	国内総生産	Gross Domestic Products	Produktit të Brendshëm Bruto
IMF	FMN	世界通貨基金	International Monetary Fund	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT	INSTAT	アルバニア統計局	Albanian Institute of Statistics	Instituti i Statistikave të Shqipërisë
JCC	KPK	合同調整委員会	Joint Coordinating Committee	Komiteti i Përbashkët Koordinues
JET	EEJ	日本人専門家チーム	Japanese expert team	Ekipi i Ekspertëve Japonez
JICA	JICA	国際協力機構	Japan International Cooperation Agency	Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
LGU(s)	NJQV	地方自治体	Local Government Unit(s)	Njësia e Qeverisjes Vendore
MM	PM	人月	Man-month	Punë-Mujore
MOE	MM	環境省	Ministry of Environment	Ministria e Mjedisit
MTI	MTI	運輸・建設省	Ministry of Transport and Infrastructure	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MoUD	MZHU	都市開発省	Ministry of Urban Development	Ministria e Zhvillimit Urban
NEA	ARM	国家環境局	National Environmental Agency	Agjenci Rajonale Mjedisore
NGO(s)	OJQ	非政府組織	Non-Governmental Organization(s)	Organizata jo qeveritare
NSSWM	SKMMN	全国自治体廃棄物管理状況調査	National Survey on Solid Waste Management by LGUs	Studimi Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta për NJQV

Shkurtime	Shkurtime në shqip	Japonisht	Anglisht	Shqip
PP	PP	パイロットプロジェクト	Pilot Project	Projekt Pilot
P/R	R/P	進捗報告書	Progress Report	Raporti i Progresit
PDM	MHP	プロジェクト・デザイン・マトリックス	Project Design Matrix	Matrica e Hartimit të Projektit
PO	PO	業務工程	Plan of Operation	Plani i Operimit
POS	VOP	住民意識調査	Public Opinion Survey	Vëzhgim i Opinionit Publik
SDC	SDC	スイス開発協力省	Swiss Agency for Development and Cooperation	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SWM	MMN	固形廃棄物管理	Solid Waste Management	Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta
T&M Survey	Studimi i K&L	タイム & モーション調査	Time and Motion Survey	Studimi i Kohës dhe Lëvizjes
WP	GMR	ウエストピッカー	Waste Picker	Grumbullues të Materialit të Riciklueshëm
W/P	PP	業務計画書	Work Plan	Plani i Punës
WACS	VSPM	ごみ量・ごみ質調査	Waste Amount and Composition Survey	Vëzhgim i Sasisë dhe Përbërjes së Mbetjeve
WAS	VSM	ごみ量調査	Waste Amount Survey	Vëzhgim i Sasisë së Mbetjeve
WB	BB	世界銀行	World Bank	Banka Botërore
WCS	VPM	ごみ質調査	Waste Composition Survey	Vëzhgim i Përbërjes së Mbetjeve

1 Përmbledhje e projektit

1.1 Sfondi i projektit

Republika e Shqipërisë (në vazhdim “Shqipëria”), nga transferimi në republikë nga një vend komunist në vitin 1991, ka promovuar në mënyrë proaktive shkëmbimet ekonomike dhe burimet njerëzore me vendet fqinje, investimet e huaja dhe zhvillimin e industrive vendase dhe infrastrukturave duke përfshirë rrjetet rrugore, shpërndarjen e energjisë elektrike, sistemet e ujit dhe kanalizimit, duke synuar stabilitetin shoqëror, prosperitetin dhe përmirësimin e jetës së njerëzve. Në vitet e fundit, ka pasur një rritje të shpejtë të popullsisë urbane dhe sasisë së mbetjeve të zbrazura, dhe menaxhimi i mbetjeve të ngurta është përgjegjësi e qeverive vendore në Shqipëri.

Në të njëjtën kohë, Shqipëria ka vendosur si synim të bëhet shtet anëtar i Bashkimit Europian (BE) dhe politikat e saj mjedisore janë vendosur në përputhje me Direktivat e BE-së. Po ashtu në menaxhimin e mbetjeve të ngurta (MMN), Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve në Shqipëri (në vazhdim “Strategjia”) përcakton qëllimin për të zvogëluar sasinë e mbetjeve të depozituara brenda vendit me 25% në 2014, 35% në 2016, dhe pastaj 55% në 2020¹.

Trajtimi i mbetjeve (transportimi, depozitimi përfundimtar i mbetjeve) është zbatuar nga pushtetet vendore (komunat dhe bashkitë)² si pjesë e shërbimeve publike dhe kryhet nga korporatat publike dhe kompanitë private të kontraktuara. Megjithatë, momentalisht, ndarja e mbetjeve nuk zbatohet. Sipas praktikave të tanishme, do të jetë e vështirë të arrihet shuma dhe norma e reduktimit të mbetjeve, që synon qëllimin e përcaktuar.

Me qëllim arritjen e synimit të vendosur në Strategji, kërkohet urgjentisht që të zbatohet reduktimi i mbetjeve nëpërmjet menaxhimit të mbetjeve, i cili integron 3R, që do të thotë Reduktim, Ripërdorim dhe Riciklim, në burimet e prodhimit në nivel lokal. Prandaj, u bë një kërkesë për asistencë teknike nga Qeveria Shqiptare për Qeverinë Japoneze për të zhvilluar kapacitetin e qeverisë në zhvillimin dhe zbatimin e politikave për menaxhimin e mbetjeve me qëllimin e kryerjes së MMN në përputhje me Strategjinë, dhe R/D për Projektin u firmosën nga të dyja palët në 31 Janar, 2014.

1.2 Kuadri i projektit

(1) Qëllimi i përgjithshëm

Është futur korniza 3R në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta (MMN) në qeveritë vendore në Shqipëri për pakësimin e mbetjeve si një përpjekje mbarëkombëtare

(2) Qëllimet e projektit

Është forcuar kapaciteti MM në aspektin e zhvillimit të politikave 3R, si dhe ofrimi i mbështetjes për qeveritë vendore me qëllim zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planin e Veprimit në Shqipëri.

(3) Rezultatet

Rezultati 1: Gjendja e MMN dhe sfidat për të prezantuar 3R në MMN në çdo qeveri

¹ Në lidhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve i ligjëruara në vitin 2015. Momentalisht kjo “Strategji” është në shqyrtim për rishikimin nga MM për vitin 2017.

² Pas Reformës Territoriale të zbatuar në vitin 2014, komuna është shfuqizuar dhe është integruar në bashki (Shiko 5-2 për detaje).

vendore janë të identifikuara nga MM

- Rezultati 2: Është finalizuar një draft Udhërrëfyes për prezantimin e 3R në planin rajonal të MMN (Udhërrëfyesi 3R).
- Rezultati 3: Është kryer projekti pilot i praktikave 3R në MMN në qeveri vendore në shkallë të vogël (Bashkia Vau i Dejës³) dhe janë identifikuar sfidat e saj.
- Rezultati 4: Është kryer projekti pilot i praktikave 3R në MMN në qeveri vendore në shkallë të mesme (Bashkia Cërrik) dhe janë identifikuar sfidat e saj.
- Rezultati 5: Është kryer projekti pilot i praktikave 3R në MMN në qeveri vendore në shkallë të madhe (Bashkia Tiranë) dhe janë identifikuar sfidat e saj.
- Rezultati 6: Është forcuar ndihmesa dhe bashkëpunimi i MM për qeveritë vendore mbi praktikën 3R në MMN.

1.3 Zonat e Projektit Pilot

Bashkia Tiranë, Bashkia Cërrik, Bashkia Vau i Dejës

1.4 Organizatat e përfshira në projekt

- Ministria e Mjedisit / MM

Institucioni kryesor i përfshirë me politikën dhe menaxhimin e mbetjeve. Përgjegjësitë kryesore përfshijnë: formulimin e strategjisë, hartimin e legjislacionit, dhe vendosjen e rregullave për monitorimin. Agjensia Mjedisore Kombëtare (AMK) është pjesë e MM, e specializuar në monitorimin dhe mbrojtjen mjedisore. AMK ka dymbëdhjetë Agjensi Mjedisore Rajonale (AMR) që punojnë në nivel rajoni.

- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës / MTI

Përgjegjësitë kryesore përfshijnë: përgatitjen dhe zbatimin e politikave qeveritare për zhvillimin e infrastrukturës së mbetjeve, sigurimin e fondeve për zhvillimin e infrastrukturës, drejtimin, menaxhimin, mbikëqyrjen dhe vendosjen e standardeve teknike për infrastrukturën, përcaktimin e standardeve teknike për infrastrukturën, dhe koordinimin e punës me ministrinë e tjera dhe financimet ndërkombëtare.

- Ministria e Zhvillimit Urban / MZHU

Përgjegjësitë kryesore përfshijnë fazën e planifikimit të venddepozitimit rajonal të mbetjeve.

<NjQV-të e synuara për Projektet Pilot >

- Bashkia Tiranë
- Bashkia Cërrik
- Bashkia Vau i Dejës

1.5 Mbetjet e synuara nga projekti

“Mbetje” në këtë Projekt nënkupton mbetjet bashkiake.

³ Komuna Bushat është integruar në Bashkinë Vau i Dejës me reformën territoriale në 2016.

1.6 Klasifikimi i zonave të qeverive vendore

Në Shqipëri, 373 qeveri vendore u integruan në 61 qeveri vendore për përmirësimin e efikasitetit të qeverisë vendore nën reformën territoriale e cila u bë efektive në Shtator 2016. Para kësaj, zgjedhjet për kryetarët e bashkive dhe anëtarët e këshillit vendor bashkiak u zhvilluan në Qershor 2016. Si rezultat i reformës, NjQV-të e reja kanë ardhur për të qeverisur një rajon relativisht të madh duke përfshirë disa ish-NjQV fqinje si NjA të saj dhe NjQV-të e reja tani quhen të gjitha “Bashki,” ndërkohë përpara reformës, NjQV-të quheshin ose Bashki ose Komunë, në varësi të madhësisë së tyre.

Projekti filloi përpara Reformës Territoriale dhe kishte një komunë si një nga NjQV-të e synuara për projektin e tij pilot. Pas Reformës, bashkia e re, e cila përfshin zonën që më parë klasifikohet si “komunë” si një nga Njësitë Administrative (NjA), u bë NjQV-ja e synuar. Në këtë raport, kur “bashkia” referohet në lidhje me aktivitetet e zbatuara pas Shtatorit 2016, nënkupton bashkinë e re.

2 Gjendja e arritjeve të qëllimit dhe rezultateve të projektit

2.1 Tranzicioni i MHP dhe PO

Që me miratimin e MHP (0) në KPK e 1^{te}, MHP dhe PO janë rishikuar ashtu siç edhe tregohet në tabelën më poshtë. Rishikimet kryesore bazohen në shpërndarjen e Udhërrëfyesit 3R dhe vlerat numerike të vlerave të hamendësuara të treguara tek indikatorët.

Tabela 1: Tranzicioni i MHP dhe PO

Rishikim	Përmbledhje e rishikimeve	Referenca
0	Miratimi i planit të punës	Minutat e Takimit (në vazhdim M/M) për KPK 1 (17 Korrik 2014)
1	- Ndryshimi i zonës së synuar të projektit pilot (Bashkia Lezhë në Bashkinë Cërrik: për shkak të mbivendosjes me donatorë të tjerë) - Ndryshimi i zonës së synuar të projektit pilot (Komuna Bushat në Bashkinë Vau i Dejës: për shkak të reformës territoriale) - Dixhitalizimi i vlerave të hamendësuara të treguesve të synuar të projektit - Dixhitalizimi i vlerave të hamendësuara të Rezultatit 1 - Ndryshimi i termit “Udhërrëfyesi 3R” në “Draft Udhërrëfyesi 3R” “Është përfunduar raporti i Analizës” që është tregues për rezultatet 3, 4, 5 e janë ndryshuar në “Bazuar në rezultatet e vëzhgimit të MMN dhe analizës së problemeve të kryer për ish NjQV-të përpara reformës territoriale dhe NjQV-ve të tanishme, është hartuar draft Plan Veprimi 3R” dhe “janë zbatuar Projektet Pilot bazuar në draft Plan Veprimin 3R”. Gjithashtu, për arsyet e mësipërme janë ndryshuar mjetet e verifikimit. - Dixhitalizimi i vlerave të hamendësuara të Rezultatit 6	M/M për KPK 2 (27Janar 2016)
2	“Plan veprimi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta nëpërmjet 3R (Plani 3R) është hartuar për XX% të gjithë qeverive vendore të gjithë vendit” te treguesit e qëllimeve të përgjithshme u ndryshua në “Një pjesë e aktiviteteve 3R të përcaktuara në Plan Veprimin 3R u zbatuan në 20% të gjithë qeverive vendore deri në 2020” “Plani 3R u zbatua në yy% të gjithë qeverive vendore” të treguesve të qëllimeve të përgjithshme u ndryshua në “Një pjesë e aktiviteteve 3R të përcaktuara në Plan Veprimin 3R do zbatohen në 20% të gjithë qeverive vendore deri në 2020. “Sasia e mbetjeve të ngurta për person (ose familje) në fazën e depozitimit përfundimtar	M/M për KPK 4 (15 Shtator 2016)

Rishikim	Përmbledhje e rishikimeve	Referenca
	është pakësuar me 22% nga sasia në fillim të projektit (2014), në qeveritë vendore që punojnë me Planin 3R” te treguesit e qëllimeve të përgjithshme u ndryshua me “Sasia e mbetjeve të ngurta bashkiake për person (ose familje) në fazën e depozitimit përfundimtar u pakësua me 25% nga sasia në fillimin e projektit (2014), në qeveritë vendore që punojnë me Plan Veprimi 3R”. • “Workshop-e në mbështetje të NjQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R u zhvilluan në 7 qarqe” u shtua te treguesit e Rezultatit 6. • “6-5 MeM, në bashkëpunim me EEJ, zbaton workshop-e në mbështetje të NjQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo Qark. NjQV-të e synuara mendohen 40 në 8 Qarqe” dhe “6-6 MeM, në bashkëpunim me EEJ, instruktin në vend NjQV-të për hartimin e Planit të tyre të Veprimit 3R. NjQV-të e synuara mendohen 40 në 7 Qarqe” u shtuan tek aktivitetet që lidhen me Rezultatin 6.	

2.2 Gjendja e arritjeve për rezultatet e pritshme

2.2.1 Rezultati 1

Rezultati 1	Statusi i MMN dhe sfidat për të prezantuar 3R në MMN në secilën qeveri vendore janë identifikuar nga MM.	Arritur
Treguesit	• Raport i analizës mbi gjendjen aktuale të menaxhimit të mbeturinave dhe sfidat e prezantimit të 3R në MMN në qeveritë lokale. • Është mbajtur një seminar që synonte NjQV-të. • Është mbajtur një seminar mbi Raportin e Vëzhgimit.	Arritur Arritur Arritur

Gjendja e arritjes:

Konsiderohet që “Rezultati 1” është arritur bazuar në gjendjen e mëposhtme.

- “Vëzhgimi Kombëtar mbi Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta nga NjQV-të” u krye nga Shtatori 2014 në Nëntor 2014. U grumbulluan të dhëna që kanë të bëjnë me MMN në NjQV, nga 373 NjQV në 12 Qarqe.
- Rezultatet e Vëzhgimit u prezantuan në “Seminari mbi Vëzhgimin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta nga NjQV-të” që u mbajt në 26 Shkurt 2015, me 62 pjesëmarrës nga 42 organizma.

2.2.2 Rezultati 2

Rezultati 2	Është përfunduar një draft Udhërrëfyes për prezantimin e 3R-ve në planin rajonal të MMN (Udhërrëfyesi 3R).	Arritur
Treguesit	• Mbahet Workshop mbi Udhërrëfyesin 3R me pjesëmarrës nga qeveria qendrore dhe ajo vendore. • Mbahet një Seminar për vlerësimin afatmesëm të projektit pilot e shpjegimin e Draft Udhërrëfyesit 3R. • Draft Udhërrëfyesi 3R është përfunduar.	Arritur Arritur Arritur

Gjendja e arritjes:

Konsiderohet që “Rezultati 2” është arritur bazuar në gjendjen e mëposhtme

- 43 persona nga 6 Qarqe dhe 43 NjQV morën pjesë në “Seminar mbi shpjegimin e draft Udhërrëfyesit 3R” që u mbajt në 26 Shkurt 2015
- 40 persona nga 4 Qarqe dhe 26 NjQV morën pjesë në “Seminar mbi shpjegimin e 2^{të} të draft Udhërrëfyesit dhe raportimin e ndërmjetëm të projektit pilot” që u mbajt në 26 Mars 2017.
- Udhërrëfyesi përmban të dhëna të prodhuara nga vëzhgime të ndryshme përfshirë vëzhgimin e përbërjes dhe sasisë së mbetjeve (VPSM), vëzhgimi i opinionit publik (VOP), vëzhgimi i riciklimit dhe analizimi i të dhënave të peshores së mjeteve në venddepozitim, që, si këmbim, mundësoi zhvillimin e rrymës së mbetjeve në nivel bashkiak. Ky grup të dhënash i shtoi vlera domethënëse Udhërrëfyesit 3R.
- 87 persona nga institucionet qendrore dhe bashkitë morën pjesë në “Seminar mbi prezantimin e Udhërrëfyesit 3R dhe shpjegimi i rezultateve të projektit pilot” që u mbajt në 9, 10 Mars 2017.
- Udhërrëfyesi 3R u përfundua dhe publikua si dokument teknik i MM.
- Udhërrëfyesi 3R ju shpërnda 61 bashkive dhe 12 qarqeve në Prill 2017.

2.2.3 Rezultati 3

Rezultati 3	Projekti Pilot i praktikave të 3R në MMN realizohet në qeveritë vendore në shkallë të vogël (Bashkia Vau Dejës) dhe sfidat e tij identifikohen	Arritur
Treguesit	• Bazuar në rezultatet e vëzhgimit të MMN dhe analizës së kryer të problemeve për ish NjQV (Bashkia Bushat) përpara reformës territoriale, është hartuar draft Plani i Veprimit 3R.	Arritur
	• Është hartuar Draft Plan Veprimi 3R për NjQV-në e tanishme (Bashkia Vau i Dejës pas reformës territoriale).	Arritur
	• Janë zbatuar Projektet Pilot bazuar në draft Planin e Veprimit 3R.	Arritur

Gjendja e arritjes:

Konsiderohet që “Rezultati 3” është arritur bazuar në gjendjen e mëposhtme

- Draft Plan Veprimi 3R për Komunën Bushat u përgatit në Janar 2015 bazuar në vëzhgimet në terren dhe analizimi i problemeve.
- Draft Plan Veprimi 3R për Bashkinë Vau i Dejës u përgatit në Mars 2017.
- Projekti Pilot që u planifikua bazuar në draft Plan Veprimin 3R u zbatua nga Shtatori 2015 në Dhjetor 2016.
- Projekti pilot i kryer në Bashkinë Vaut i Dejës ku u hulumtuan zgjidhje për pakësimin e mbetjeve bujqësore / të gjelbra. Projekti pilot identifikoi sfidat e prezantimit të kompostimit në vend dhe jashtë oborrit për të pakësuar mbetjet bujqësore / të gjelbra dhe ofroi mundësi për një mjedis të pastër dhe mbledhjen efikase të mbetjeve në zonat rurale.

2.2.4 Rezultati 4

Rezultati 4	Projekti Pilot i praktikave 3R në MMN realizohet në qeveritë vendore të mesme (Bashkia Cërrik) dhe identifikohen sfidat e tij identifikohen.	Arritur
-------------	--	---------

Treguesit	• Bazuar në rezultatet e vëzhgimit të MMN dhe analizës së kryer të problemeve për ish NjQV-në (Bashkia Cërrik) përpara reformës territoriale, është hartuar draft Plani i Veprimit 3R.	Arritur
	• Është hartuar Draft Plan Veprimi 3R për NjQV-në e tanishme (Bashkia Cërrik pas reformës territoriale).	Arritur
	• Janë zbatuar Projektet Pilot bazuar në draft Planin e Veprimit 3R.	Arritur

Gjendja e arritjes:

Konsiderohet që “Rezultati 4” është arritur bazuar në gjendjen e mëposhtme

- Draft Plan Veprimi 3R për ish Bashkinë Cërrik u përgatit në Janar 2015 bazuar në vëzhgimet në terren dhe analizimin e problemeve.
- Draft Plan Veprimi 3R për Bashkinë Cërrik u përgatit në Dhjetor 2016.
- Projekti Pilot u planifikua bazuar në draft Plan Veprimin 3R dhe zbatua nga Shtatori 2015 në Dhjetor 2016.
- Projekti pilot identifikoi sfidat e bërjes së riciklimit ekonomikisht të zbatueshëm dhe ofroi mundësinë e kuptimit të efikasitetit të shërbimit të grumbullimit derë më derë që mundëson një mjedis të pastër.

2.2.5 Rezultati 5

Rezultati 5	Projekti pilot i praktikave 3R në MMN realizohet në qeveritë vendore në shkallë të madhe (Bashkia Tiranës) dhe sfidat e tij identifikohen.	Arritur
Treguesit	• Bazuar në rezultatet e vëzhgimit të MMN dhe analizës së kryer të problemeve për ish NjQV (Bashkia Tiranë) përpara reformës territoriale, është hartuar draft Plani i Veprimit 3R.	Arritur
	• Është hartuar Draft Plan Veprimi 3R për NjQV-në e tanishme (Bashkia Tiranë pas reformës territoriale).	Arritur
	• Janë zbatuar Projektet Pilot bazuar në draft Planin e Veprimit 3R.	Arritur

Gjendja e arritjes:

Konsiderohet që “Rezultati 5” është arritur bazuar në gjendjen e mëposhtme

- Draft Plan Veprimi 3R për ish Bashkinë Tiranë u përgatit në Janar 2015 bazuar në vëzhgimet në terren dhe analizimin e problemeve.
- Draft Plan Veprimi 3R për Bashkinë Tiranë u përgatit në Mars 2017.
- Projekti Pilot u planifikua bazuar në draft Plan Veprimin 3R dhe zbatua nga Shtatori 2015 në Dhjetor 2016.
- Projekti pilot tregoi se shkolla ka potencial të madh të rrisë ndërgjegjësimin e nxënësve dhe prindërve të tyre mbi çështjet e riciklimit.

2.2.6 Rezultati 6

Rezultati 6	Forcohet asistenca e MM dhe bashkëpunimi me qeveritë vendore në praktikat 3R në MMN.	Pothuajse Arritur
Treguesit	• Zhvillohen 5 herë takime lidhur me aktivitetet 3R në NjQV-të e synuara.	Arritur
	• 2 takime ndërmjet MM dhe kompanive të riciklimit do të organizohen gjatë aktiviteteve të projektit pilot	I pa arritur
	• Botohen 5 Buletine të Projekt	Arritur
	• Workshop-e në mbështetje të NjQV-ve për hartimin e Plan	Arritur

	Veprimi 3R u mbajtën në 7 qarqe	
--	---------------------------------	--

Gjendja e arritjes:

Konsiderohet që "Rezultati 6" është arritur bazuar në gjendjen e mëposhtme

- (1) Seminar mbi vëzhgimin kombëtar të menaxhimit të mbetjeve të ngurta nga NjQV-të (26 Shkurt 2015)
- (2) Seminar mbi shpjegimin e rrymës së mbetjeve të NjQV-ve (26 Shkurt 2015)
- (3) Seminar mbi shpjegimin e draft Udhërrëfyesit 3R (12 Maj 2015)
- (4) Seminar mbi shpjegimin e 2^{të} të draft Udhërrëfyesit 3R dhe raportimi i ndërmjetëm i projekteve pilot (23 Mars 2016)
- (5) Seminar mbi prezantimin e Udhërrëfyesit 3R dhe shpjegimi i rezultateve të projekteve pilot (9, 10 Mars 2017)
- Pas fillimit të diskutimeve në Shtator të vitit 2016 në lidhje me rifillimin e "importit të burimeve të mbetjeve", industrinë e riciklimit dhe Ministria e Mjedisit kanë qenë në negociata dhe në një marrëdhënie shumë delikate. Nuk pati një takim, sepse marrëdhëniet mes tyre nuk është përmirësuar
- U publikuan 5 Buletine.
- Workshop-e mbështetës për hartimin e Plan Veprimit 3R për bashkitë u mbajtën nga Shtator 2016 në Dhjetor 2016.

2.2.7 Qëllimi i Projektit

Qëllimi i Projektit	Kapaciteti i Ministrisë së Mjedisit (MM) forcohet në aspektin e zhvillimeve të politikave 3R dhe sigurimin e mbështetjes për qeveritë vendore me qëllim zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planin e Veprimit në Shqipëri.	Arritur
Indikatorët	• Workshop për prezantimin e draftit të përfunduar të Udhërrëfyesit 3R NjQV-ve kryhet nga MM. • Nëpërmjet workshop-it të sipërpërmendur, më shumë se 25 NjQV do të zhvillojnë një draft paraprak Plan Veprimi 3R për NjQV-në e tyre.	Arritur

Gjendja e arritjes:

Konsiderohet që "Propozimi i Projektit" është arritur bazuar në gjendjen e mëposhtme

- Seminari mbi prezantimin e Udhërrëfyesit 3R dhe shpjegimet e projektit pilot u organizua nga MeM dhe u mbajt më datat 9, 10 Mars 2017. Morën pjesë 87 vetë nga qeveria qendrore dhe rajonale si dhe bashkitë.
- U përgatitën Plane Veprimi për 26 bashki.

Në kohën e fillimit të projektit, në stafin e MM, ndjenja e "hierarkisë së komandës" ishte e fortë dhe ata mendonin se ishte detyrë e një bashkie të ndiqte dhe të zbatonte ligjet relevante të legjislacionit dhe strategjinë kombëtare dhe masat e saj duhet të merren parasysh vetë nga qeveria vendore. Megjithatë, ata kanë arritur të njohin nevojat për udhëzimin e MM për qeveritë vendore duke parë drejtpërdrejt aftësitë individuale të qeverive vendore dhe problemet me të cilat ballafaqohen përmes projektit, dhe kjo mund të konsiderohet si një përmirësim i madh i kapaciteteve. Ndërkohë, burimet njerëzore të MM janë aq të kufizuara sa që aktualisht nuk është realiste të mendohet që stafi i MM do të ofrojë udhëzime për të gjitha qeveritë vendore. Në rrethana të tilla, MM deklaroi në KPK përfundimtare që stafi i MM vazhdon të zbatojë workshop-et për mbështetjen e formulimit të Plan Veprimit 3R që mund të zbatohet me stafin e kufizuar të MM, dhe faktin që stafi i MM pranon tani që ata janë në krye të politikave mjedisore, dhe është përgjegjësia e tyre për të udhëzuar bashkitë, mund të konsiderohen si një tregues i aftësive të tyre mbështetëse të përmirësuar.

Plan of Operation (Rev.3)																																									
Year	2014												2015												2016												2017				
Month	6	7	8	9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	1	2	3	4	5					
Working month	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36					
Output 4: Pilot project of 3R waste management carried out in medium scale local government (Gerrik Municipality) and its challenges are identified.																																									
4.1 Survey	Plan																																								
Actual																																									
4.2 3R Action Plan for former LGU	Plan																																								
Actual																																									
4.3 3R Action Plan for new LGU	Plan																																								
Actual																																									
4.4 Planning	Plan																																								
Actual																																									
4.5 Implementation and Monitoring	Plan																																								
Actual																																									
4.6 Evaluation	Plan																																								
Actual																																									
4.7 Analysis Report	Plan																																								
Actual																																									
4.8 Seminar	Plan																																								
Actual																																									
4.9 Feedback to 3R Guideline	Plan																																								
Actual																																									
Output 5: Pilot project of 3R waste management carried out in large scale local government (Tirane Municipality) and its challenges are identified.																																									
5.1 Survey	Plan																																								
Actual																																									
5.2 3R Action Plan for former LGU	Plan																																								
Actual																																									
5.3 3R Action Plan for new LGU	Plan																																								
Actual																																									
5.4 Planning	Plan																																								
Actual																																									
5.5 Implementation and Monitoring	Plan																																								
Actual																																									
5.6 Evaluation	Plan																																								
Actual																																									
5.7 Analysis Report	Plan																																								
Actual																																									
5.8 Seminar	Plan																																								
Actual																																									
5.9 Feedback to 3R Guideline	Plan																																								
Actual																																									
Output 6: MOE's assistance and cooperation to local government is strengthened in 3R solid waste management																																									
6.1 Formulation of Principle	Plan																																								
Actual																																									
6.2 3R Conferences	Plan																																								
Actual																																									
6.3 Deepening exchanges with recyclers	Plan																																								
Actual																																									
6.4 Disseminations	Plan																																								
Actual																																									
6.5 WS to support 3R Action Plan formulation	Plan																																								
Actual																																									
6.6 LGU visits to support 3R Action Plan formulation	Plan																																								
Actual																																									
6.7 technical transfer for formulating 3R Action Plan	Plan																																								
Actual																																									
Project management																																									
JCC	Plan																																								
Actual																																									
Project Report	Plan																																								
Actual																																									
Project Evaluation	Plan																																								
Actual																																									

<Symbol>
SE: Seminar, RP: Report, WS: Workshop, MT: Meeting, NL: Newsletter, ICR: Project Inception Report, PR: Progress Report, Mid: Mid-term Project Review, Terminal: Project Terminal Evaluation
Local election had been held at June 2015

3.2 Arritjet e çdo aktiviteti

3.2.1 Aktivitete të përbashkëta

Aktiviteti 0.1 Të përgatisë planin e punës dhe të mbajë një mbledhje këshilli

Plani i punës u përgatit nga EEJ dhe u miratua në mbledhjen e 1^{te} të Komitetit të Përbashkët Koordinativ (në vazhdim KPK).

Aktiviteti 0.2 Të mbajë mbledhjen e Komitetit të Përbashkët Koordinues (JCC)

KPK është mbajtur pothuajse një herë në 6 muaj. Çështjet kryesore mbi të cilat është rënë dakord tregohen në tabelën më poshtë. Për të parë çdo Minutë Takimi (në vazhdim M/M) të KPK, referohu në “Shtojca 7.1 Minutat e Takimit të KPK”.

Tabela 2: Procesverbalet e KPK

Koha	Vendi	Data	Çështjet kryesore të rëna dakord
1	MeM	17 Korrik 2014	Shpjegimi i planit të punës, miratimi i tij Miratimi i MHP (0) dhe PO(1)
2	MeM	27 Janar 2015	Shpjegimi i draft Udhërrëfyesit 3R Shpjegimi i projektit pilot Miratimi i MHP(1) dhe PO(2)
3	MeM	5 Prill 2016	Shpjegimi i rezultateve të rishikimit të ndërmjetëm dhe rekomandimeve
4	MeM	15 Shtator 2016	Miratimi i MHP (2) dhe PO(3)
5	MeM	26 Janar 2017	Shpjegimi i rezultateve të vlerësimit përfundimtar dhe rekomandimeve
6	MeM	25 Prill 2017	Shpjegimi i rezultateve të projektit Shpjegimi i draft raportit përfundimtar

Aktiviteti 0.3 Kryerja e vlerësimit të kapaciteteve: V/K

Ne bëmë Vlerësimin e parë të Kapaciteteve (VK) në Gusht 2014. Pas mbajtjes së aktiviteteve të ndryshme si seminare, ne planifikuam të zbatonim VK deri në fund të 2015, por shkalla e përfshirjes në seminare të Ministrisë së Mjedisit ishte e ulët, kështu që nuk mund ta zhvillonim këtë vlerësim.

Meqë zyrtarët e MM deklarojnë që ata janë zyrtarë administrativë, prandaj rishikimet dhe diskutimet i caktohen ekspertëve të jashtëm dhe stafi i Ministrisë së Mjedisit vepron si koordinator në to. Gjithsesi, në Seminarin e Shpjegimit të Udhërrëfyesit 3R të mbajtur në fund të projektit, Udhërrëfyesi 3R ju shpjegua qeverive vendore nga MM; duket se zyrtarët e MM e kuptuan përgjegjësinë e MM kundrejt bashkive dhe filluan të veprojnë vetë. Kjo konsiderohet të ketë përmirësuar aftësinë udhëzuese të zyrtarëve të MM ndaj bashkive.

Aktiviteti 0.4 Të përgatisë raportin e progresit dhe raportin përfundimtar

Raporti i Progresit Nr.1 dhe Nr. 2 u përgatitën përkatësisht në Shtator 2015 dhe Shtator 2016 dhe këto raporte u miratuan nga KPK. Draft Raporti Përfundimtar u përgatit në Prill 2017 dhe u kërkuar që të bëhen komente nga anëtarët e KPK. Raporti përfundimtar që përmban edhe komentet e anëtarëve KPK u dorëzua në Qershor 2017.

Aktiviteti 0.5 Trajnimi i homologëve në Japoni

Trajnimet në Japoni u kryen në Bashkinë Ogaki, prefektura Gifu. Seminaret kishin për qëllim kuptimin e rolit brenda organizmit të tyre, të mësojnë mbi menaxhimin japonez të mbetjeve të ngurta, aktivitetet e tanishme 3R dhe bazuar në këto të sjellin eksperiencën e marrë në Shqipëri. Trajnimet e kryera tregohen në tabelën më poshtë. Për detaje referohu në “Shtojca 7.2 Vizitë trajnimi”.

Tabela 3: Lista e trajnimeve të kryera në Japoni

	Datë	Pjesëmarrës	Përmbajtja e trajnimit
I pari	18 Maj~23 Maj 2015	MeM: 2 persona MTI: 1 person MZHU: 1 person	Leksione: 3 herë Vizita terreni: 9 vende
I dyti	18 Maj~28 Maj 2016	Bashkia Vau i Dejës: 2 persona Bashkia Cërrik: 2 persona	Leksione: 2 herë Vizita terreni: 14 vende
I treti	2 Prill~12 Prill 2017	Bashkia Ura Vajguore: 1 person Bashkia Përmet: 1 person Bashkia Konispol: 1 person	Leksione: 3 herë Vizita terreni: 12 vende

Aktiviteti 0.6 Hartimi i treguesve të MHP

U ndryshuan vlerat e hamendësuar të dhëna në MHP në vlera të synuara dhe u mor miratimi për rishikimin e MHP në KPK e 2^{të} dhe të 4^{të}.

3.2.2 Aktivitete lidhur me Rezultatit 1

Aktiviteti 1-1 MM mbledh dhe analizon informacionet ekzistuese për MMN në bashki në bashkëpunim me MTI dhe Ekipin e Ekspertëve Japonez (EEJ)

Vëzhgimi kombëtar mbi praktikatat e menaxhimit të mbetjeve të ngurta u krye mbi punën e bërë. U krye me metodën e P&P. P&P ju dërguan në fillim personave të ngarkuar në 373 NjQV-të, që kishin bashki dhe komuna në 12 Qarqe.

Aktiviteti 1-2 MM identifikon sfidat e prezantimit të 3R në MMN në qeveritë vendore në bashkëpunim me EEJ

Vetëm 6 nga 373 bashkitë dhe komunat kishin drejtori përkatëse. Zyrtarët në bashkitë dhe komunat e tjera shërbenin edhe si specialistë mjedisi dhe infrastrukture dhe shumë prej tyre nuk e kishin idenë e gjendjes së menaxhimit të mbetjeve në qeverinë vendore. Veçanërisht, mungonin zyrtarët vendorë që kishin dijeni mbi gjendjen financiare të menaxhimit të mbetjeve në bashkinë e tyre prandaj është urgjente për zyrtarët vendorë të kuptojnë gjendjen e menaxhimit të mbetjeve përfshirë atë financiare. Gjithashtu, kishte vetëm 5 qarqe që kishin sektorin e menaxhimit të mbetjeve në institucion, përgjegjës për çdo bashki, asnjë prej këtyre zyrtarëve nuk e njohte gjendjen e menaxhimit të mbetjeve në bashkitë përkatëse. Për më tepër, u vu re se që qarqet nuk kishin buxhet dhe si rrjedhim kishin vështirësi të zbatonin strategjinë e mbetjeve në rajonin e tyre. Detajet tregohen në “Shtojca 1 Aktivitetet lidhur me Rezultatit 1 Vëzhgimi kombëtar mbi praktikatat e menaxhimit të mbetjeve të ngurta”.

Aktiviteti 1.3 MM organizon një seminar në bashkëpunim me EEJ me qeveritë vendore për të kuptuar opinionin dhe interesat e tyre mbi MMN.

Sipas rezultateve të “Vëzhgimit kombëtar mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta në NjQV”, personi i ngarkuar me menaxhimin e mbetjeve nuk e njihte gjendjen mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta në NjQV-në e tij. Kjo gjendje çoi që nuk ka tema që do të ngrihen nga personat përgjegjës, për këtë arsye nuk u mbajt "Seminar në bashkëpunim me EEJ për qeveritë vendore për të kuptuar mendimet dhe interesat e tyre në MMN". Në "Seminarin Gjendja e Menaxhimit të Mbetjeve" siç tregohet në "Aktiviteti 1.5", rezultatet e anketës u ndanë me zyrtarët bashkiakë dhe ata qendrorë në "Seminar mbi Vëzhgimin Kombëtar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta nga NjQV-të".

Aktiviteti 1.4 MM përgatit një raport analizë për të përmbledhur statusin e MMN në pushtetin vendor dhe parimin e tyre për të prezantuar 3R në MMN, në bashkëpunim me EEJ.

Bazuar në “Vëzhgimin kombëtar mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta në NjQV”, zbatueshmëria e aktiviteteve të ndryshme 3R në Shqipëri dhe draft aktivitetet 3R, u përmbledh mundësia dhe pikat që duhen marrë parasysh në “Masat për promovimin e 3R-ve, mundësia e prezantimit të masave dhe pikat që duhen marrë parasysh kur prezantohen”

Aktiviteti 1.5 MM mban seminare për të prezantuar raportin e analizës për qeveritë vendore me përkrahje të EEJ.

“Seminari mbi Vëzhgimin kombëtar mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta nga NjQV-të” u mbajt bazuar në rezultatet e dala nga “Vëzhgimi kombëtar mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta nga NjQV-të” më 26 Shkurt 2015. Morën pjesë 8 vetë nga qeveria qendrore, 43 vetë nga NjQV-të dhe 5 vetë nga donatorët.

Aktiviteti 1.6 MM boton raportin e analizës dhe informacionet e rëndësishme mbi seminarat pjesëmarrëse nëpërmjet Internetit në bashkëpunim me MTI dhe EEJ.

Rezultatet e P&P të “Vëzhgimit kombëtar mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta nga NjQV-të” u ngarkuan në faqet e internetit të MM dhe MTI.

3.2.3 Aktivitete lidhur me Rezultatin 2

Aktiviteti 2-1 MM bashkëpunon dhe mbështet EEJ në formulimin e draft Udhërrëfyesit për prezantim të 3R në MMN qeverive vendore (Draft Udhërrëfyesi 3R) bazuar në rezultatet e seminareve pjesëmarrëse dhe raporteve në bashkëpunim me EEJ.

Udhërrëfyesi 3R u miratua nga MM në Prill 2017. Udhërrëfyesi 3R ju shpërnda personave të ngarkuar në 61 bashki dhe 12 qarqe dhe ju dorëzua zyrës qendrore të JICA si një dokument teknik.

Aktiviteti 2-2 MM mban seminar shpjegues për Draft Udhërrëfyesit 3R kompanive ricikluese dhe qeverive vendore në bashkëpunim me MTI dhe EEJ.

Qeveria e Shqipërisë, nga 2014, vendosi të ndalonte importin për “materialet e riciklueshme”. Disa nga anëtarët e shoqatës së ricikluesve u dëmtuan nga pamundësia e materialit bazë. Më pas, u lejua importi i disa metaleve. Bazuar në këtë gjendje, marrëdhënia ndërmjet MM dhe shoqatës së ricikluesve u bë e tensionuar nga fillimi i diskutimit për “Rishqyrtimin e importit për materialet e papërpunuara të riciklueshme”. Nuk ishte e mundur të bëheshin diskutime ndërmjet MM dhe shoqatës së ricikluesve, prej tensioneve deri në përfundim të projektit.

Aktiviteti 2-3 MM rishikon Draft Udhërrëfyesin 3R në bashkëpunim me EEJ, përmes informacionit mbi rezultatet e workshop-eve dhe seminareve të sipërpërmendura.

“Seminari mbi prezantimin e Udhërrëfyesit 3R dhe shpjegime të rezultateve të projekteve pilot” u mbajt me 87 persona nga qeveria qendrore, rajonale dhe bashkitë më 9 - 10 Mars 2017. U ngritën shumë pyetje nga bashkitë lidhur me Udhërrëfyesin 3R dhe menaxhimin e përgjithshëm të mbetjeve dhe MM ju përgjigj atyre drejt. Detajet tregohen në “Shtojca 6.2.4 Seminar mbi prezantimin e Udhërrëfyesit 3R dhe shpjegime të rezultateve të projekteve pilot”.

Aktiviteti 2-4 Mbahet Konferenca për përfundimin e draft Udhërrëfyesit 3R nga MM dhe EEJ.

EEJ i kërkoi komente MM mbi Draft Udhërrëfyesin 3R. Gjithsesi, nuk ka komente mbi të. MM vendosi që Udhërrëfyesi 3R do të dalë si dokument teknik i ministrisë prandaj ai do jetë Udhërrëfyesi 3R. Nuk ka më draft Udhërrëfyesi 3R. Për më tepër, Udhërrëfyesi 3R ju shpërnda gjithë qarqeve dhe bashkive më Prill 2017.

3.2.4 Aktivitete lidhur me Rezultatit 3

Aktiviteti 3-1 EEJ studion gjendjen e MMN në bashkëpunim me qeveritë vendore (Bashkia Vau i Dejës) në zonën e tyre të mbikëqyrjes/ administrative për të njohur (vlerësuar) sasinë e mbetjeve dhe përbërjen në burimin gjenerues, ripërdorimin, riciklimin dhe venddepozitimet përfundimtare, dhe ndërgjegjësimin social midis prodhuesve të mbetjeve.

Vëzhgimi bazë u krye nga Shtatori 2014 deri në Maj 2016. Vëzhgimi bazë përbëhet nga 1) vëzhgimi mbi sasinë dhe përbërjen e mbetjeve, 2) sasia e mbetjeve të hyra në landfill, 3) vëzhgimi i opinionit publik dhe 4) vëzhgimi i riciklimit. Rryma e tanishme e mbetjeve në zonat e synuara u bënë bazuar në rezultatet e vëzhgimeve më sipër.

Detajet tregohen në “Dokumentin teknik: Udhërrëfyesi 3R, 3 vëzhgime mbi sasinë dhe përbërjen e mbetjeve, 4 rryma e mbetjeve në zonat e synuara”.

Aktiviteti 3-2 MM dhe EEJ mbështesin NjQV-në e synuar të formulojë draft Plan Veprimi 3R bazuar në rezultatet e vëzhgimit të sipërpërmendur për ish-komunën Bushat.

Bazuar në rezultatet e vëzhgimit të MMN dhe analizimi i problemit të kryer në ish NjQV-në (Komuna Bushat) përpara reformës territoriale, draft Plan Veprimi 3R u hartua nga personi i ngarkuar për menaxhimin e mbetjeve në komunën Bushat në Shtator 2015.

Aktiviteti 3-3 MM dhe EEJ mbështesin NjQV-në e synuar të formulojë draft Plan Veprimi 3R bazuar në rezultatet e vëzhgimit të sipërpërmendur për Bashkinë e re Vau i Dejës.

Draft Plan Veprimi 3R për NjQV-të e tanishme (Bashkia Vau i Dejës pas reformës territoriale) u hartua nga personi i ngarkuar me menaxhimin e mbetjeve në bashkinë Vau i Dejës. Në draft Plan Veprimin 3R synohet trajtimi i mbetjeve bujqësore. Detajet tregohen në “Dokumentin teknik: Udhërrëfyesi 3R, 7 Plan Veprimi 3R për Bashkinë Vau i Dejës”.

Aktiviteti 3-4EEJ dhe MM planifikojnë dhe projektojnë projektin projekt pilot në bashkëpunim me qeverinë vendore bazuar në draft Plan Veprimin 3R.

Projektet Pilot bazuar në draft Plan Veprimin 3R janë planifikuar që nga Qershori 2015 deri në fillim të Shtatorit 2015. Projekti Pilot përbëhet nga 1) Sigurimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve me kontejnerë të vegjël, 2) Përmirësimi i sistemit të grumbullimit me kontejnerë të mëdhenj dhe mënyra e zbrazjes nga qytetarët (me qëllimin shqyrtimi i mundësisë së ndarjes së mbetjeve bujqësore) dhe 3) Pakësimi i mbetjeve bujqësore në burimin e prodhimit (kompostimi brenda oborrit). Detajet tregohen në “Shtojca 3 Aktivitetet lidhur me Rezultatit 3”.

Aktiviteti 3-5EEJ dhe qeveritë vendore zbatojnë dhe mbikëqyrin projektin pilot në bashkëpunim me MM.

Projektet Pilot u zbatuan që 1) Të sigurojnë shërbimin e grumbullimit të mbetjeve me kontejnerë të vegjël nga Shtatori 2015, 2) Të përmirësojnë sistemin e grumbullimit me kontejnerë të mëdhenj dhe mënyrën e zbrazjes së qytetarëve (me qëllimin shqyrtimi i mundësisë së ndarjes së mbetjeve bujqësore) nga Shkurti 2016 dhe 3) Të pakësojë mbetjet bujqësore në burimin e prodhimit (Kompostimi brenda oborrit) nga Shtatori 2016 deri në Dhjetor 2016. Monitorimi i Projekteve Pilot u krye nga EEJ në fazën fillestare, e më pas ju transferua gradualisht personave të ngarkuar me menaxhimin e mbetjeve në bashkinë Vau i Dejës. Kur u pa e nevojshme, u bënë ndryshime të aktiviteteve të projektit pilot.

Aktiviteti 3-6EEJ dhe MM vlerësojnë dhe bëjnë analizë të projektit pilot në bashkëpunim me qeverinë vendore.

U bë raporti i ndërmjetëm në Shtator 2016 dhe raporti përfundimtar në Mars 2017 gjatë “Seminarit mbi prezantimin e Udhërrëfyesit 3R dhe shpjegimit të rezultateve të projektit pilot”. Rekomandimet për vazhdimësinë dhe zgjerimin e projektit pilot në Bashkinë Vau i Dejës tregohen në vazhdim.

Faza 1

- PP rriti në përgjithësi shërbimin e grumbullimit të mbetjeve ku kompaktori mbulon 300 kontejnerë të vegjël. Pas përfundimit të PP vazhdohet me këtë shërbim. Grumbullimi bëhet përgjithësisht një herë në javë për çdo kontejner.
- Gjithsesi PP shfaqti probleme lidhur me sistemin e grumbullimit me kompaktor pasi u vunë re sasi të mëdha mbetjesh (përgjithësisht mbetje organike) të zbrazura jashtë kontejnerëve.

Faza 2

- Më pas u vendosën kontejnerët e mëdhenj për mbetjet organike për të zgjidhur problemin. PP kishte edhe rolin të vëzhgonte cilësinë e mbetjeve dhe nivelin e bashkëpunimit të njerëzve me qëllim të ndihmës së pakësimit të mbetjeve si hapi tjetër.
- Rezultoi se vendi mbahej pastër dhe grumbullimi i mbetjeve ishte efikas. Edhe pse u zgjidh çështja e fazës 1, faza 2 shfaqti sfidën e radhës, nevojën për të pakësuar mbetjet që do të transportohen ku bashkia duhet të transportojë mbetje organike të zbrazura në sasi shumë të mëdha.

Faza 3

- Kompostimi jashtë oborrit nuk mundëson pakësimin e sasisë që duhet të

transportohet. Kjo është arsyeja pse kompostimi brenda oborrit i përshtatet bashkisë e cila përballlet me problemin e transportit të mbetjeve, pasi kompostimi brenda oborrit pakëson sasinë e mbetjeve që duhen transportuar.

- Për këtë arsye PP u përqendrua te kompostimi brenda oborrit. Nëpërmjet vëzhgimit të PP u panë disa metoda kompostimi mbi praktikën e mirë.
- PP dha mësimin që kompostimi përfundimisht duhet të zgjerohet për efikasitetin e transportit të mbetjeve dhe promovimin e 3R-ve. Bashkia dhe autoritetet qendrore nxiten të punojnë së bashku në këtë drejtim.

Detajet tregohen në “Shtojca 3, Aktivitetet lidhur me Rezultatin 3”.

Aktiviteti 3-7 EEJ dhe MM bëjnë raport analize të projektit pilot në bashkëpunim me qeverinë vendore.

Raporti i projektit pilot u bë në Mars 2017. Detajet e aktiviteteve tregohen në “Shtojca 3, Aktivitetet lidhur me Rezultatin 3”.

Aktiviteti 3-8 EEJ, MM dhe qeveria vendore bashkë-organizojnë seminare për të raportuar rezultatet e projektit pilot te banorët dhe palët e interesuara.

Aktivitetet e projektit pilot ju raportuan bashkive të tjera nga persona nga zona e synuar e projektit pilot në “Seminari mbi prezantimin e Udhërrëfyesit 3R dhe shpjegimi i rezultateve të projektit pilot” në Mars 2017. Detajet tregohen në “Shtojca: Aktivitetet lidhur me Rezultatin 3” dhe “Shtojca 6.2.4 Seminari mbi prezantimin e Udhërrëfyesit 3R dhe shpjegimi i rezultateve të projektit pilot”.

Aktiviteti 3-9 EEJ, MM dhe qeveria vendore aplikojnë mësimet e nxjerra nga projekti pilot në Udhërrëfyesin 3R.

Reagimet nga Udhërrëfyesi 3R nëpërmjet projektit pilot janë si më poshtë.

- Rezultoi se vendi mbahej pastër dhe grumbullimi i mbetjeve ishte efikas. Edhe pse u zgjidh çështja e fazës 1, faza 2 shfaqti sfidën e radhës, nevojën për të pakësuar mbetjet që do të transportohen ku bashkia duhet të transportojë mbetje organike të zbrazura në sasi shumë të mëdha.
- PP dha mësimin që kompostimi përfundimisht duhet të zgjerohet për efikasitetin e transportit të mbetjeve dhe promovimin e 3R-ve. Bashkia dhe autoritetet qendrore nxiten të punojnë së bashku në këtë drejtim.

Përmbajtja e projektit pilot u publikua në Udhërrëfyesin 3R si “Shembuj të aktiviteteve 3R bazuar në mësimet e nxjerra nga projekti pilot që u zbatuan në zonat e synuara”. Detajet tregohen në “Dokumentin teknik: Udhërrëfyesi 3R, 8 Shembuj të aktiviteteve”.

3.2.5 Aktivitete lidhur me Rezultatin 4

Aktiviteti 4-1 EEJ studion gjendjen e MMN në bashkëpunim me qeveritë vendore (Bashkia Cërrik) në zonën e tyre të mbikëqyrjes/administrative për të njohur (vlerësuar) sasinë e mbetjeve dhe përbërjen në burimin gjenerues, ripërdorimin, riciklimin dhe venddepozitetet përfundimtare, dhe ndërgjegjësimin social midis prodhuesve të mbetjeve.

Vëzhgimi bazë u krye nga Shtatori 2014 deri në Maj 2016. Vëzhgimi bazë përbëhet nga 1)

vëzhgimi mbi sasinë dhe përbërjen e mbetjeve, 2) sasia e mbetjeve të hyra në landfill, 3) vëzhgimi i opinionit publik dhe 4) vëzhgimi i riciklimit. Rryma e tanishme e mbetjeve në zonat e synuara u bënë bazuar në rezultatet e vëzhgimeve më sipër.

Detajet tregohen në “Dokumentin teknik: Udhërrëfyesi 3R, 3 Vëzhgimi i sasisë dhe përbërjes së mbetjeve, 4 Rryma e mbetjeve në zonën e synuar”.

Aktiviteti 4-2MM dhe EEJ mbështesin NjQV-në e synuar të formulojë draft Plan Veprimi 3R bazuar në rezultatet e vëzhgimit të sipërpërmendur për ish-Bashkinë Cërrik.

Bazuar në rezultatet e vëzhgimit mbi MMN dhe analizimi i problemeve të kryer për ish NjQV-në (Bashkia Cërrik) përpara reformës territoriale, draft Plan Veprimi 3R u hartua nga personi i ngarkuar për menaxhimin e mbetjeve në bashkinë Cërrik në Shtator 2015.

Aktiviteti 4-3MM dhe EEJ mbështesin NjQV-në e synuar të formulojë draft Plan Veprimi 3R bazuar në rezultatet e vëzhgimit të sipërpërmendur për Bashkinë e re Cërrik.

Draft Plan Veprimi 3R për NjQV-të e tanishme (Bashkia Cërrik pas reformës territoriale) u hartua nga personi i ngarkuar me menaxhimin e mbetjeve në bashkinë Cërrik në Tetor 2016. Synon 1) Pakësimin e sasisë së mbetjeve që dërgohen në landfill dhe 2) Përmirësimin e mënyrës së zbrazjes në zonën rurale. Detajet tregohen në “Dokumentin teknik: Udhërrëfyesi 3R, 6 Plan Veprimi 3R për Bashkinë Cërrik”.

Aktiviteti 4-4EEJ dhe MM planifikojnë dhe projektojnë projektin pilot në bashkëpunim me qeveritë vendore bazuar në draft Plan Veprimin 3R.

Projektet Pilot bazuar në draft Plan Veprimin 3R janë planifikuar nga Qershor 2015 deri në fillim Shtator 2015. Projektet Pilot përmbajnë 1) Pakësimin e sasisë së mbetjeve që dërgohen në landfill dhe 2) Përmirësimin e mënyrës së zbrazjes në zonën rurale. Detajet tregohen në “Shtojca 4 Aktivitetet lidhur me Rezultatin 4”.

Aktiviteti 4-5EEJ dhe qeveritë vendore zbatojnë dhe mbikëqyrin projektin pilot në bashkëpunim me MM.

Projekti Pilot kishte një vonesë 6 mujore nga programi për shkak të rizgjedhjes së bashkisë së mesme (referoju 5.1 Zgjedhja e komunës së mesme për projekt pilot).

Projektet Pilot u zbatuan 1) Pakësimin e sasisë së mbetjeve që dërgohen në landfill nga Janari 2016 dhe 2) Përmirësimin e mënyrës së zbrazjes në zonën rurale nga Prilli 2016 deri në Dhjetor 2016. Fillimisht monitorimi i Projektit Pilot u krye nga EEJ dhe gradualisht ju transferua personit të ngarkuar për menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Cërrik. Kur ishte e nevojshme aktivitetet e projektit pilot u ndryshuan.

Aktiviteti 4-6EEJ dhe MM vlerësojnë dhe bëjnë analizë të projektit pilot në bashkëpunim me qeverinë vendore.

U bë raporti i ndërmjetëm në Shtator 2016 dhe raporti përfundimtar në Mars 2017 gjatë “Seminarit mbi prezantimin e Udhërrëfyesit 3R dhe shpjegimit të rezultateve të projektit pilot”. Rekomandimet për vazhdimësinë dhe zgjerimin e projektit pilot në Bashkinë Cërrik tregohen në vazhdim.

- U pa që funksionimi i grumbullimit të ndarë të riciklueshmeve kërkonte kosto

shtesë. Është e vështirë të vazhdohet me gjendjen e tanishme financiare të bashkisë.

- Nuk rezultoi sasi e madhe të riciklueshmesh të grumbulluara për të pakësuar sasinë që dërgohet në landfill për të ulur ndikimin në mjedis dhe për të kursyer nga kosto e transportit, për shkak se qytetarët në përgjithësi nuk ishin bashkëpunues në zbrazjen më vete.
- Gjithsesi, PP në zonën e Fermës zbuloi se ishte efikase prezantimi i sistemit të grumbullimit derë më derë për mbetjet e përgjithshme përpara fillimit të grumbullimit të ndarë të të riciklueshmeve. Gjithashtu u pa se grumbullimi i mbetjeve të përgjithshme dhe të riciklueshmeve është më mirë të bëhet në ditë të ndryshme, edhe pse kërkon kosto shtesë. Grumbullimi i mbetjeve të përgjithshme dhe të riciklueshmeve në të njëjtën ditë duket ti dekurajojë qytetarët për ndarjen e të riciklueshmeve në shtëpi dhe kërkon punë shtesë nga punëtorët e grumbullimit për ndarjen e këtyre materialeve gjatë procesit të grumbullimit.
- Në zonën urbane, veçanërisht në atë me pallate, grumbullimi vetëm i të riciklueshmeve me muzikë nuk duket të jetë efikas ndërkohë që gjithë mbetjet e tjera mund të zbrazen në çdo kohë në kontejnerët bashkiakë të vendosur në lagje. Për më tepër, kishte mendime se nuk ishte e arsyeshme të prisje që banorët e pallateve të dilnin nga shtëpia të zbraznin të riciklueshmet me të dëgjuar muzikën e mjetit të grumbullimit.
- Kur të bëhet grumbullimi i ndarë i të riciklueshmeve, me bashkëpunimin e mirë të banorëve dhe me një sasi të mjaftueshme materiali të grumbulluar, atëherë kontribuon në uljen e ndikimit në mjedis në landfill si dhe ul koston e transportit të mbetjeve të grumbulluara në të ardhmen drejt landfillit rajonal.

Detajet tregohen në “Shtojca 4, Aktivitetet lidhur me Rezultatin 4”.

Aktiviteti 4-7EEJ, MM dhe qeveria vendore bashkë-organizojnë seminare për të raportuar rezultatet e projektit pilot banorëve dhe palëve të interesuara.

Raporti i projektit pilot u bë në Mars 2017. Detajet tregohen në “Shtojca 4, Aktivitetet lidhur me Rezultatin 4”.

Aktiviteti 4-8EEJ, MM dhe qeveria lokale bashkë-organizojnë seminare për të raportuar rezultatet e projektit pilot banorëve dhe palëve të interesuara.

Aktivitetet e projektit pilot ju raportuan bashkive të tjera nga persona nga zona e synuar e projektit pilot në “Seminari mbi prezantimin e Udhërrëfyesit 3R dhe shpjegimi i rezultateve të projektit pilot” në Mars 2017.

Detajet tregohen në “Shtojca 4: Aktivitetet lidhur me Rezultatin 4” dhe “Shtojca 6.2.4 Seminari mbi prezantimin e Udhërrëfyesit 3R dhe shpjegimi i rezultateve të projektit pilot”.

Aktiviteti 4-9EEJ, MM dhe qeveria vendore aplikojnë mësimet e nxjerra nga projekti pilot në Udhërrëfyesin 3R.

Përmbajtja e projektit pilot u publikua në Udhërrëfyesin 3R si “Shembuj të aktiviteteve 3R bazuar në mësimet e nxjerra nga projekti pilot që u zbatuan në zonat e synuara”. Detajet tregohen në “Dokument i teknik: Udhërrëfyesi 3R, 8 Shembuj aktiviteteve”. Në vijim janë

reagimet nga Udhërrëfyesi 3R gjatë projektit pilot.

- Nevojitet kosto e lartë të zbatohet grumbullimi i ndarë i të riciklueshmeve. Është e parakohshme për bashkitë në Shqipëri të prezantohet ky sistem, bazuar në gjendjen e tanishme financiare.
- Gjithsesi, prezantimi i grumbullimit derë më derë për mbetjet e përgjithshme dhe ndryshimi i një dite grumbullimi në ditë grumbullimi vetëm për të riciklueshmet në zonën rurale tregon se banorët janë të aftë të kuptojnë më lehtësisht grumbullimin e ndarë të riciklueshmeve dhe mund të grumbullohet një sasi materiali. Për pasojë, kur të bëhet prezantimi i grumbullimit të ndarë të riciklueshmeve, rekomandohet që të bëhet hap pas hapi.
- Nga ana tjetër, në zonën urbane, veçanërisht në zonën ku ka shumë pallate, është e vështirë të grumbullosh të riciklueshme duke përdorur grumbullimin me muzikë ndërkohë që mbetjet e përgjithshme mund të zbrazen në çdo kohë në kontejnerët bashkiakë të vendosur në zonë.
- Si sugjerimi për bashkinë Cërrik, kur grumbullimi i ndarë i të riciklueshmeve kryhet duke pasur një bashkëpunim të mirë me banorët dhe një sasi të mjaftueshme të riciklueshme të grumbulluar, mbledhja e veçantë kontribuon në zvogëlimin e ndikimit në mjedis të shkaktuar në landfill dhe do të çojë në më pak kosto transporti në të ardhmen për mbetjet e grumbulluara që do të dërgohen në landfillin rajonal.
- U pa në PP, Bashkinë Cërrik se përmirësimi i sistemit të zbrazjes/grumbullimit të mbetjeve është prioritet para prezantimit të ndarjes/grumbullimit të riciklueshmeve. Si dhe, për bashkinë ku menaxhimi i tanishëm i mbetjeve të ngurta nuk është menaxhuar si duhet, rekomandohet përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta para ndarjes/grumbullimit të riciklueshmeve.

Detajet tregohen në “Dokumenti teknik: Udhërrëfyesi 3R, 8 Shembuj aktivitetesh”.

3.2.6 Aktivitete lidhur me Rezultatin 5

Aktiviteti 5-1 EEJ studion gjendjen e MMN në bashkëpunim me qeverinë vendore (Bashkia Tiranë) në zonën e tyre të mbikëqyrjes/ administrative për të njohur (vlerësuar) sasinë e mbetjeve dhe përbërjen në burimin gjenerues, ripërdorimin, riciklimin dhe venddepozitimet përfundimtare, dhe ndërgjegjësimin social midis gjeneruesve të mbetjeve.

Vëzhgimi bazë u krye nga Shtatori 2014 deri në Maj 2016. Vëzhgimi bazë përbëhet nga 1) vëzhgimi mbi sasinë dhe përbërjen e mbetjeve, 2) sasia e mbetjeve të hyra në landfill, 3) vëzhgimi i opinionit publik dhe 4) vëzhgimi i riciklimit. Rryma e tanishme e mbetjeve në zonat e synuara u bënë bazuar në rezultatet e vëzhgimeve më sipër.

Detajet tregohen në “Dokumentin teknik: Udhërrëfyesi 3R, 3 Vëzhgimi i sasisë dhe përbërjes së mbetjeve, 4 Rryma e mbetjeve në zonën e synuar”.

Aktiviteti 5-2 MM dhe EEJ mbështesin NjQV-në e synuar të formulojë draft Plan Veprimi 3R bazuar në rezultatet e vëzhgimit të sipërpërmendur për ish-Bashkinë Tiranë.

Bazuar në rezultatet e vëzhgimit mbi MMN dhe analizimi i problemeve të kryer për ish

NjQV-në (Bashkia Tiranë) përpara reformës territoriale, draft Plan Veprimi 3R u hartua nga personi i ngarkuar për menaxhimin e mbetjeve në bashkinë Tiranë në Shtator 2015

Aktiviteti 5-3MM dhe EEJ mbështetin NjQV-në e synuar të formulojë draft Plan Veprimi 3R bazuar në rezultatet e vëzhgimit të sipërpërmendur për Bashkinë e re Tiranë.

Draft Plan Veprimi 3R për NjQV-të e tanishme (Bashkia Tiranë pas reformës territoriale) u hartua nga personi i ngarkuar me menaxhimin e mbetjeve në bashkinë Tiranë në Tetor 2016. Synon 1) Aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi të zbrazësve 2) Riciklimi dhe pakësimi i sasisë së mbetjeve nëpërmjet riciklimit. Detajet tregohen në “Dokumentin teknik: Udhërrëfyti 3R, 7.2 Përmbledhje e Plan Veprimit 3R dhe përzgjedhja e aktiviteteve 3R në Bashkitë Model”.

Aktiviteti 5-4EEJ dhe MM planifikojnë dhe projektojnë projektin pilot në bashkëpunim me qeverinë vendore bazuar në draft Plan Veprimin 3R.

Projektet Pilot bazuar në draft Plan Veprimin 3R janë planifikuar nga Qershor 2015 deri në fillim Shtator 2015. Projektet Pilot përmbajnë 1) Aktiviteti i ndarjes së riciklueshmeve dhe edukim mjedisor në shkollë dhe 2) Grumbullimi i ndarë i të riciklueshmeve në komunitet duke synuar familjet e nxënësve të shkollës. Detajet tregohen në “Shtojca 5 Aktivitetet lidhur me Rezultatin 5”.

Aktiviteti 5-5EEJ dhe qeveritë vendore zbatojnë dhe mbikëqyrin projektin pilot në bashkëpunim me MM dhe grupet përkatëse të interesit (kompanitë e riciklimit etj.).

Projektet Pilot u zbatuan 1) Aktiviteti i ndarjes së riciklueshmeve dhe edukim mjedisor në shkollë nga Shtatori 2016 dhe 2) Grumbullimi i ndarë i të riciklueshmeve në komunitet duke synuar familjet e nxënësve të shkollës nga Janar 2016 deri në Dhjetor 2016. Fillimisht monitorimi i Projektit Pilot u krye nga EEJ dhe gradualisht ju transferua personit të ngarkuar për menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Tiranë. Kur ishte e nevojshme aktivitetet e projektit pilot u ndryshuan.

Aktiviteti 5-6EEJ dhe MM vlerësojnë dhe bëjnë analizë të projektit pilot në bashkëpunim me qeverinë vendore.

U bë raporti i ndërmjetëm në Shtator 2016 dhe raporti përfundimtar në Mars 2017 gjatë “Seminarit mbi prezantimin e Udhërrëfyesit 3R dhe shpjegimit të rezultateve të projektit pilot”. Rekomandimet për vazhdimësinë dhe zgjerimin e projektit pilot në Bashkinë Tiranë tregohen në vazhdim.

 Faza 1

- Është domosdoshmëri vendosja e rrugës nga pika e zbrazjes më vete (hyrje) deri në mbledhjen dhe shitjen (dalje) para se të fillohet me zbrazjen veçantë. Përndryshe, të riciklueshmet që zbrazen nga nxënësit do përfundojnë të grumbulluara në shkollë, ose të zbraza me mbetjet e tjera, duke humbur përpyjekjen e nxënësve për zbrazjen më vete. Një dështim i tillë do pengojë zbatimin e aktivitetit "tjetër", që duhet shmangur, duke projektuar që në fillimi rrugën nga hyrja në dalje.
- Është e nevojshme të krijohet një sistem monitorimi nga bashkia dhe/ose vetë shkolla, me qëllim komunikimin e menjëhershëm ndërmjet grumbulluesit dhe

shkollës.

- Rekomandohet të ketë disa grumbullues aktivë në listën e kontakteve në zonën e synuar gati për të bashkëpunuar, më mirë sesa të varesh në vetëm një. Rekomandohet gjithashtu, të sigurohen grumbullues me mjetet e tyre të transportit, përta i përket aktivitetit bazë në shkolla.
- Mësuesit si edhe nxënësit priren drejt fitimit nga shitja e të riciklueshmeve më shumë se nga vetë aktiviteti i ndarjes. Është e nevojshme herë pas here ti kujtohet qartë “pse është e nevojshme ndarja dhe riciklimi.”
- Nëse grumbullimi i ndarë i mbetjeve të riciklueshme është zbatuar tashmë në lagjen ku ndodhen shkollat e aktivitetit të synuar, është e nevojshme për aktivitetin e shkollave të ndjekin të njëjtin rregull ndarje si në lagje. (Për shembull, nëse lagja ka një sistem që kërkon ndarjen e të riciklueshmeve në 4 lloje dhe zbrazjen në kontejnerë me ngjyra të ndryshme, shkolla duhet të ketë kontejnerë me të njëjtat ngjyra.) Nëse lagja ende nuk ka grumbullimin e diferencuar, është e mundur vendosja e kontejnerëve të riciklimit me ngjyra-kode në përputhje me llojet e mbetjeve të riciklueshme të trajtuara nga mbledhësit në dispozicion, ose në bazë të kategorisë që mbledhësit mund të kërkojnë. Megjithatë, kategorizimi duhet të jetë i thjeshta në mënyrë që nxënësit të mund ta ndjekin lehtë. Në PP Tiranë, një grumbullues mund të mbledhë gjithë PET, qelq dhe kanoçe së bashku, dhe kështu ndarja është bërë në dy kategoritë e mbetjeve, të riciklueshmet e synuara dhe jo të riciklueshmet.

Faza 2

- Flisni për shkakun, jo vetëm për rregullat (Pse riciklojmë ne?);
- Lëri nxënësit të mendojnë për aktivitetet sepse çdo shkollë ka problemet dhe karakteristikat e veta si dhe nxënësit janë gjithashtu shumë krijues;
- Organizoj shkollat pranë njëra-tjetrës në një grup në mënyrë që transporti të jetë sa më i mundshëm dhe sa më pak kosto për çdo shkollë;
- Lidh (grupin e) shkollat me grumbulluesit / ricikluesit e zonës;
- Fillimisht ofro mbështetje ditore dhe monitorim;
- Me materiale që kanë treg në zonë;
- Me një rrugë grumbullimi të përcaktuar që më parë;

Detajet tregohen në “Shtojca 5, Aktivitetet lidhur me Rezultatin 5”.

Aktiviteti 5-7 EEJ dhe MM bëjnë raport analize të projektit pilot në bashkëpunim me qeverinë vendore.

Raporti i Projektit Pilot u bë në Mars 2017. Detajet tregohen në “Shtojca 5, Aktivitetet lidhur me Rezultatin 5”.

Aktiviteti 5-8 EEJ, MM dhe qeveria vendore bashkë-organizojnë seminare për të raportuar rezultatet e projektit pilot banorëve dhe palëve të interesuara.

Aktivitetet e projektit pilot ju prezantuan bashkive të tjera nga persona nga zona e synuar e projektit pilot në “Seminari mbi prezantimin e Udhërrëfyesit 3R dhe shpjegimet e rezultateve të projektit pilot” në Mars 2017.

Detajet tregohen në “Shtojca 4, Aktivitetet lidhur me Rezultatin 4” dhe “6.2.4 Seminari mbi prezantimin e Udhërrëfyesit 3R dhe shpjegimet e rezultateve të projektit pilot”.

Aktiviteti 5-9 EEJ, MM dhe qeveria vendore aplikojnë mësimet e nxjerra nga projekti pilot në Udhërrëfyesin 3R.

Detaje të projektit pilot u botuan në Udhërrëfyesin 3R si “Shembuj të aktiviteteve 3R bazuar në mësimet e nxjerra nga projekti pilot që u zbatuan në zonën e synuar”.

- Flisni për shkakun, jo vetëm për rregullat (Pse riciklojmë ne?);
- Lërimi nxënësit të mendojnë për aktivitetet sepse çdo shkollë ka problemet dhe karakteristikat e veta si dhe nxënësit janë gjithashtu shumë krijues;
- Organizoj shkollat pranë njëra-tjetrës në një grup në mënyrë që transporti të jetë sa më i mundshëm dhe sa më pak kosto për çdo shkollë;

Detajet tregohen në “Dokumenti teknik: Udhërrëfyesi 3R, 8 Shembuj aktiviteteve”. Në vijim janë reagimet nga Udhërrëfyesi 3R gjatë projektit pilot.

3.2.7 Aktivitete lidhur me Rezultatin 6

Aktiviteti 6-1 MM përcakton parimin bazë dhe masat institucionale (p.sh. mekanizma të autorizuar për mbajtje të takimeve etj.) si të mbështesë qeveritë vendore nën konsultimin me EEJ.

“Seminari mbi vëzhgimin kombëtar të menaxhimit të mbetjeve të ngurta nga NjQV-ja” u mbajt bazuar në rezultatet e “Vëzhgimit kombëtar mbi praktikën e menaxhimit të mbetjeve” në 26 Shkurt 2015. Morën pjesë 8 vetë nga institucionet qendrore, 43 vetë nga NjQV-të dhe qarqet dhe 5 vetë nga donatorët ku u nda informacioni lidhur me organizimin dhe menaxhimin e mbetjeve në NjQV.

Aktiviteti 6-2 MM organizon konferencën mbi promovimin të 3R dhe MMN me qeveritë vendore në bashkëpunim me EEJ.

U kryen seminarët dhe workshop-et e mëposhtme. Detajet tregohen në “Shtojca 6.2 Seminare dhe Workshop-e”.

Tabela 4: Seminarët dhe workshop-et e kryera

	Datë	Titulli i seminarit dhe/ose workshop-it
1	26 Shkurt 2015	Seminar mbi vëzhgimin kombëtar të menaxhimit të mbetjeve të ngurta nga NjQV-të Seminar për shpjegimin e rrymës së mbetjeve NjQV-ve
2	12 Maj 2015	Seminar shpjegues i draft Udhërrëfyesit 3R
3	23 Mars 2016	Seminar mbi shpjegimin e 2 ^{të} të draft Udhërrëfyesit 3R dhe raport i ndërmjetëm i projekteve pilot
4	19 Shtator 2016	Workshop për mbështetjen e NjQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Gjirokastrë)
5	21 Shtator 2016	Workshop për mbështetjen e NjQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Vlorë 1)
6	23 Shtator 2016	Workshop për mbështetjen e NjQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Vlorë 2)

	Datë	Titulli i seminarit dhe/ose workshop-it
7	26 Shtator 2016	Workshop për mbështetjen e NJQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Fier)
8	29 Shtator 2016	Workshop për mbështetjen e NJQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Berat)
9	11 Tetor 2016	Workshop për mbështetjen e NJQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Elbasan)
10	12 Tetor 2016	Workshop për mbështetjen e NJQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Shkodër)
11	13 Tetor 2016	Workshop për mbështetjen e NJQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Lezhë)
12	9, 10 Mars 2017	Seminar mbi prezantimin e Udhërrëfyesit 3R dhe shpjegimi i rezultateve të projekteve pilot

Aktiviteti 6-3MM do të thellojë shkëmbimet me kompanitë e riciklimit përmes seminarit të raportimit mbi projektin pilot dhe Udhërrëfyesit 3R, në bashkëpunim me EEJ dhe NJQV-të.

Nga viti 2014 qeveria shqiptare vendosi ndalimin e importit të “lëndës së parë të riciklueshme”. Disa nga anëtarët e shoqatës së ricikluesve u dëmtuan nga mungesa e lëndës së parë. Më pas, u lejua importi i disa metaleve. Bazuar në rrethana të tilla, marrëdhënia ndërmjet MM dhe shoqatës së ricikluesve ishte e tensionuar për shkak të fillimit të diskutimit mbi “Rishikimin e importit të lëndës së parë”. Ishte e pamundur të zhvilloheshin diskutime ndërmjet MM dhe shoqatës së ricikluesve, pasi gjendja e tensionuar vazhdoi deri në përfundimin e projektit.

Aktiviteti 6-4MM shpërndanë aktivitetet & rezultatet e Projektit përmes buletinit të projektit qeverive vendore si dhe u siguron informacione qytetarëve përmes internetit, në bashkëpunim me EEJ.

U botuan dhe shpërndanë Buletine në Anglisht dhe Shqip. Buletini në Shqip u shpërnda për publikun nëpërmjet faqes së internetit të MM dhe MTI. Detajet jepen në “Shtojca 6.4 Marrëdhëniet me publikun”.

Tabela 5: Hedhja në qarkullim e buletinit

Nr.	Muaji	Çështjet kryesore
1	Prill 2015	• Prezantimi i projektit
2	Shkurt 2016	• Prezantimi i projektit pilot në 3 zonat e synuara • Informacion mbi Trajnimin e 1 ^{re} në Japoni
3	Nëntor 2016	• Raportimi mbi ecurinë e projektit pilot në 3 zonat e synuara • Informacion mbi Trajnimin e 2 ^{te} në Japoni • Raportim mbi vizitën në Prizren
4	Shkurt 2017	• Raporti përfundimtar i projektit pilot në 3 zonat e synuara • Raportimi i zbatimit të workshop-eve në mbështetje të NJQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo Qark
5	Prill 2017	• Përfundimi i Udhërrëfyesit 3R • Reportim mbi seminarin e prezantimit të Udhërrëfyesit 3R • Informacion për Trajnimin e 3-të në Japoni • Reportim i përfundimit të projektit

Aktiviteti 6-5 MeM, në bashkëpunim me EEJ, organizon workshop-e në mbështetje të NjQV-të për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo Qark. NjQV-të e synuara mendohet të jenë 40 NjQV në 8 Qarqe.

U zhvilluan workshop-e për mbështetjen e NjQV-ve në hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark ku synoheshin 40 bashki në 7 qarqe. Morën pjesë 32 zyrtarë nga 40 nga bashkitë dhe 7 zyrtarë nga qarqet. Disa nga pjesëmarrësit i kishin përgatitur të dhënat e bashkive të tyre dhe i kishin shkruar që më përpara në formatin e shpërndarë, nga ana tjetër, disa zyrtarë nuk e kishin fare idenë e kuptimit të gjendjes së tanishme në territorin e tyre. EEJ vlerësoi shkallën e kuptueshmërisë së pjesëmarrësve nëpërmjet një shkalle 5 pikëshe, 25 zyrtarë nga 32 morën një rezultat më shumë se 3 pikë.

Detajet tregohen në “Shtojca 6.2.5 Workshop në mbështetje të NjQV-së për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo Qark”.

Tabela 6: Workshop-et e kryera

	Datë	Emri i workshop-it
1	19 Shtator 2016	Workshop për mbështetjen e NjQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Gjirokastrë)
2	21 Shtator 2016	Workshop për mbështetjen e NjQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Vlorë 1)
3	23 Shtator 2016	Workshop për mbështetjen e NjQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Vlorë 2)
4	26 Shtator 2016	Workshop për mbështetjen e NjQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Fier)
5	29 Shtator 2016	Workshop për mbështetjen e NjQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Berat)
6	11 Tetor 2016	Workshop për mbështetjen e NjQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Elbasan)
7	12 Tetor 2016	Workshop për mbështetjen e NjQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Shkodër)
8	13 Tetor 2016	Workshop për mbështetjen e NjQV-ve për hartimin e Plan Veprimit 3R në çdo qark (Qarku Lezhë)

Aktiviteti 6-6 MeM, në bashkëpunim me EEJ, udhëzon në vend NjQV-të për hartimin e Planit të tyre të Veprimit 3R. NjQV-të e synuara mendohet të jenë 40 NjQV në 7 Qarqe.

Në draft Plan Veprimet 3R që ju dërguan EEJ nga bashkitë pas seminarit, EEJ i renditi ato bazuar në 1) shkallën e kuptimit të gjendjes së tanishme, 2) krijimin e rrymës së mbetjeve, 3) kuptimin e gjendjes financiare dhe 4) nxjerrjen e problemeve / pikave nëpërmjet pikëzimit me shkallë nga 5 pikë. Ndërmjet tyre, EEJ vendosi të japë udhëzime individuale favorizuese për bashkitë me një vlerësim të plotë të progresit që kishin arritur deri në 3. Edhe nëse vlerësimi është 4 ose 5, EEJ vizitoi qeverive vendore, ku kishte pjesë bosh dhe dha mbështetje për hartimin e plan veprimit.

Tabela 7: Data e vizitave individuale

	Emri i Bashkisë	Data e vizitës
1	Gjirokastrë	23 Nëntor 2016
2	Dropull	23 Nëntor 2016

Emri i Bashkisë		Data e vizitës
3	Libohovë	23 Nëntor 2016
4	Sarandë	24 Nëntor 2016
5	Konispol	23 Nëntor 2016
6	Delvinë	24 Nëntor 2016
7	Vlorë	24 Nëntor 2016
8	Fier	13 Dhjetor 2016
9	Mallakastër	1 Dhjetor 2016
10	Patos	13 Dhjetor 2016
11	Roskovec	1 Dhjetor 2016, 13 Dhjetor 2016
12	Lushnje	6 Dhjetor 2016
13	Divjakë	6 Dhjetor 2016
14	Kuçovë	1 Dhjetor 2016
15	Ura Vajgurore	1 Dhjetor 2016
16	Skrapar	6 Dhjetor 2016
17	Shkodër	12 Dhjetor 2016
18	Lezhë	12 Dhjetor 2016
19	Mirditë	12 Dhjetor 2016
20	Elbasan	7 Dhjetor 2016
21	Belsh	7 Dhjetor 2016
22	Gramsh	7 Dhjetor 2016
23	Librazhd	7 Dhjetor 2016
24	Peqin	7 Dhjetor 2016

Nëpërmjet vizitave individuale në çdo bashki u përgatitën draft Plan Veprimi për 26 bashki.

4 Kontributet

4.1 Kontributet nga Pala Japoneze

Detyrat e anëtarëve të ekipit të ekspertëve japonez (në tekstin e mëtejshëm EEJ) janë siç tregohet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 8: Lista e anëtarëve të EEJ

Përgjegjësia	Emri	
Këshilltari Kryesor / MMN i Integruar	Hiroshi	FUJITA
Zëvendës-këshilltari kryesor/ Ndërgjegjësim Publik / Edukim Mjedisor	Chiaki	NISHI
Politikat & praktikat 3R	Koji	KUSUNOKI
Masat administrative dhe politike	Shinnosuke	ODA
Qasja pjesëmarrëse në praktikën 3R	Aya	ITO
Koordinator / Trajnimi i homologëve në Japoni	Maiko	FUKUTOMI
Koordinator (Monitorimi)	Hiroshi	TSURUTA
Trajnimi i homologëve në Japoni	Hideo	SATO

4.1.1 Dërgimi i ekspertëve

Periudha gjithsej e detyrës së EEJ për Projektin është 75.80 MM sipas programit më poshtë.

Tabela 9: Programi i Misionit të EEJ

Emri (në pagesë)	FY 2014												FY 2015						
	6	7	8	9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	7					
Hiroshi FUJITA (Këshilltari Kryesor/ MMN i Integruar)	3	21	59			34			55	17		16		23					
Chiaki NISHI (Zëvendës Kryekëshilltar/ Ndërgjegjësim publik dhe Edukimi mjedisor)		31	29	30							35	10		23					
Koji KUSUNOKI (Politika & Praktika 3R)		44			58				71			34							
Shinnosuke ODA (Masat administrative dhe politike)				32					30				38						
Aya ITO (Qasja pjesëmarrëse në MIMN)									43			21							
Maiko FUKUTOMI (Koordinues / Trajnimi në Japoni)			46						91				7						
Hiroshi TSURUTA (Koordinues (Monitorimi))																			
Hideo SATO (Trajnimi në Japoni)																			

Emri (në pagesë)	FY 2015								FY 2016								
	8	9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	7	6	7			
Hiroshi FUJITA (Këshilltari Kryesor/ MMN i Integruar)				44				17		40							
Chiaki NISHI (Zëvendës Kryekëshilltar/ Ndërgjegjësimi publik dhe Edukimi mjedisor)					37				70			62					
Koji KUSUNOKI (Politika & Praktika 3R)				39				40		40							
Shinnosuke ODA (Masat administrative dhe politike)						59			60					46			
Aya ITO (Qasja pjesmarrëse në MIMN)																	
Maiko FUKUTOMI (Koordinues / Trajnimi në Japoni)																	
Hiroshi TSURUTA (Koordinues (Monitorimit))														46			
Hideo SATO (Trajnimi në Japoni)																	
Emri (në pagesë)	FY 2016								FY 2017							Totali ditë	Totali muaj
	8	9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	7					
Hiroshi FUJITA (Këshilltari Kryesor/ MMN i Integruar)							15		22		26				439	14.63	
Chiaki NISHI (Zëvendës Kryekëshilltar/ Ndërgjegjësimi publik dhe Edukimi mjedisor)							22				14				446	14.87	
Koji KUSUNOKI (Politika & Praktika 3R)															455	15.17	
Shinnosuke ODA (Masat administrative dhe politike)															400	13.33	
Aya ITO (Qasja pjesmarrëse në MIMN)															64	2.13	
Maiko FUKUTOMI (Koordinues / Trajnimi në Japoni)															144	4.80	
Hiroshi TSURUTA (Koordinues (Monitorimit))															317	10.57	
Hideo SATO (Trajnimi në Japoni)															9	0.30	
Total															2,274	75.80	

4.1.2 Blerja e bërë e pajisjeve

Pala Japoneze bleu dhe solli nga Japonia dhe Shqipëria artikujt e mposhtëm.

Tabela 10: Pajisjet e blera në Japoni

Artikulli	Emri i produktit	Sasia
GPS dore	GARMIN eTrex 30	2
Kamera Dixhitale	Canon IXY 140	2
Video Kamera dore Dixhitale	Panasonic HC-V230M	1

Tabela 11: Pajisjet e blera në Shqipëri

Artikulli	Emri i produktit	Sasia
Makinë fotokopje	SHARP AR-5618N	1 set
Printer Laser A4 mono-kolor	HP Leaser Jet 400	1 set
Printer Inkjet A3 ngjyra	HP7110	1 set
Kompjuter Laptop	DEL Satellite Pro C660	1 set
Kompjuter Desktop	HP pro	2 set
UPS	Power tree industry S850E	2 copë
Projektor	EPSON EB-S18	1 copë

Artikulli	Emri i produktit	Sasia
OS	MS Windows 7	3 copë
MS Office	MS Office 2010	3 copë
Software Anti-virus	Kasperski 2014	3 copë

4.2 Kontribute nga pala Shqiptare

4.2.1 Pajisje dhe zyrë për Projektin

Pala Shqiptare përgatiti zyrën dhe pajisjet si më poshtë.

A Zyra e Projektit

Që nga Gushti 2014, në fazën e hershme të Projektit, EEJ mori me qira një zyrë me hapësirë rreth 80 m² me distancë ecje në këmbë rreth 10 minuta nga godina e re e MM (ndryshuar nga Gushti 2015).

B Pajisjet

Pala Shqiptare vuri në dispozicion pajisjet e poshtëshënuara.

Tabela 12: Lista e pajisjeve nga pala Shqiptare

Njësia : JPY

Artikujt	Sasia			Gjithsej
	2014	2015	2016	
Zyrë	Pajisjet e përdorura që janë pronë e MM			-
Tavolina dhe karrige zyre				-
Rafte				-
Elektriciteti	Është e paqartë, pasi pagesa bëhet bazuar në konsumin e përgjithshëm të MM			-
Uji				-
Tarifa e internetit	23,750	33,250	0	57,000
Gjithsej	23,750	33,250	0	57,000

※ Tarifa e Internetit hamendësohet e njëjtë me atë të zyrës së EEJ, është ofruar nga Gusht 2014 deri në Korrik 2015.

4.2.2 Burimet njerëzore

Në tabelën më poshtë tregohen personat e ngarkuar me Projektin në organizmat homologë⁴ për periudhën e sipërpërmendur.

Tabela 13: Lista e Homologëve Shqiptarë

Organizmi	Emri	Pozicioni
【Homologët kryesorë】		
Ministria e Mjedisit	Z. Pëllumb ABESHI	Drejtore i Përgjithshëm i Politikave Mjedisore / Drejtore i Projektit

⁴ Homologët (C/P)

Organizmi	Emri	Pozicioni
	Z. Redi BADUNI (deri në Maj 2016)	Drejtore, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Jetësimit të Prioriteteve / Menaxher Projekti
	Z. Athanas KARAJA (nga Qershor 2016)	Drejtore, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Jetësimit të Prioriteteve / Menaxher Projekti
	Znj. Ledjana BOJAXHI	Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve & Aksidenteve Industriale
	Z. Polikron HORESHKA	Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Mbetjeve & Aksidenteve Industriale
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Z. Isa MEMIA	Specialist, Departamenti i Politikave në Mbetjet e Ngurta
Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Znj. Aida SESERI	Drejtoreshë, Drejtoria e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit
【Homologët e tjerë】		
Bashkia Tiranë	Z. Namik SHIMIXHIU	Drejtore, Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta
Bashkia Cërrik	Z. Servet DUZHA (deri në Gusht 2016)	Drejtore, Departamenti i Shërbimeve Publike
	Z. Qerim BAKU (nga Shtatori 2016)	Drejtore, Departamenti i Shërbimeve Publike
Bashkia Vau i Dejës	Z. Zija GERBETI	Drejtore, Departamenti i Shërbimeve Publike

5 Faktorët e jashtëm

5.1 Zgjedhja e komunës së mesme për projekt pilot

5.1.1 Objektivat e vëzhgimit

Ky vëzhgim ka për qëllim përzgjedhjen e bashkisë ose komunës së mesme si një alternativë e bashkisë Lezhë për projektin pilot.

5.1.2 Përzgjedhja e NjQV së synuar

A Procedurat e përzgjedhjes

Procedura e përzgjedhjes së NjQV së mesme u nda në dy faza. Në fazën e parë, u krijua një listë e kandidatëve (këtu e në vazhdim lista e gjatë) mbështetur në të dhënat e siguruar nga vëzhgimi i mëparshëm. Pas diskutimeve ndërmjet EEJ, Ministrisë së Mjedisit (MM) dhe zyrës së koordinimit pranë Këshillit të Ministrave, u përzgjedhën si kandidatë për në listën e shkurtër tre bashki. Në fazën e dytë, Ekipi i Ekspertëve të JICA (EEJ) vizitoi tre bashkitë përkatëse për të parë situatën e tanishme të menaxhimit të mbetjeve nga bashkitë si dhe për të vlerësuar fizibilitetin e kryerjes së projektit pilot. Rezultati i vëzhgimit iu raportua MM dhe zyrës së koordinimit pranë Këshillit të Ministrave për të përmbyllur përzgjedhjen e bashkisë së mesme.

B Faza e parë e përzgjedhjes

B.1 Kriteret e përzgjedhjes së NjQV në listën e gjatë

Përzgjedhja e NjQV-ve në fazën e parë u bë mbështetur në rezultatet e Studimit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Qeveritë Vendore (SKMMN), që u krye në periudhën Gusht – Nëntor 2014. Kriteret e përzgjedhjes së NjQV-ve për në listën e gjatë jepen më poshtë.

B.1.1 Raporti i popullsisë rezidente në NjQV

Raporti i popullsisë rezidente në çdo NjQV u konsiderua si një kriter i rëndësishëm për përzgjedhjen. Me qëllim identifikimin e popullsisë në çdo NjQV, fillimisht iu referuam rezultateve të CENSUS 2011. Megjithatë, u gjet një hendek i madh ndërmjet shifrave të CENSUS 2011 dhe popullsisë së tanishme rezidente të raportuar në SKMMN. Për këtë arsye, EEJ kreu një intervistë telefonike shtesë me NjQV për të konfirmuar numrin e tanishëm të rezidentëve. Kështu që, popullsia rezidente e dalë nga kjo intervistë telefonike u përdor si kriter përzgjedhjeje. Me këto të dhëna të popullsisë rezidente, mesatarja e popullsisë rezidente në NjQV u vlerësua 30,112 për NjQV. Përgjashtuar bashkinë e Tiranës, që ka popullsinë më të madhe në Shqipëri me 556,604 banorë, mesatarja e popullsisë në bashki u vlerësua 21,886 banorë, ndërsa mesatarja e popullsisë në komunë u vlerësua 5,737 banorë. Kështu, duke pasur parasysh mesataren e popullsisë të NjQV si dhe raportin e shpërndarjes së popullsisë, siç është paraqitur në 1.2, EEJ vendosi të përkufizojë si NjQV të mesme "Bashkinë ose Komunën, që ka popullsi prej më pak se 50.000 banorë".

B.1.2 Bashkia dhe komuna

Ekzistenca e sektorit të menaxhimit të mbetjeve në NjQV u pa gjithashtu si thelbësore në

zbatimin e projektit pilot. Sipas SKMMN, u pa se vetëm 25 % e Komunave ka sektor të menaxhimit të mbetjeve. U vu re, sipas reformës territoriale, se të gjitha komunat në Shqipëri pritet ti bashkohen bashkive kufitare deri në qershor 2015. Duke marrë parasysh këtë situatë, EEJ vendosi ti heqë Komunat si kandidate në kuadër të fizibilitetit dhe qëndrueshmërisë së projektit pilot. Si rrjedhim, EEJ vendosi të synojë Bashkitë si kandidate për projektin pilot.

B.1.3 Raporti i mbulimit me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve në bashki

Është shumë e rëndësishme për praktikën 3R që shërbimi i grumbullimit të mbetjeve i bashkisë të mbulojë pjesën më të madhe të zonës së banuar. Për këtë qëllim, mbështetur në SKMMN, EEJ ka përzgjedhur Bashkitë, që kanë shërbim grumbullimi mbetjesh, që mbulojnë më shumë se 50% të zonës së tyre të shërbimit.

B.1.4 Mbledhja e tarifës së grumbullimit të mbetjeve

Bashkëpunimi nga banorët si dhe ekzistenca e menaxhimit të qenësishëm bashkiak janë të rëndësishme për zbatimin e praktikave 3R. Mbështetur në besimin se shkalla e pagesës së tarifës së grumbullimit të mbetjeve përfaqëson shkallën e vullnetit të banorëve për të bashkëpunuar për 3R dhe nivelin administrativ të menaxhimit të mbetjeve nga bashkia, EEJ përzgjodhi Bashkitë që kanë raport të lartë të mbledhjes së tarifës së grumbullimit të mbetjeve.

B.1.5 Prezenca e donatorëve të tjerë

Me marrjen e kërkesës nga MM, EEJ hoqi Bashkitë, që kanë pasur tashmë mbështetje nga donatorët lidhur me çështjet e menaxhimit të mbetjeve me qëllim shpërndarjen e përfitimit nga donatorët në rajone të tjera të Shqipërisë. (p.sh. Bashkia e Tiranës në Qarkun e Tiranës edhe Komuna e Bushatit në Qarkun e Shkodrës kanë marrë tashmë mbështetjen e donatorëve të tjerë ndërkombëtarë në fushën e menaxhimit të mbetjeve).

B.2 Përzgjedhja e bashkive të synuara në Fazën e 1-rë

Siç tregohet në Tabela 14 ishin 24 bashki që përmbushnin kriteret. Pas diskutimeve me MM, tre bashki, Kuçovë, Cërrik dhe Ersekë, u përzgjodhën për në listën e shkurtër si bashki të synuara.

Tabela 14: Lista e qeverive vendore të synuara

V_ID	Population 2014 (1)	New Municipal Name	Number	County Name	LGU Type (2)	Category	LGU Name	Waste collection fee per Household, month (3)	Coverage (4)	Donner activities in county (5)	Note
7	16,800	Kucove	13	BERAT	Municipality	2	Kucove	120.00	100%	No	Short listed
10	5,700	Polican	17	BERAT	Municipality	2	Polican	33.33	100%	No	Complied
15	5,400	Skrapar	16	BERAT	Municipality	2	Corodove	50.00	100%	No	Complied
25	9,600	Ura Vajgurore	2	BERAT	Municipality	2	Ura Vajgurore	91.66	100%	No	Complied
26	10,900	Bulgize	333	DIBER	Municipality	2	Bulgize	100.00	100%	No	Complied
43	17,600	Diber	318	DIBER	Municipality	2	Peshkopi	100.00	100%	No	Complied
54	14,400	Mat	341	DIBER	Municipality	2	Burrel	100.00	100%	No	Complied
77	11,700	Belsh	70	ELBASAN	Municipality	2	Belsh	83.67	100%	No	Complied
81	8,900	Cerrik	69	ELBASAN	Municipality	2	Cerrik	50.00	100%	No	Short listed
99	11,200	Gramsh	97	ELBASAN	Municipality	2	Gramsh	133.33	100%	No	Complied
110	9,200	Librazhd	107	ELBASAN	Municipality	2	Librazhd	83.33	100%	No	Complied
119	8,400	Peqin	91	ELBASAN	Municipality	2	Peqin	83.67	100%	No	Complied
122	7,800	Prrenjas	108	ELBASAN	Municipality	2	Prrenjas	83.33	100%	No	Complied
174	26,400	Gjrokaster	286	GJIROKASTER	Municipality	1	Gjrokaster	150.00	100%	No	Complied
181	3,500	Kelcyre	310	GJIROKASTER	Municipality	2	Kelcyre	58.00	100%	No	Complied
190	3,500	Memaliaj	300	GJIROKASTER	Municipality	2	Memaliaj	16.67	100%	No	Complied
194	7,900	Permet	309	GJIROKASTER	Municipality	2	Permet	100.00	100%	No	Complied
201	8,300	Devoll	135	KORCE	Municipality	2	Bilisht	30.00	80%	No	Complied
208	5,000	Kolonje	139	KORCE	Municipality	2	Erseke	50.00	100%	No	Short listed
209	2,000	Kolonje	140	KORCE	Municipality	2	Leskovik	42.00	100%	No	Complied
232	27,700	Pogradec	147	KORCE	Municipality	1	Pogradec	200.00	100%	No	Complied
241	8,000	Has	170	KUKES	Municipality	2	Krume	41.67	100%	No	Complied
248	22,200	Kukes	155	KUKES	Municipality	2	Kukes	120.00	100%	No	Complied
257	7,100	Tropoje	174	KUKES	Municipality	2	Bajram Curri	83.33	100%	No	Complied

C Përzgjedhja e bashkive të synuara në Fazën e 2-të

C.1 Vëzhgimi në Terren

Gjatë periudhës nga 28 janari deri në 5 shkurt 2015 (3 ditë), EEJ kreu një vëzhgim në terren në bashkitë e listës së shkurtër.

Tabela 15: Programi i Vëzhgimit në Terren

Data	Bashkia
28 janar 2015	Bashkia Kuçovë
3 shkurt 2015	Bashkia Cërrik
5 shkurt 2015	Bashkia Ersekë

C.2 Përmbledhje e vëzhgimit në terren

Si rezultat i vëzhgimit në terren, u pa se në asnjë nga të tre bashkitë nuk ka industri të rëndë. Gjithashtu, njerëzit që jetojnë në këto bashki marrin të ardhura kryesisht nga sektori i shërbimeve si edhe nga bujqësia. Edhe pse çdo komunë siguron siç duhet mbledhjen e mbetjeve në zonat e banuara, ka disa çështje që duhen adresuar përpara fillimit të 3R, për shembull, duke përmirësuar eficientësinë e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve, nivelin e kënaqësisë së banorëve lidhur me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve dhe menaxhimin e venddepozitimeve sanitare. Për më tepër, krejt normalisht u vu re mungesa e politikave të menaxhimit të mbetjeve në të tre bashkitë, që propozon nevojën e ristrukturimit të skemës së tanishme të menaxhimit të mbetjeve si edhe hartimi i politikave për menaxhimin e mbetjeve bashkiake. Pas kësaj, si kriter përzgjedhjeje, EEJ vendosi të marrë parasysh fizibilitetin nëse bashkitë e përzgjedhura janë në gjendje të trajtojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse problemet në menaxhimin e tanishëm të mbetjeve para fillimit të praktikave 3R. Tabela e mëposhtme tregon përmbledhjen e vëzhgimit në terren, kryer nga EEJ.

Tabela 16: Përmbledhje e Vëzhgimit në Terren për Bashkitë e Mesme dhe Përparësitë e Përzgjedhjes

Bashkitë kandidate	Kuçovë		Cërrik		Ersekë	
Popullsia në 2014	Regjistruar: 30,017 Rezident: 22,500 CENSUS 2011:12,603		Regjistruar: 15,000 Rezident: 11,000 CENSUS 2011: 6,668		Regjistruar: 10,000 Rezident: 7,500 CENSUS 2011: 3,731	
Popullsia rezidente pas reformës territoriale	Kuçovë	16,800	Cërrik	8,900	Barmash	600
	Kozare	7,500	Gostimë	10,800	Çlirim	500
	Lumas	5,300	Klos	4,300	Ersekë	5,000
	Perondi	12,000	Mollas	7,400	Leskovik	2,000
			Shalës	5,100	Mollas	2,000
					Novoselë	500
					Qendër Ersekë	3,600
					Qendër Leskovik	600
	Kuçovë	41,600	Cërrik	36,500	Kuçovë	41,600
Renditja e popullsisë rezidente pas reformës	21 / 61		28 / 61		48 / 61	
Përshtatshmëria për bashki e mesme	I përshtatshëm		I përshtatshëm		I papërshtatshëm	
Situata e tanishme e menaxhimit të përgjithshëm të mbetjeve nga NjQV	【 Menaxhimi nga NjQV】 Përdor mënyrën e thjeshtë të llogaritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve të kostos mbetjeve të grumbulluara dhe të zbrazura. Megjithatë, ka kryer vetëm ndërgjegjësimin e publikut nga 6 pikat e formuluar në strategjinë kombëtare të mbetjeve, si dhe nuk është përgatitur plani i menaxhimit të mbetjeve të NjQV. Është bërë studim i fizibilitetit për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin nën drejtimin e USAID. Është planifikuar zbatimi i projektit të ndarjes mbështetur në studim.		【 Menaxhimi nga NjQV】 Përdor mënyrën e thjeshtë të llogaritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve të kostos mbetjeve të grumbulluara dhe të zbrazura. Megjithatë, ka kryer vetëm ndërgjegjësimin e publikut nga 6 pikat e formuluar në strategjinë kombëtare të mbetjeve, si dhe nuk është përgatitur plani i menaxhimit të mbetjeve të NjQV.		【 Menaxhimi nga NjQV】 Përdor mënyrën e thjeshtë të llogaritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve të kostos mbetjeve të grumbulluara dhe të zbrazura. Megjithatë, ka kryer vetëm ndërgjegjësimin e publikut nga 6 pikat e formuluar në strategjinë kombëtare të mbetjeve, si dhe nuk është përgatitur plani i menaxhimit të mbetjeve të NjQV. Janë bërë modele të letrës së përdorur dhe ashklave të drurit për ngrohje. Megjithatë, nuk është vënë ende në zbatim.	
	【 Grumbullimi i mbetjeve】		【 Grumbullimi i mbetjeve】		【 Grumbullimi i mbetjeve】	

Bashkitë candidate	Kuçovë	Cërrik	Ersekë
	Grumbullimi i mbetjeve kryhet nga kompani private. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve mbulon 100% të territorit. Mbetjet hidhen në kontejnerë dhe mblidhen nga kamionë me kompaktor. Disa mbetje mblidhen nga një kamion i vogël me kompaktor në disa zona rurale ku kamioni i madh ka vështirësi ty hyjë. Koshat e mbetjeve janë larg banesave në zonat rurale, pra janë të papërshtatshëm dhe është e vështirë të mbledhësh opinionin e qytetarëve për shërbimin. Mbetjet grumbullohen në ora 3 të mëngjesit që të shmanget trafikun dhe parkimet e paligjshme.	Në qendrën e qytetit mbetjet hidhen në kontejnerë dhe mblidhen nga një kamion kompaktor, nga ana tjetër, në zonat rurale mbetjet derdhen në platforma betoni dhe ngarkimi i tyre për transport bëhet me dorë. Duhet një kohë e gjatë për ngarkimin e mbetjeve që e bën procesin e grumbullimit joefiçent. Ka shumë mbetje nëpër rrugë në qendrën e qytetit.	Territori i bashkisë është shumë më i vogël se i dy bashkive të tjera dhe rreth 20% e territorit të bashkisë Cërrik. Mbetjet hidhen në kontejnerë. Nuk ka mbetje të hedhura në rrugë dhe mjedisi i qytetit mbahet pastër. Nuk u gjet ndonjë problem madhor lidhur me menaxhimin e mbetjeve.
	【 Venddepozitimi mbetjeve】 Venddepozitimi ndodhet brenda territorit të bashkisë, megjithatë, nuk është i rrethuar me gardh dhe nuk trajtohen ujërat që kullojnë. Venddepozitimi ndodhet përgjatë shtratit të lumit që po gërryhet. Nevojitet mbrojtje urgjente e shtratit të lumit.	【 Venddepozitimi mbetjeve】 Venddepozitimi ndodhet brenda territorit të bashkisë me një sipërfaqe 2000m². Venddepozitimi është pothuajse plot. Jetëgjatësia e tij nuk është edhe shumë e gjatë. Prandaj, me përparësi është krijimi i një venddepozitimi të ri. Gjithsesi, shumica e tokës është tokë e kategorisë së parë (për bujqësi), prandaj është i pamundur ndërtimi i një venddepozitimi.	【 Venddepozitimi mbetjeve】 Venddepozitimi gjendet rreth 2 km larg qendrës së qytetit. Në fillimet e funksionimit, venddepozitimi kishte rrethim dhe një portë hyrëse të cilat janë vjedhur dhe nuk gjenden më në kohën që flasim. Venddepozitimi është një ish-gurore dhe kohë pas kohe mbetjet mbulohen me një shtresë dheu për të ruajtur pastërtinë.

Bashkitë kandidate	Kuçovë	Cërrik	Ersekë
		Bashkia po planifikon gjetjen e tokës për venddepozitimin e ri pas reformës territoriale ku do të bashkohet me komuna të tjera. Gjithsesi, nuk ka ende një plan konkret.	
Metoda e pritshme e përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve dhe efienca	Nevojitet bërja e planit të menaxhimit të mbetjeve të NjQV. Futja e sistemit të grumbullimit derë më derë në vend të grumbullimit me kontejnerë për përmirësimin e efijencës në zonat rurale mund të ndikojë në rritjen e nivelit të pëlqyeshmërisë te banorëve. Futja e sistemit të grumbullimit derë më derë dhe njëkohësisht e ndarjes në burim. Kjo ka nevojë të verifikohet për mundësinë dhe efijencën e të dyja metodave. Përmirësimi i aktiviteteve të venddepozitimit. Nevojitet zgjerimi i zonës së depozitimit dhe mbrojtja e shtratit të lumit.	Nevojitet bërja e planit të menaxhimit të mbetjeve të NjQV. Futja e sistemit të grumbullimit derë më derë në vend të platformave të betonit në zonat rurale për përmirësimin e efijencës së grumbullimit gjithashtu mund të ndikojë në rritjen e nivelit të pëlqyeshmërisë te banorët. Duhet shkuar drejt pakësimit të sasive të shkarkuara në venddepozitim duke futur sistemin e ndarjes në burim dhe shitjen e materialeve të riciklueshme. Kjo mund të çojë edhe në zgjatjen e jetës së venddepozitimit.	Nevojitet bërja e planit të menaxhimit të mbetjeve të NjQV. Nuk ka probleme të mëdha lidhur me zbrazjen, grumbullimin dhe transportin e mbetjeve.
Nevoja për përmirësim	E mesme	E lartë	E ulët
Përmbajtja e pritshme e projektit pilot lidhur me 3R	Futja e sistemit të zbrazjes dhe e grumbullimit të ndarë të mbetjeve në zonat rurale. Futja e sistemit të grumbullimit derë më derë në vend të atij me kontejnerë. Pakësimi i	Futja e sistemit të zbrazjes dhe e grumbullimit të ndarë të mbetjeve në qendër të qytetit dhe rrethina. Futja e sistemit të grumbullimit derë më derë në vend të atij me kontejnerë.	Futja e sistemit të ndarjes së mbetjeve në burim dhe grumbullimi mbështetur në planin e menaxhimit të mbetjeve të NjQV. Gjithsesi, nuk është i nevojshëm prezantimi i 3R-ve për shkak të sasive

Bashkitë kandidate	Kuçovë	Cërrik	Ersekë
	shpeshtisë së grumbullimit të mbetjeve dhe caktimi i ditës së grumbullimit të materialit të riciklueshëm.	Pakësimi i shpeshtisë së grumbullimit të mbetjeve dhe caktimi i ditës së grumbullimit të materialit të riciklueshëm.	të pakta të mbetjeve
Domosdoshmëria për përmirësim	E lartë	E lartë	E ulët
Konsideratat e pritshme për projektin pilot - Ndikimi për zbatim - Bashkëpunimi i NJQV	Nevojitet bashkëpunimi i kompanisë së grumbullimit. (Mbulimi i kostos së funksionimit etj.) Grumbullues mbetjesh të aftë që të kontribuojnë në aktivitetet 3R. Projekti Pilot do të kryhet vetëm në disa zona, prandaj është e vështirë të matet pakësimi i sasisë së mbetjeve. Nuk është e sigurt që kompania private e grumbullimit bie dakord të ndryshojë metodën e grumbullimit të mbetjeve.	Është e lehtë gjetja e bashkëpunimit pasi grumbullimi i mbetjeve kryhet nga bashkia dhe gjithashtu përgjigjet do të jenë të menjëhershme. Nevojitet ngritja e sistemit të përzgjedhjes e magazinimit të materialit të riciklueshëm. Nevojitet gjetja e blerësve të materialit të riciklueshëm të grumbulluar dhe duhen studiuar kushtet e tyre. Është e lehtë matja e efikasitetit meqë projekti pilot do të kryhet në shumicën e territorit të bashkisë.	Përhapja e eksperiencës lidhur me ndarjen në burim dhe grumbullimin e mbetjeve të bashkitë e tjera është e kufizuar për shkak të madhësisë së bashkisë, që është e vogël dhe nuk ka shumë bashki të ngjashme.
Ndikimi dhe efektiviteti i përgjithshëm	E mesme	E lartë	E ulët
Renditja e përgjithshme	2	1	3

D Rezultatet e përzgjedhjes

Pas diskutimeve me MM, bashkia Cërrik u caktua të jetë vendi për projektin pilot për bashkinë e mesme. Pas kësaj, EEJ e vizitoi sërish bashkinë Cërrik në 17 shkurt 2015 për të diskutuar mbi veprimet e nevojshme nga bashkia dhe aktivitetet për projektin pilot dhe të dyja palët ranë dakord mbi kuadrin e projektit pilot.

MM kërkoi miratimin e anëtarëve të KPK nëpërmjet një dokumenti për përzgjedhjen e Cërrikut, si NJQV e mesme për të zëvendësuar Lezhën. Të gjithë anëtarët, përfshirë Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Qarku Tiranë, Bashkia Tiranë, Komuna Bushat, Bashkia Lezhë dhe Qarku Lezhë, dhanë miratimin e tyre më 23 mars.

5.2 Reforma territoriale dhe zgjedhjet e qeverive vendore

Në Shqipëri, 385 qeveri vendore janë integruar në 61 për përmirësimin e efikasitetit të qeverisjes vendore sipas reformës territoriale e cila hyri në fuqi në shtator të vitit 2016. Para saj, zgjedhjet për kryetarë të bashkive dhe anëtarëve vendorë të këshillit bashkiak u mbajtën në qershor të vitit 2016. Si rezultat i reformës, një njësi e re pushteti vendor është formuar për të qeverisur një rajon relativisht më të madh duke përfshirë disa ish-NjQV⁵ fqinje si njësi e saj administrative dhe njësitë e reja të pushtetit vendor janë quajtur tani të gjitha "Bashki", ndërsa para reformës NjQV quheshin ose Bashki ose Komuna në varësi të madhësive të tyre.

Bashkitë ku Projekti zhvillon projektet pilot përsuan ndryshime: Komuna Bushat është bërë Bashkia Vau i Dejës duke përfshirë 6 Nj.A⁶ fqinje; Bashkia Cërrik, edhe pse mban të njëjtin emër si para reformës, tani drejton 4 Nj.A; Bashkia e Tiranës po ashtu mbetet e njëjtë në emrin e saj, por është zgjeruar në masë të madhe ku përfshihen 14 Nj.A dhe për t'u bërë në mënyrë të konsiderueshme më e madhe se çdo bashki tjetër.

Tabela 17: Ndryshimet në bashkitë e PP

Ish NjQV		NjQV e re	
Emri	Popullsia (2014*)	Emri	Popullsia (2015*)
Komuna Bushat	18,096	Bashkia Vau i Dejës	39,800
Bashkia Cërrik	14,536	Bashkia Cërrik	42,100
Bashkia Tiranë	556,600	Bashkia Tiranë	741,400

* Popullsia e treguara këtu për vitin 2014 dhe 2015 janë vlerësime të bëra nga Projekti i bazuar në rezultatin e regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 dhe të dhënave të INSTAT-it. Detajet e vlerësimit janë shpjeguar në projekt Udhërrëfyesin 3R.

Partia në pushtet përmbysi opozitën për të fituar vende të reja të kryetarëve të bashkive në disa zona dhe gjithashtu bashkitë e Projektit Pilot u ndikuan duke pasur si pasojë zyrtarë të rinj në krye të aktiviteteve të projektit. Tabela e mëposhtme përmbledh ndryshimet në bashkitë pilot. Vetëm në janar të vitit 2016 çdo bashki pilot filloi funksionimin normalisht në bazë të sistemit të ri me buxhetin bashkiak të miratuar.

Tabela 18: Pasojat e zgjedhjeve në bashkitë e PP

Bashkia PP	Kryetari	Drejtori i ngarkuar me MMN	Zyrtarët e ngarkuar me aktivitetet e Projektit	Periudha e kohës kur u ndërpreu diskutimet mbi PP.
Bashkia Vau i Dejës	Ish kryetari i komunës Bushat është rizgjedhur si bashkiaku i Vau i Dejës.	Është i njëjti (emëruar zyrtarisht në fund shtator)	Është i njëjti (emëruar zyrtarisht në fund shtator)	Nga periudha e zgjedhjeve në qershor deri në konstituimin e këshillit të ri bashkiak në shtator 2015

⁵ Njësia e Qeverisjes Vendore (NjQV)

⁶ Njësitë Administrative (NjA)

Bashkia PP	Kryetari	Drejtori i ngarkuar me MMN	Zyrtarët e ngarkuar me aktivitetet e Projektit	Periodha e kohës kur u ndërprejnë diskutimet mbi PP.
Bashkia Cërrik	Është zgjedhur bashkiak i ri.	Ndryshuar (drejtori i ri që e ka mbajtur këtë pozicion në të kaluarën, u emërua në fund të shtatorit)	Është i njëjti (emëruar zyrtarisht në fund shtator)	Nga periudha e zgjedhjeve në qershor deri në konstituimin e këshillit të ri bashkiak në shtator 2015
Bashkia Tiranë	Është zgjedhur bashkiak i ri.	Është i njëjti (i emëruar zyrtarisht në mes janari 2016. Nga nëntori deri në janar 2016, në diskutimet mbi Projektin u caktua një person i përkohshëm.)	Është i njëjti (emëruar zyrtarisht në janar 2016)	Deri në nëntor nuk ishte caktuar asnjë dhe aktivitetet e projektit nuk mund të vazhdonin. Në janar 2016 pas ricaktimit të drejtorit, u informua Drejtori i Përgjithshëm mbi PP për aprovimin e tij.




Figura 1: Kufijtë e ri të bashkive dhe njësive të tyre administrative pas Reformës Territoriale




Figura 2: Kufijtë e qarqeve që përfshijnë bashkitë e reja pas Reformës Territoriale

6 Kundërmasa për sugjerimet që janë dhënë në vlerësimin përfundimtar

A Përfundimi i Udhërrëfyesit 3R dhe familjarizimi i homologëve të MM me përmbajtjen

A.1 Sugjerime

Draft Udhërrëfyesi 3R, që përfshin përshkrime mbi zbatimin e sistemit të monitorimit 3R dhe procedurat e rishikimit të Udhërrëfyesit, duhet të përfundohen mirë përpara përfundimit të periudhës së bashkëpunimit në mënyrë që Projekti të marrë opinione edhe nga palët e interesuara si ministritë e tjera, qeveritë vendore dhe agjencitë donatore. Më pas, opinionet duhet të përdoren për të përmirësuar cilësinë e Udhërrëfyesit. Rekomandohet që Udhërrëfyesi 3R të paraqesë sa më shumë të dhëna të mbledhura nga terreni të jetë e mundur pasi këto të dhëna të mbledhura në botën reale janë me të vërtetë të vlefshme dhe demonstrojnë forcën dhe përparësitë krahasuese të Projektit. Të dhënat do të lehtësojnë qeveritë vendore të marrin vendime të bazuara në dëshmi në lidhje me menaxhimin e mbetjeve dhe masat 3R.

Homologët e MM duhet të familjarizohen tërësisht me përmbajtjen si pronarë të Udhërrëfyesit. Ekipi i Ekspertëve është këshilluar të japë trajnim intensiv për homologët e MM për të thelluar kuptimin e tyre mbi Udhërrëfyesin.

A.2 Kundërmasa

a Sistemi i monitorimit për zbatimin dhe rishikimin e procedurave 3R të përfshihen në draft Udhërrëfyesin 3R

Shtohet Seksioni 2 për monitorimin, përditësimin, dhe procedurat e rishikimit në draft Udhërrëfyesin 3R. Përditësimet janë bërë çdo vit bazuar në informacionet e përmendura më poshtë. Sa i përket rishikimit, është përcaktuar një herë në çdo 5 vjet.

Draft Plan Veprimi 3R përfshin "fletën e monitorimit" ku bashkitë raportojnë ecurinë në hartimin dhe zbatimin e tij. Veç kësaj, u vendos të ndajnë këtë fletë monitorimi nga bashkitë drejt qarkut dhe nga qarku drejt Ministrisë së Mjedisit.

b Zyrtarët e MM të familjarizohen me Udhërrëfyesin 3R

Më 28 shkurt 2017 nga EEJ u mbajt një ligjëratë për zyrtarët e MM (tre persona) për Udhërrëfyesin 3R për të kuptuar thellësisht përmbajtjen e tij. Leksion shfrytëzoi planin e veprimit 3R të përgatitur nga bashkitë dhe synon të aftësojë për përzgjedhjen e aktivitetit 3R, vlerësimin e arsyeshmërisë dhe realizimit. Gjithashtu EEJ instruktroi për kuptimin më të thellë të sistemit të monitorimit të aktivitetit 3R dhe metodat e rishikimit të Udhërrëfyesit 3R.

c Shpjegime mbi Udhërrëfyesin 3R në seminarin mbi prezantimin e draft Udhërrëfyesit 3R

Bazuar në sa më sipër, Znj. Ledjana bëri prezantimin për shpjegimin e draft Udhërrëfyesit 3R zyrtarëve të bashkive dhe qarkut. Ajo ju përgjigj pyetjeve të pjesëmarrësve në mënyrën e duhur. Mund të konsiderohet se është përmirësuar kuptueshmëria e zyrtarëve të MM.

B Përgatitja e autorizimit për Udhërrëfyesin 3R brenda MM

B.1 Sugjerime

MM duhet të fillojë të përgatisë për autorizimin e Udhërrëfyesit 3R brenda saj në mënyrë që të njihet si një dokument i rëndësishëm teknik që bën pjesë tek dokumentet e politikave zyrtare mbi menaxhimin e mbetjeve.

B.2 Kundërmasa

EEJ konfirmoi nëpërmjet letrës së MM që Udhërrëfyesi 3R do të jetë një dokument teknik i MM. Prandaj, “draft” u prish nga titulli i Udhërrëfyesit 3R. Pas kësaj, EEJ boton Udhërrëfyesin 3R dhe ja dërgon personave të ngarkuar me menaxhimin e mbetjeve në 61 bashkitë dhe 12 qarqet.

Venddepozitimi përfundimtar i Sharrës dhe Bushatit janë Landfilldët e vetëm të miratuara zyrtarisht në Shqipëri, në Nëntor 2014. Mbetjet e njësive vendore pranë tyre transportohen në këto 2 vende, ndërkohë që shumica e njësive i trajtojnë vetë mbetjet e tyre brënda kufirit të tyre administrative duke qënë se nuk e përballojnë dot transportin për shkak të kufizimeve të kostos dhe mungesës së paisjeve të transportit. Edhe pse ndërtimi dhe operimi i venddepozitimeve përfundimtare nuk është çështje që trajtohet vetëm nga njësitë e qeverisjes vendore, dhe kërkon një periudhë të gjatë kohore, është e dëshirueshme që Qeveria Qëndrore dhe Qarku të marrë rolin e udhëzuesit për NjQV në mënyrë që situata e tanishme do të përmirësohet me përpjekjet e tyre.

B.6 Statusi financiar i menaxhimit të mbetjeve

Pothuajse asnjë njësi e qeverisjes vendore dinte statusin financiar të menaxhimit të mbetjeve në njësitë e tyre. Mund të supozohet se arsyet për këtë janë ; i) Tarifa e shërbimit për grumbullimin e mbetjeve grumbullohet zakonisht së bashku me tarifat e tjera të tilla si tarifa e pastrimit, ii) grumbullimi i mbetjeve realizohet nga kompanitë private së bashku me

shërbime të tjera publike që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbetjeve. Këto dy situata konsiderohen se e bëjnë të vështirë të kuptojmë statusin financiar (të ardhurave dhe shpenzimeve) të secilit shërbim të menaxhimit të mbetjeve.

Jo vetëm për menaxhimin e mbetjeve, por në përgjithësi, është thelbësore të kuptojmë gjendjen financiare për sigurimin e qëndrueshëm të shërbimeve publike. Dështimi për të bërë këtë mund të çojë në një ndikim negativ në të gjithë menaxhimin financiar të një Njësie të Qeverisjes Vendore. Për të shmangur këtë, është e dëshirueshme të prezantohen sisteme me anë të së cilit menaxhimi financiar mund të bëhet në mënyrë sistematike kur integrimi dhe shfuqizimi i NjQV-ve të jetë ekzekutuar.

1.1.5 Rekomandime

A Nevoja për themelimin Struktura Organizative për Menaxhimin e Mbeturinave

"Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve" përcakton Qarqet si organe përgjegjëse për të përgatitur dhe zbatuar Planin Zonal të Mbetjeve. Megjithatë, rezultati i Studimit tregon se roli i luajtur nga Qark në menaxhimin e mbetjeve është i kufizuara në krahasim me pritshmërinë e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve, ose shërbimet për menaxhimin e mbetjeve nga njësitet e qeverisë vendore nuk janë kryer në bashkëpunim të ngushtë me Qarqet.

Sipas ligji "për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" miratuar në 31 Korrik 2014, i cili ka hyr në fuqi në Shtator 2014, 373 njësitet aktuale të pushtetit vendor do të integrohen në 61 njësi. Roli dhe funksionet e pritshme të njësive të reja administrative mund të rishikohen pas riorganizimit të tyre. Mund të theksohet se ekziston një mospërputhje e roleve dhe përgjegjësive që pritshme nga Qarqet, mes "Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve" dhe "për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore". Përgjegjësitë aktuale të Qarqeve nën "Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve" është që të drejtojnë njësitet e qeverisjes vendore, ndërsa nën ligjin e ri "për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore", NjQV-të janë pozicionuar si entiteti i dytë ligjor pranë Qeverisë Qendrore dhe Qarqet si i tretë, me rolin e tyre të pritshmëm për të mbështetur NjQV.

Bazuar në rolet aktuale të Qarqeve dhe mospërputhjes së lartë përmendur që aktualisht ekziston në sistemin e menaxhimit të mbetjeve, është e nevojshme që të rishqyrtohen rolet dhe përgjegjësitë e Qeverisë Qendrore, Qarqeve dhe NjQV-ve në menaxhimin e mbetjeve të Shqipërisë në mënyrë që të përputhen me gjendjen aktuale dhe ligjet, duke marrë mundësinë e riorganizimit të njësive e qeverisjes vendore që do të ekzekutohet në 2015.

B Zhvillimi i venddepozitimeve përfundimtare

Sikundër u arrit në përfundim pas studimit, shumica e NjQV-ve i trajtojnë mbetjet brenda kufijve të tyre administrative, duke mos i transportuar në venddepozitimet e ligjshme. Reduktimi i mbetjeve dhe promovimi i 3R-ve janë të nevojshme në drejtim të së ardhmes së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, megjithatë, hapi i parë që duhet të ndërmerret në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve është realizimi i sistemit të grumbullimit dhe trajtimit adekuat të tyre. Krijimi i këtyre venddepozitimeve nuk do të zhvillojë vetëm trajtimin e duhur të mbetjeve, por do të kontribuojë gjithashtu për pakësimin e mbetjeve dhe promovimin e 3R-ve si sistem i ndërmjetëm trajnimit, të tillë si pajisje për ndarjen dhe riciklimin mund të instalohet në zona të tilla përfundimtare të depozitimit.

Është zakonisht e ditur se zhvillimi dhe funksionimi i venddepozitimeve përfundimtare nuk mund të mbartet vetëm nga NjQV, kryesisht për shkak të buxhetit të madh të nevojshëm. Prandaj, kërkohet që Qeveria Qendrore dhe Qarqet të marrin rol aktiv në zhvillimin e tyre.

C Ngritja e kapaciteteve të Njësive të Qeverisjes Vendore në menaxhimin e mbetjeve

Kapaciteti aktual i njësitë e qeverisjes vendore në menaxhimin e mbetjeve është i kufizuar, dhe përmirësimi i tyre nuk ka gjasa edhe pas riorganizimit të strukturave të njësive vendore. Ligji “për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore” përcaktojnë zbatimin e menaxhimit të mbetjeve dhe sigurimin e financave për zbatimin si rol të njësive të qeverisjes vendore. Kjo buron nga politika e decentralizimit për të transferuar përgjegjësitë nga qeveria qendrore tek pushteti vendor, megjithatë, është e vështirë për NjQV të gjejnë një mënyrë për tu pajtuar me situatën e tanishme duke qënë se njohuritë dhe përvojat e zotëruara nga oficerët në njësitë e qeverisjes vendore nuk janë të mjaftueshme.

Duke pasur parasysh rrethanat, kapacitetet e menjëhershme të nevojshme për nëpunësit e NjQV konsiderohen të jenë si më poshtë;

- Njohuri për përfitimin e mënyrave se si për të kuptojnë situatën e tanishme
- Njohuri në planifikim
- Aftësia për të kryer aktivitetet siç është planifikuar

Pikat e lartpërmendura në këtë fazë nuk kërkojnë zbatimin e rreptë, por më e rëndësishme është që kapacitetet do të zhvillohen për të kuptuar situatën e tanishme dhe për të marrë vendime për në këtë drejtimin. Kur këto kapacitete të zhvillohen, hapat e ardhshëm do të jenë;

- Fitimi i kapacitetit të menaxhimit financiar
- Fitimi i kapacitetit të menaxhimit të kontratës
- Shfrytëzimi i investimeve private

Për të zhvilluar kapacitetet e NjQV siç u përmend më sipër, është parashikuar që është e dobishme ndarja e njohurive/përvojës e Qeverisë Qendrore me NjQV, prandaj është i mirëpritur roli i Qeverisë Qendrore si udhëheqëse e NjQV. Përveç kësaj, mungesa e metodologjisë ose udhëzuesve të unifikuar në nivel kombëtar ose rajonal është duke e vështirësuar të kuptuarin e gjendjes së tanishme të gjenerimit të mbetjeve. Prandaj, dëshirohet që Qeveria Qendrore ose Qarqet të marrin rol udhëheqës për të zhvilluar udhëzime mbi metodologjinë dhe planifikimin për të realizuar hapa konkrete në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

2 Aktivitetet Lidhur me Përfundimin 2

3R Udhëzimi është bërë për aktivitetin që lidhet me Produktin 2. Aktivitetet e detajuara tregohen si më poshtë. Referojuni broshurës së ndarë për Udhëzimet 3R të krijuara.

2.1 Historia e botimit të Udhëzuesit 3R

Ky Udhërrëfyes është zhvilluar nga Ministria e Mjedisit (MM) e Republikës së Shqipërisë dhe Ekipi i Ekspertëve Japonezë (EEJ) nën projektin e bashkëpunimit teknik “Projekti për Minimizimin e Mbetjeve dhe Promovimin e 3R-ve” të Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (në vazhdim, Projekti), i cili ka filluar në Korrik 2014, si përgjigje e kërkesës nga qeveria Shqiptare për promovim të minimizimit të mbetjeve nëpërmjet 3R (Reduktim në burimet gjeneruese, Ripërdorim, dhe Riciklim) bazuar në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve.

Përpara zhvillimit të draft Udhërrëfyesit të parë në Korrik 2015, EEJ kreu Studimin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Njësitë e Qeverisjes Vendore, me anë të pyetësorit për çdo NjQV, si dhe ka realizuar studime bazë në tri njësi të qeverisjes vendore, të cilat ishin planifikuar si zona të zhvillimit të projektit pilot. Bazuar në rezultatet e studimeve, në Mars 2015 MM dhe JET diskutuan dhe ranë dakord për aspektet e mëposhtme, dhe u vendosën si politika bazë për formulimin e “Udhërrëfyesit 3R

- Objektivat e zhvillimit të Udhëzuesit 3R.
- Përbërja e Udhërrëfyesit 3R.
- Korniza për planifikimin përfshirë popullsinë në të ardhmen, sasinë e mbetjeve në të ardhmen e kështu me radhë.
- Viti i synuar dhe shifrat e synuara për promovimin e 3R

Gjithashtu u konfirmua se pikat e mëposhtme do të përfshihen në “Përbërjen e Udhërrëfyesit 3R”.

- Procedura të zhvillimit të Planit të Veprimit 3R për zbatim të 3R-ve.
- Procese dhe metoda për zbatim të aktiviteteve 3R.

Përmbajtja specifike të secilit aspekt të rënë dakord janë pasqyruar dhe përfshirë në Udhëzimin.

Përmbajtja e draftit të parë, veçanërisht e “Plan Veprimi 3R për të zbatuar Projektin Pilot 3R (3R-PP)”, do të rishikohet pas zbatimit të projekteve pilot në tre NjQV e synuara gjatë një periudhe prej rreth 1.5 vjet, nëpërmjet projektit, dhe do të rishikohet për të hartuar draftin përfundimtar të Udhërrëfyesit.

Njësia e “NjQV” përmendur në Udhërrëfyes i referohet ndarjes së mëparshme territoriale shqiptare, e cila ka egzistuar deri në periudhën e reformës territoriale. Në Shtator 2015 (dhe përfshinte Bashkitë dhe Komunat). Fillimisht, u krijua rryma e mbetjeve për çdo njësi vendore bazuar në rezultatet e vëzhgimit. Rryma e mbetjeve për njësitë e reja vendore u krijua duke bashkuar rrymat e mbetjeve të njësive që formojnë njësitë e reja administrative.

Termi “mbetje” në Udhërrëfyes i referohet “mbetjeve bashkiake” ose “mbetjeve urbane”, dhe nënkupton mbetjet nga familjet ose mbetje të ngjashme (zbrazur nga zyrat ose bizneset e vogla), të cilat grumbullohen nga shërbimi i ofruar nga bashkia. Për më tepër, “mbetjet” në Udhërrëfyes përfshijnë mbetjet mjeksore dhe industriale.

2.2 Formulimi i Udhërrëfyesit 3R


2.2.1 Sfondi për zhvillimin e Udhërrëfyesit 3R

MMN i papërshtatshëm, veçanërisht krijimi i pamjaftueshëm i venddepozitimeve përfundimtare ka qenë një çështje kritike për shumë NjQV në Shqipëri. Në mënyrë që të ofrojë një zgjidhje për këtë gjendje ndërsa vendi nxit ndërtimin e landfilleve rajonal në nivel qarku, kërkohet urgjentisht pakësimi i sasisë së mbetjeve të trajtuara në venddepozitimin përfundimtar duke zbatuar MIMN, që përfshin praktikën e 3R

Qeveria shqiptare, me qëllim anëtarësimin në BE, ka zhvilluar Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve në përputhje me direktivat e BE-së, dhe ka përcaktuar si qëllim pakësimin e sasisë përfundimtare të depozituar me 55 % në vitin 2020 krahasuar me vitin 1995. Konsiderohet si e padiskutueshme sjellja në Shqipëri e aktiviteteve 3R nga vendet e tjera të BE, por ajo që ka qenë efektive në këto vende mund të mos jenë të përshtatshme për tu zbatuar në Shqipëri, si rezultat i ndryshimit të gjendjes së menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe mjedisit social lidhur me 3R-në.

Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve që përcaktohet në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve krahasohet me përcaktimet 3R përshkruar në Udhërrëfyes.

Tabela 1: Krahasimi me hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve promovuar në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve në Shqipëri dhe përcaktimi i 3R në këtë Udhërrëfyes.

Opsioni më i favorshëm 	Përkufizimet në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve	Përkufizimet e 3R në Udhërrëfyes	
	1. Parandalim	1. Reduktim	Vetëdije dhe veprime për pakësim të mbetjeve para prodhimit të mbetjeve. Si rezultat i rritjes së popullsisë dhe përmirësimit të standardit të jetës, reduktimi i mbetjeve nuk është vetëm politikë për të zvogëluar një mbetje me ligj dhe me rregullore apo përpjekje e kompanisë për të prodhuar një mall, por edhe veprimi nga banorët bëhet i rëndësishëm.
	2. Përgatitje për ripërdorim	2. Ripërdorim	Mbetjet e prodhuara pas tentativës të pakësimit të mbetjeve ripërdoret ose riciklohet sa më shumë të jetë e mundur.
	3. Riciklim	3. Riciklim	
	4. Rigjenerim		
	5. Depozitim	Depozitim	Vetëm pas përpjekjes së pakësimit të mbetjeve, ripërdorimit ose riciklimit, mbetjeve të grumbulluara si duhet, trajtuar dhe depozituar në mënyrën e duhur, pa ndikime negative mjedisore.

2.2.2 Lidhja ndërmjet menaxhimit të mbetjeve dhe 3R

Promovimi i 3R është i lidhur ngushtë me Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta Bashkiake (MMNB). MMNB mund të shprehet në formën e një Rryme Mbetjesh të përbërë kryesisht nga 1. prodhimi,

2. zbrazja, 3. grumbullimi dhe transporti, 4. procesi i ndërmjetëm dhe 5. depozitimi përfundimtar. Ndër veprimet e 3R (Ripërdorim, Reduktim, Riciklim) së mbetjeve, Reduktimi zhvillohet kryesisht në burimet e prodhimit dhe Ripërdorimi dhe Riciklimi praktikohen në disa faza në Rrymën e Mbetjeve. Më konkretisht, Riciklimi kryhet në fazat e mëposhtme;

- Riciklimi në vend ku, në burimin e prodhimit (familje), mbetja e kuzhinës riciklohet si kompostim dhe/apo ushqim për bagëtinë dhe mbetjet e drurit nga kopshtet përdoret si dru zjarri.
- Materialet e riciklueshme mblidhen në vendin e zbrazjes nga grumbulluesit e mbetjeve
- Materialet e riciklueshme mblidhen në venddepozitimin përfundimtar nga grumbulluesi i mbetjeve
- Riciklimi në impiantet e kompostimit dhe/apo ndarjes

Deri tani nuk është integruar asnjë implant i trajtimit të ndërmjetëm në menaxhimin e mbetjeve në NjQV-të e Shqipërisë. Burimi i prodhimit të mbetjeve janë të kufizuara në familjare dhe jo familjare përfshirë bizneset dhe aktivitetet e pastrimit publik e kështu me radhë, sepse importi në vend i materialit të riciklueshëm është i ndaluar nga qeveria Shqiptare

Lidhja midis menaxhimit të mbetjeve dhe 3R tregohet në Figura 1.




Figura 1: Rryma e Mbetjeve dhe 3R e mbetjeve

2.2.3 Objektivat për zhvillimin e Udhërrëfyesit 3R

Objektivat kryesore të Udhërrëfyesit 3R janë të mbështesë aktivitetet 3R zbatuara nga NjQV-ja mënyrë që të jenë më efektive dhe të qëndrueshme dhe për të promovuar 3R në gjithë Shqipërinë, sic është përshkruar më parë.

Në anën tjetër, pakësimi i mbetjeve përmes 3R nuk mund të jetë e pavarur nga menaxhimi i mbetjeve të ngurta siç përmendet në seksionin e mësipërm, ndaj zbatimi i MMN është prezumimi i zbatimit të suksesshëm 3R. Megjithatë, edhe pse Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve kërkon çdo rajon dhe NjQV të zhvillojnë planin e tyre të menaxhimit të mbetjeve, i cili duhet të jetë një udhërrëfyes për NjQV-të për të zbatuar MMN, dhe të zbatojë planin e tyre të veprimit, vetëm plane rajonale të menaxhimit të mbetjeve janë dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit, por nuk është miratuar ende. Për këtë arsye është e drejtë të konsiderojmë së Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve nuk është vënë në praktikë plotësisht.

Formulimi i Udhërrëfyesit 3R do të mbështesë zbatimin në praktik të politikave 3R, të cilat janë përcaktuar në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, dhe do të kontribuojë në përmirësimin e situatës në aspektin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në përgjithësi. Më

konkretisht;

- NjQV-ja zbaton 3R aktivitete 3R, planveprimi i 3R zhvillohet në përputhje me Udhërrëfyesin 3R. Nëpërmjet këtij procesi, Udhërrëfyesi 3R gjithashtu mbështet NjQV-në të zhvillojë planin e menaxhimit të mbetjeve
- Udhërrëfyesi 3R mbështet një NjQV të zbatojë aktivitete 3R. Nëpërmjet këtij procesi, Udhërrëfyesi 3R mbështet realizimin e veprimeve që synojnë menaxhimit të mbetjeve në planin e tyre. planin e tyre.




Figura 2: Pozicionimi i Udhërrëfyesit 3R në MMN në Shqipëri

2.2.4 Përbërja e Udhërrëfyesit 3R

Udhërrëfyesi 3R përbëhet nga 3 aspekte që përfshijnë “Politikën Kombëtare të 3R-ve”, “përzgjedhja e aktiviteteve 3R”, dhe “zbatimi i aktiviteteve 3R nga NjQV-të,” siç tregohet në Figura 3.

Në këtë aspekt të Politikës Kombëtare të 3R-ve, gjendja e tanishme dhe problemet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Shqipëri dhe politika bazë e 3R-ve përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta janë për tu qartësuar.

Në kuadër të “përzgjedhjes së aktiviteteve 3R”, do të përzgjidhen aktivitetet 3R, që janë të realizueshëm në kontekstin e sotëm shqiptar, pas shqyrtimit të aktiviteteve të zakonshme 3R nën kushte të caktuara. Pikëpamje dhe çështje të rëndësishme për t’u konsideruar për NjQV-të për zbatimin e aktiviteteve 3R duhet gjithashtu të përmbledhen, duke marrë në konsideratë efektet e tyre në menaxhimin e mbetjeve të ngurta.

NjQV-të e interesuara do të hartojnë Planet e tyre të Veprimit 3R në përputhje me Politikën kombëtare të 3R. NjQV-të do të planifikojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë Projektet Pilot 3R bazuar në Planin e Veprimit 3R dhe përfshijnë gjetjet e tyre për të përmirësuar Planin e tyre të Veprimit.




Figura 3: Përbërja e Udhërrëfyesit 3R

2.2.5 Hapat për Formulimin dhe Përditësimin e Udhërrëfyesit 3R

Udhërrëfyesi 3R përbëhet nga 8 kapituj kryesor dhe kapitulli i 9-të që janë shtojcat. Përmbajtja e udhërrëfyesit 3R është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Kapitulli 1 deri në 3 në këtë Udhërrëfyes përshkruan procesin deri në pikën e vendosjes të qëllimeve të objektivizmit numerikisht të politikës kombëtare për 3R dhe tregohet në gjysmën e parë të Hapit 1 në figurën e mësipërme. Në kapitullin 4, një listë e plotë të aktiviteteve standarde 3R është zhvilluar më tej nga lista, dhe janë përzgjedhur aktivitete 3R të cilat janë të mundshme në Shqipërinë e tanishme dhe në të ardhmen e afërt. (në vazhdim “Aktivitete të Rekomanduara 3R”)

Kapitulli 5 shpjegon procedurat e përzgjedhjes dhe zbatimit të aktiviteteve të përshtatshme 3R të cilat do të testohen dhe të verifikohen në NJQV pilote. Kjo pjesë është treguar në pjesën e dytë të Hapit 1 në figurën e mësipërme si dhe në Hapin 2, ku secila NJQV do të zhvillojë Planin e Veprimit 3R dhe zbatoj aktivitetet 3R.

Për më tepër, si reference për NJQV-të që të zbatojnë aktivitete 3R, Kapitulli 6 përmban shembuj aktual të disa Aktiviteteve të Rekomanduara 3R të zbatuara në NJQV pilot dhe Kapitulli 7 prezanton shembuj të tjera specifik të Aktiviteteve të Rekomanduara 3R

Udhërrëfyeti 3R synohet të lexohet kryesisht nga organizatat e mëposhtme.

Tabela 2: Përmbajtja e Udhërrëfysit 3R dhe organizatat që synon

Numri	Përmbajtja	Organizatat e synuara		
		Qeveria Qëndrore	Regional government	Local government unit
Kryesor				
Kapitulli 1	Historiku i publikimit të Udhërrëfyesit 3R	○	○	–
Kapitulli 2	Formulimi i Udhërrëfyesit 3R	○	○	–
Kapitulli 3	Gjendja e tanishme dhe çështje të të menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe 3R-ve.	○	○	–
Kapitulli 4	Përcaktimi i qëllimeve për promovimin e 3R-ve	○	○	–
Kapitulli 5	Procure to select 3R activities feasible in Albania	○	○	○
Kapitulli 6	Implementation of 3R activities by LGUs	△	△	○
Kapitulli 7	3R action plan formulated by local governments	△	△	○
Kapitulli 8	Examples of 3R activity	△	△	○
Shtojca				
1	Nationwide Survey on Waste Management Practices	○	○	△
2	Manual for waste amount and waste composition survey	△	△	○
3	Results of waste amount and waste composition survey	○	○	△
4	Waste flow in target local government units	△	△	○
5	Form for formulation of 3R action plan in local government unit	△	△	○
6	Draft 3R action plan (Tirana municipality)	○	○	○
7	Draft 3R action plan (Cerrik municipality)	○	○	○
8	Draft 3R action plan (Vau i Dejes municipality)	○	○	○
9	Excel file for formulation of waste flow (Current situation and Future)	–	–	○

○: Shumë e rekomanduar, △: E rekomanduar, –: Nuk aplikohet




Figura 4: Hapat për formulimin dhe përditësimin e Udhërrëfyesit 3R

2.2.6 Përditësimi dhe rishikimi i Udhërrëfyesit 3R

A Monitorimi

Roli i MM përcaktohet në mbështetjen dhe promovimin e zbatimit të menaxhimit mbetjeve në nivel Kombëtar. Aktivitetet 3R janë pjesë e menaxhimit të mbetjeve ndaj kërkohet që MM të promovoj aktivitetet 3R. Para se të mbështesë dhe promovoj aktivitetet 3R, MM do të kuptoj aktivitetet aktuale 3R në nivel njësisë së qeverisjes vendore. Rekomandohet që të vizitohen të gjitha njësitë vendore nga MM, sidoqoftë kjo mund të mos jetë e mundur, ndaj MM mund të kuptojë gjëndjen e tanishme me anë të fletës së mëposhtme të monitorimit.

Tabela 3: Fletë monitorimi për aktivitetet 3R

Emri i Bashkisë:		
Emri i Qarkut:		
Data e Raportit:		
Përshkrim		
1	Draft Plan Veprimi 3R në përgatitje	Data e publikimit: Për vitin nga në (plan 5-vjeçar)
2	Drafti është përgatitur. Pritet miratimi nga këshilli bashkiak.	Data e miratimit:
3	Miraturar nga këshilli bashkiak. Në pritje të ndarjes së buxhetit për zbatimin e aktiviteteve.	Data e ndarjes së buxhetit:
4	Ecuria e Aktiviteteve 3R	
(1)	Emri i aktivitetit	Ecuria:
		Problemet (nëse ka):
(2)	Emri i aktivitetit	Ecuria:
		Problemet (nëse ka):
(3)	Emri i aktivitetit	Ecuria:
		Problemet (nëse ka):

Ju lutem ndani me bashkitë e tjera mësimet e nxjerra
(përvojat tuaja që çuan në formulimin e suksesshëm apo penguan procesin e formulimit të Planit të Veprimit 3R për bashkinë tuaj):

Është përcaktuar se "MM do të menaxhojë aktivitetet e njësisë së qeverisjes vendore nëpërmjet qarqeve" ndaj, fleta e monitorimit do të dërgohet dhe mblidhet duke ndjekur këtë rrugë.




Figura 5: Dërgimi dhe mbledhja e fletës së monitorimit

B Përditësimi i Udhërrëfyesit 3R

MM mbledh informacionin mbi aktivitetet të cilat nuk përfshihen në “8.2 Prezantimi i Aktiviteteve 3R” në Udhërrëfyesin 3R ose mbi aktivitetet e përmirësuara. MM do të përmbledhë pikat e aktiviteteve të detajuara, përmirësimin dhe efektivitetin dhe të informojnë publikun. Për më tepër MM, ia shton përmbajtjen në “8.2 Prezantimi i Aktiviteteve 3R” në Udhërrëfyesin 3R. Do të kryhet një herë në vit.

Tabela 4: Shëmbull i përditësimit të Udhërrëfyesit 3R

Përshkrimi	Më parë	Përditësimi
Emri i aktivitetit 3R	1. Reduktim	1. Reduktim
	1.2 Edukimi në shkollë (Nivel Kombëtar)	1.2.(1) Edukimi në shkollë fillore dhe të 9 vjeçare(Në nivel komuniteti)
Mbetjet e synuara	Mbetje bashkiake	Mbetje bashkiake

Përshkrimi	Më parë	Përditësimi
Përmbledhje	Duke përfshirë edhe problemet aktuale që lidhen me problemet e mjedisit, duke përfshirë mbetjet dhe njohjen e rëndësisë së ruajtjes së Mjedisit në kurrikulën e arsimit shkollor si edukim mjedisor.	Duke përfshirë edhe problemet aktuale që lidhen me problemet e mjedisit duke përfshirë mbetjet dhe njohjen e rëndësisë së ruajtjes së Mjedisit në programin mësimor Rregullorja duhet të paraqesin që shkolla fillore dhe të mesme do të përfshijnë edukimin mjedisor në programin e tyre.
Pika që duhen mare parasysh për zbatim	• Shqyrtimi i sistemit arsimor • Rishikimi i kurrikulave dhe programeve të edukimit mjedisor • Trajnim i mësuesëve • Zhvillimi i materialeve të edukimit mjedisor	• Shqyrtimi i sistemit arsimor • Rishikimi i kurrikulës dhe programeve të edukimit mjedisor • Trajnim për mësuesit e shkollave fillore dhe të mesme • Zhvillimi i materialeve të edukimit mjedisor • Miratim i rregullores


C Rishikimi i Udhërrëfyesit 3R

Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve. Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve po planifikohet të rishikohet nga GIZ, sipas informacionit në Janar 2017. Kur strategjia dhe plani i veprimit të rishikohen, MM duhet të rishikoj përmbajtjen e Udhërrëfyesit 3R përputhje me to. Gjithashtu MM do të rishikoj Udhërrëfyesin 3R bazuar në informacionin e “Praktikës së mirë” dhe “Aktiviteteve të reja” dhënë nga Njësitë e Qeverisjes Vendore. Do të bëhet njëherë në pesë vjet.

3 Aktivitetet Lidhur me Përfundimin 3 (Bashkia Vau i Dejës)

3.1 Përmbledhje mbi Bashkinë

3.1.1 Përshkrimi Gjeografik



3.1.2 Informacioni Baza

Nr.	Njësia Administrative	Administrimi para bashkimit	Banorë	Familje	Shënime
1	Bushat	Komunë	18,096	4,585	Ka popullsinë më të madhe edhe pse nuk është qendër e Bashkisë
2	Vau i Dejës	Bashki	10,800	2,734	Qendra e Bashkisë me një hidrocentral të madh
3	Hajmel	Komunë	5,900	1,494	Nj.A e mesme e Bashkisë
4	Vig-Mnele	Komunë	2,000	506	Njësi e vogël në zonën malore
5	Shllak	Komunë	900	228	Njësi e vogël në zonën malore
6	Temal	Komunë	2,100	532	Njësi e vogël në zonën malore
7	Gjithsej		39,796	10,079	

3.1.3 Shërbimi i Grumbullimit të Mbetjeve

Nr	Njësia Administrative	Numri i Kontejnerëve të Vendosur	Sasia e Grumbulluar e Mbetjeve (ton/muaj)	Sasia e Grumbulluar e Mbetjeve (ton/ditë)	Shpeshtësia e Shërbimit të Grumbullimit	Përgjegjësia
1	Bushat	297	154.61	5.2	1 herë / javë	NKZ me kompaktorin e bashkisë
2	Vau i Dejës	120	74.33	2.5	1 herë / javë	NKZ me kompaktorin e vet
3	Hajmel	69	40.03	1.3	1 herë / javë	NKZ me kompaktorin e vet
4	Vig-Mnele	0	0	0	Pa shërbim	
5	Shllak	0	0	0	Pa shërbim	
6	Temal	0	0	0	Pa shërbim	
7	Gjithsej	486	268.97	9.00		



Zbrazja e kontejnerit në kompaktor



Brenda kontejnerit



Kontejnerët e grumbullimit të mbetjeve të vendosur në bashki

3.1.4 Mjetet e Grumbullimit të Mbetjeve

	
Kompaktor i Bashkisë Vau i Dejës (AA753IY)	Kamionçinë e Bashkisë Vau i Dejës (AA396AR)
	
Ngarkues i Bashkisë Vau i Dejës	Kompaktor i Ndërkomunales Zadrime (AA492GN)

3.1.5 Landfilli



Pamje e Landfillit

Tabela 5: E mbeturinave mbante shuma e landfillit

	Bashkia Lezhë	Bashkia Shkodër	Bashkia Vau i Dejës	Privatë të tjerë	Gjithsej
Janar	474.22	2,140.90	203.00	187.40	3,005.52
Shkurt	450.18	1,994.96	204.14	146.20	2,795.48
Mars	516.82	2,322.84	304.50	229.01	3,373.17
Prill	552.62	2,662.88	274.20	169.68	3,659.38
Maj	576.50	2,673.90	233.94	162.93	3,647.27

Qershor	671.28	2,843.88	248.04	97.48	3,860.68
Korrik	1,062.88	3,149.06	289.18	57.56	4,558.68
Gusht	1,244.72	3,026.42	359.76	476.22	5,107.12
Shtator	693.50	2,535.64	303.94	280.34	3,813.42
Mesatarja Mujore	693.64	2,594.50	268.97	200.76	3,757.86
Mesatarja Ditore	22.78	85.22	8.83	6.59	123.43

	Bashkia Lezhë	Bashkia Shkodër	Bashkia Vau i Dejës	Privatë të tjerë	Gjithsej
Mesatarja Mujore	249,015	931,425	96,559	72,071	1,349,071
Mesatarja Ditore	8,179	30,594	3,172	2,367	44,313

3.1.6 Gjendja Financiare


Njësia Administrative	Numri i Familjeve	Tarifa e Mbetjeve e Familjeve (Lekë/Vit)	Të ardhurat Teorike nga Familjet (milionë Lekë/Vit)	Norma e Grumbullimit të Tarifës nga Familjet (%)	Llogaritja e të ardhurave gjithsej të mbledhura (milionë Lekë/Vit)
Bushat	4,585	1,200	5.50	211.6% ¹	11.64
Vau i Dejës	2,734	1,200	3.28		6.94
Hajmel	1,494	1,200	1.79		3.79
Vig-Mnele	506		0.00		0.00
Shllak	228		0.00		0.00
Temal	532		0.00		0.00
Gjithsej	10,079		10.58		22.38

※ Kjo ka dalë nga llogaritja në bazë të mesatares kombëtare në vend të të ardhurave të tanishme.

¹ Norma mesatare nxjerrë nga sondazhi kombëtar mbi Planin e Veprimit 3R. Është koeficienti i të ardhurave gjithsej

3.2 Përmbledhje e Njesisë Administrative Bushat

3.2.1 Përshkrimi Gjeografik



Krijuar nga EEJ, informacioni i kufijve marrë nga Njësia Administrative Bushat

3.2.2 Informacioni Bazë

Tabela 6: Popullsia dhe familjet për çdo fshat në Nj.A Bushat

		Regjistri i Z.Gj.C		Emigrantë		Banorë	
		Familje	Popullsia	Familje	Popullsia	Familje	Popullsia
1	Bushat	708	2,740	185	700	523	2,040
2	Shkjeze	270	1,119	18	71	252	1,048
3	Pleshe	174	764	32	126	142	638
4	Stajke	693	2,783	118	456	575	2,327
5	Ashte	250	986	84	299	166	687
6	Kosmace	609	2,450	44	134	565	2,316
7	Melgushe	719	2,718	170	655	549	2,063
8	Konej	203	681	66	285	137	396
9	Rranxa	864	3,544	390	1,610	474	1,934
10	M.Jushit	228	885	61	225	167	660
11	F.Ri	201	861	38	162	163	699
12	Barbullush	1,029	4,048	332	1,466	697	2,582
13	Hoten	109	480	40	163	69	317
14	Kukel	180	675	74	286	106	389
	Gjithsej	6,237	24,734	1,652	6,638	4,585	18,096

3.2.3 Shërbimi i Grumbullimit të Mbetjeve

Tabela 7: Shërbimi i Grumbullimit

Nr	Njësia Administrative	Numri i Kontejnerëve të Vendosur	Sasia e Grumbulluar e Mbetjeve (ton/muaj)	Sasia e Grumbulluar e Mbetjeve (ton/ditë)	Shpeshtësia e Shërbimit të Grumbullimit	Përgjegjësia
1	Bushat	297	154.61	5.21	herë / javë	NKZ me kompaktorin e bashkisë
2	Vau i Dejës	120	74.33	2.51	herë / javë	NKZ me kompaktorin e vet
3	Hajmel	69	40.03	1.31	herë / javë	NKZ me kompaktorin e vet
4	Vig-Mnele	0	0	0	Pa shërbim	
5	Shllak	0	0	0	Pa shërbim	
6	Temal	0	0	0	Pa shërbim	
7	Gjithsej	486	268.97	9.00		

Tabela 8: Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve në çdo fshat në Nj.A Bushat

		Banorë			Numri i kazanëve të vendosur	Mesatarja e Kontejnerëve për Frymë
		Familje	Popullsia	Norma e Shpërndarjes		
1	Bushat	523	2,040	11.3%	88	23.2
2	Shkjeze	252	1,048	5.8%	18	58.2
3	Pleshe	142	638	3.5%	9	70.9
4	Stajke	575	2,327	12.9%	33	70.5
5	Ashte	166	687	3.8%	13	52.8
6	Kosmaç	565	2,316	12.8%	30	77.2
7	Melgushe	549	2,063	11.4%	27	76.4
8	Konej	137	396	2.2%	7	56.6
9	Rranxa	474	1,934	10.7%	19	101.8
10	M.Jushit	167	660	3.6%	0	
11	F.Ri	163	699	3.9%	5	139.8

		Banorë			Numri i kazanëve të vendosur	Mesatarja e Kontejnerëve për Frymë
		Familje	Popullsia	Norma e Shpërndarjes		
12	Barbullush	697	2,582	14.3%	44	58.7
13	Hoten	69	317	1.8%	0	
14	Kukel	106	389	2.1%	9	43.2
	Gjithsej	4,585	18,096	100.0%	302	59.9

Tabela 9: Përmbledhje e gjendjes së grumbullimit të mbetjeve

Ofruesi i Shërbimit	Komuna Bushat	Pa Shërbim	Gjithsej
Numri gjithsej i fshatrave	12	2	14
Popullsia Gjithsej	17,119	977	18,096
Familje Gjithsej	4,349	236	4,585

3.2.4 Tarifa e Mbetjeve

Tabela 10: Taksa e Mbetjeve në Nj.A Bushat

Përmbledhëse e tarifës së pastrimit për kategori				
Subjektet Kategoritë	Njësia	Për 2014	Për 2015	Për 2016
Familje	Lekë/Vit	1,200	1,200	1,200
OJF	Lekë/Vit	3,000	3,000	3,000
Biznes me xhiro 0-8000000	Lekë / m2 / Vit	100	100	100
është kosto e llogaritur e mbulimit me shërbim dhe rezultati m2/vit				
Ambulantët	Lekë/Vit	5,000	5,000	5,000
Profesionet e lira				
Farmacistë dhe dentistë	Lekë/Vit	20,000	20,000	20,000
Transporti i pasagjerëve (ndër urbanë + taksi)				
Mjete 8-25 vende	Lekë/mjet/vit	7,000	7,000	7,000
Mjete mbi 25 vende	Lekë/mjet/vit	10,000	10,000	10,000
Transport mallrash				
Mjete deri 10 ton	Lekë/mjet/vit	7,000	7,000	7,000
Mjete mbi 10 ton	Lekë/mjet/vit	10,000	10,000	10,000
Personat juridik				
Tregtia me pakicë e karburantit		60,000	60,000	60,000
Subjektet juridike për prodhimin e asfalto-betonit, blloqe, tulla, etj.		60,000	60,000	60,000
Subjektet juridike të ndërtimit të regjistruara në Komunën Bushat		50,000	50,000	50,000
Subjekte të shërbimit tregtar (telefoni, internet, telefoni celulare, subjektet e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë etj.)		60,000	60,000	60,000
Subjektet juridike "VIP"		500,000	500,000	500,000
Subjekte shërbimi (siguracione, transporti, loto-sport, Banka, etj.		50,000	50,000	50,000
Subjekte juridike që tregtojnë artikuj të ndryshëm		60,000	60,000	60,000
Subjekte juridike që prodhojnë mish, qumësht (stalla derrash, lopësh)		60,000	60,000	60,000
Institucione				
Qendra shëndetësore	-			
Shkolla (11 shkolla)	-			
Tarifa për çdo subjekt që kryen projektin në komunë (Leke / projekt / vit) për çdo vend ndërtimi				
Vlera e investimit deri në 5 000 000 Lekë		20,000	20,000	20,000
Vlera e investimit 5 000 001 – 10 000 000 Lekë		40,000	40,000	40,000

Vlera e investimit 10 000 001 – 20 000 000 Lekë	60,000	60,000	60,000
Vlera e investimit 20 000 001 – 30 000 000 Lekë	70,000	70,000	70,000
Vlera e investimit 30 000 001 – 40 000 000 Lekë	80,000	80,000	80,000
Vlera e investimit 40 000 001 – 50 000 000 Lekë	100,000	100,000	100,000
Vlera e investimit 50 000 001 – 100 000 000 Lekë	150,000	150,000	150,000
Vlera e investimit 100 000 001 – 200 000 000 Lekë	200,000	200,000	200,000
Vlera e investimit mbi 200 000 000 Lekë	500,000	500,000	500,000

3.3 Projekti Pilot në Njësinë Administrative Bushat

3.3.1 Përmbledhje e Projektit Pilot

Projektet Pilot u planifikuan e zbatuan sipas tabelës më poshtë bazuar në vëzhgimet dhe diskutime.

Tabela 11: Përmbledhje e PP

PP Nj.A Bushat ² (Bashkia Vau i Dejës)	
Zona e synuar	Nj.A Bushat
Përmbledhje synimeve	14 fshatra me mbi 4,600 familje, rreth 300 kontejnerë mbetjesh
Parimet bazë	1. Të gjejë metodën efektive për pakësimin e mbetjeve që do dërgohen në landfill nëpërmjet zbatimit me faza të PP. 2. Fokusohet veçanërisht në mbetjet bujqësore dhe të gjelbra, pasi në zonë ka shumë të tilla që zbrazen. Do të ofrojë një model të caktuar për zonat e tjera me të njëjtat karakteristika. 3. Në vend të qasjes së menjëhershme të aktiviteteve të pakësimit, së pari ngrihet nga bashkia një sistem grumbullimi i përshtatshëm dhe mënyrë zbrazjeje nga qytetarët ku përfshihet si të trajtohen mbetjet bujqësore. 4. Më pas, do të shqyrtohet mënyra e pakësimit të mbetjeve.
Përmbledhje PP	Faza 1: Të sigurojë që shërbimi i përshtatshëm i grumbullimit të mbetjeve të ofrohet nga bashkia. Faza 2: Të vendosë një sistem të përshtatshëm zbrazje mbetjesh që të pranohet dhe ndiqet nga banorët. Faza 3: Të vendosë një metodë të përshtatshme për pakësimin e mbetjeve.

3.3.2 Faza 1, Përmirësimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve

A Tabela e përmbledhjes

Tabela 12: Përmbledhje e fazës 1

Faza 1 (Shtator, 2015 – Prill, 2016)	
Titulli	Të sigurojë një shërbim të përshtatshëm grumbullimi mbetjesh të ofruar nga bashkia
Zona e synuar	I gjithë territori i Nj.A Bushat
Shtrirja synuar	14 fshatra me rreth 4,600 familje, rreth 300 kontejnerë mbetjesh
Çështjet	1. Mbetjet zbrazen jashtë kontejnerëve të mbetjeve, që e bën të vështirë përdorimin e kompaktorit për grumbullimin e mbetjeve. Për pasojë shërbimi i bashkisë për grumbullimin e mbetjeve bëhet i çrregullt,

² Njësia Administrative (Nj.A)

	ndërsa arsyeja tjetër është se buxheti bashkiak është i vogël pas reformës territoriale. 2. Shërbimi i tillë i paqëndrueshëm i grumbullimit të mbetjeve shkakton një rreth vicioz ku njerëzit i zbrazin mbetjet në mënyrë të përsëritur të çorganizuar kur ata shikojnë parregullsi në vendet e zbrazjes.
Objektivat	Para së gjithash, kjo tregon shërbim grumbullimi gjithëpërfshirës, të njehsuar mbi profilet dhe çështjet dhe për të kuptuar gjendjen. Në mënyrë që të fitojnë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e banorëve, kryhet shërbim i shpeshtë dhe i rregullt i grumbullimit të mbetjeve.
Synimet	1. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve në zonën e ish komunës Bushat (14 fshatra) do të njehsohet dhe ofrohet nga një burim duke vënë në përdorim kompaktorin e bashkisë 2. Të gjithë kontejnerëve në 14 fshatra do tu shërbehet me mjet të paktën një herë në javë. 3. Dokumenti i buxhetit do të hartohet për vitin 2016 me shpeshtësitë e sipërpërmendura për të siguruar buxhetin për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve 4. Informacionet e marra nga zbatimi i provës së shërbimit të grumbullimit do të përdoren në hartimin e aktiviteteve në Fazën 2.
Procedura	1. Të caktojë rrugën dhe programin e mundshëm të grumbullimit 2. Të fillojë testimin e shërbimit të grumbullimit sipas programit të hartuar 3. Të kuptojë koston dhe efikasitetin e grumbullimit në bazë të regjistrimeve të mbajtura gjatë zbatimit të grumbullimit të mbetjeve 4. Të rishikojë programin bazuar në rezultatet e testimit të grumbullimit, dhe ta ndryshojë nëse është e nevojshme. 5. Të hartojë draft buxhetin për menaxhimin e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve me kostot e bashkisë nga viti 2016.

B Gjendja e zbatimit



Figura 6: Mjetet në zotërim të bashkisë



Figura 7: Një shembull i gjendjes së punës së grumbullimit të mbetjeve

U deshën 45 minuta për të pastruar vetëm një kontejner. Jo gjithë kontejnerët janë në këtë

gjendje, por nuk janë të paktë kontejnerët problematikë.

Ecuria e PP tregoi se shërbimi i rregullt i grumbullimit me kompaktor është më efektiv se me kamionçinë. Gjithsesi, është ende e domosdoshme të ndryshohet mënyra e zbrazjes nga banorët për të përmirësuar efikasitetin në maksimum.

Duhet rreth 5 minuta për të pastruar një kontejner nëse mbetjet janë zbrahur të gjitha brenda tij.

C Përmbledhje e të dhënave të regjistruara

C.1 Sasia e grumbulluar dhe kosto

Tabela 13: Regjistrime mujore të grumbullimit (Kompaktori)

Të dhëna mujore	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	* Maj	Mesatarja /muaj
	1 - 30	1 - 31	1 - 31	1 - 29	1 - 31	1 - 30	1 - 31	-
Ditë gjithsej	30	31	31	29	31	30	31	30.4
Ditë të rregullta* gjithsej	21	23	21	21	23	21	22	21.7
Ditë pune gjithsej	18	20	20	25	24	26	21	22
Udhëtime	26	31	29	36	36	35	25	31.1
Distanca mbuluar	851 km	843 km	1,015 km	1,023 km	1,298 km	1,229 km	952 km	1,030 km
Orë pune	102.0	103.0	108.0	125.0	131.0	143.0	104.0	116.6
Kontejnerët e mbuluar	1,007	1,068	1,021	1,173	1,190	1,169	849	1,068
Pesha e grumbulluar	98,620 kg	137,347 kg	120,120 kg	123,320 kg	148,290 kg	145,120 kg	121,160 kg	127,711 kg
Efiçenca (kg/orë)	967 kg	1,333 kg	1,112 kg	987 kg	1,132 kg	1,015 kg	1,165 kg	1,095 kg
Efiçenca (kontejnerë/km)	1.18 kon	1.27 kon	1.01 kon	1.15 kon	0.92 kon	0.95 kon	0.89 kon	1.04 kon
Efiçenca (min./kontejner)	6.1 min	5.8 min	6.3 min	6.4 min	6.6 min	7.3 min	7.3 min	6.5 min
Efiçenca (kontejnerë/orë)	9.9	10.4	9.5	9.4	9.1	8.2	8.2	9.2
Mesatarja (kg/udhëtim)	3,793 kg	4,431 kg	4,142 kg	3,426 kg	4,119 kg	4,146 kg	4,846 kg	4,106 kg
Konsumi i karburantit (Lekë)	96,445	80,100	90,000	98,550	78,400	101,060	-	90,759
Konsumi i karburantit (litra)	580	479	590	616	542	720	-	588
Norma njësi (Litër/ton)	5.9	3.5	4.9	5.0	3.7	5.0	-	4.6
Norma njësi (Lekë/ton)	978	583	749	799	529	696	-	711

*Për Majin, në tabelë reflektohen vetëm regjistrimet e dorëzuara nga bashkia pasi shërbimi i grumbullimit u krye edhe jashtë qëllimit të PP dhe nuk ka regjistrime mbi karburantin.

Tabela 14: Regjistrime mujore të grumbullimit
(Krahasimi ndërmjet kompaktorit dhe kamionçinës)

Mesatarja mujore	Kompaktori (Nëntor - Maj)	Kamionçina (Nëntor - Mars)
Udhëtime	31.1	**9.4
Distanca e mbuluar	1,030 km	-
Orë pune	116.6 orë	-
Kontejnerët e shërbyer	1,068	-
Pesha e grumbulluar	127,711 kg	**25,677 kg

Mesatarja mujore	Kompaktori (Nëntor - Maj)	Kamionçina (Nëntor - Mars)
Mesatarja (kg/udhëtim)	3,930 kg	**2,732 kg
Konsum karburanti (Çmimi, Lekë)	90,759	*18,600
Konsum karburanti (litra)	588	*121.1
Norma njësi (Litër/ton)	4.6	*5.4
Norma njësi (Lekë/ton)	711	*836

**Të dhënat përfshijnë pastrimin e grumbujve të mëdhenj të mbetjeve të gjelbra të mbledhura që u krye në Nëntor nga bashkia.

*Të dhënat janë nga pastrimi i lartpërmendur të regjistruara për një periudhë 4 mujore nga Dhjetor deri në Mars dhe karburanti është përdorur për ngarkuesin si dhe kompaktorin për këtë periudhë.

Tabela 15: Regjistrime ditore të grumbullimit

	Kompaktor	Kompaktor	Kamionçinë
Të dhëna ditore (Nëntor-Maj)	Për ditë pune	Për ditë gjithsej	Për ditë gjithsej
Udhëtime	1.41	1.02	0.31
Distanca e mbuluar	47 km	34 km	-
Orë pune	5.3 orë	3.8 orë	-
Kontejnerët e shërbyer	49	35	-
Pesha e grumbulluar	5,805 kg	4,201 kg	845 kg
Konsum karburanti (Lekë)	4,125	2,986	-
Konsum karburanti (litra)	27	19	-

- Kompaktori (CT) grumbullon 128 ton mbetje bashkiake nga 1068 kontejnerë, në muaj, duke bërë 31.1 udhëtime.
- Ndërsa në Nj.A Bushat janë të vendosur 308 kontejnerë, rezulton se shpeshtësia e grumbullimit është rreth 3.5 herë (1067/308) në muaj për kontejnerë.
- Përgjithësisht përdoret një kamionçinë (ODT) për nevojat shtesë të grumbullimit kryesisht të mbetjeve bujqësore të zbrazura në tokë, në sasi të mëdha që është e vështirë të grumbullohen nga kompaktori. Në raste të tilla, nevojiten edhe makineri ngarkuese të mëdha pasi ngarkimi me krahë dhe lopata dore është shumë i vështirë.
- Për shkak se nuk ka një program të rregullt, pasi deri më tani janë parë tendencat, nevojitet një ose dy ditë në muaj një pastrim i përgjithshëm për të grumbulluar të gjitha mbetjet e zbrazura në tokë.
- Rezulton se kamionçina grumbullon mesatarisht 25.7 ton në muaj mbetje të shpërhapura rreth kontejnerëve, që përgjithësisht janë mbetje bujqësore, dhe nevojiten 9.4 udhëtime në muaj.
- Për kompaktorin nevojiten rreth 90,760 Lekë në muaj si kosto për karburantin. Mund të kthehet në kosto në bazë toni në 711 Lekë/ton.
- Për kamionçinën nevojiten rreth 18,600 Lekë në muaj si kosto për karburantin si dhe për makinerinë ngarkuese. Në bazë toni mund të llogaritet rreth 836 Lekë/ton.
- Në muaj nevojitet kosto e karburantit 109,336 Lekë dhe pagat e punonjësve 100,000 Lekë. Gjithsej 209,336 Lekë/muaj nevojiten si kosto e drejtpërdrejtë për punën e grumbullimit të mbetjeve në Nj.A Bushat. Si shtesë e koston së drejtpërdrejtë nevojiten edhe kosto për riparim & mirëmbajtje, amortizim, pagesa e depozitimit etj.

C.2 Shpeshtësia e grumbullimit të mbetjeve në çdo fshat

Tabela 16: Shpeshtësia e grumbullimit të mbetjeve në çdo fshat

A	B	C	D	E	F
Nr.	Fshati	Popullsia	Numri i kontejnerëve	Mesatarja e ditëve të grumbullimit për muaj	E/4 (Mesatarja javore)
1	Bushat	2,040	81	7.0	1.8
2	Shkjeze	1,048	15	3.8	0.9
3	Pleshe	638	10	2.8	0.7
4	Stajke	2,327	34	4.5	1.1
5	Ashte	687	15	2.5	0.6
6	Kosmace	2,316	28	4.3	1.1
7	Melgushe	2,063	43	4.3	1.1
8	Konej	396	7	3.3	0.8
9	Rranxa	1,934	17	3.5	0.9
10	M.Jushit	660	0	0.0	0.0
11	F.Ri	699	6	3.8	0.9
12	Barbullush	2,582	41	4.8	1.2
13	Hoten	317	0	0.0	0.0
14	Kukel	389	7	4.0	1.0
15	Trush	N/A	4	1.3	0.3




Figura 8: Numri i kontejnerëve dhe shpeshtësia e grumbullimit të mbetjeve në çdo fshat

- Në baza mujore, Bushati ishte fshati që kishte shpeshtësinë më të madhe të grumbullimit të mbetjeve krahasuar me fshatrat e tjerë, që ishte 7 herë (ditë) në muaj. Për fshatrat e tjerë, shpeshtësia ishte rreth 4 herë në muaj ndërsa fshati i dytë më i madh, Barbullush e kishte rreth 5 herë në muaj.
- Ky fakt tregon që fshati Bushat e kishte shpeshtësinë 2 herë/javë ndërsa të tjerët rreth 1 herë/javë, ku të dhënat mujore u ndanë thjeshtë në 4 për të parë mesataren javore. (*Është hamendësuar se fshati Barbullush kërkon shpeshtësi më të madhe nëse merr parasysh sasinë e përgjithshme të mbetjeve, duke përfshirë ato bujqësore të përhapura në terren, pasi fshati ka shumë vende të tilla me mbetje të grumbulluara prej kohësh.)
- Pas vendosjes në grafikë të numrit të kontejnerëve për çdo fshat dhe herëve të grumbullimit, shihet se 3 në fshatra, Konaj, Fshati i Ri dhe Kukel ofrohet shërbim me shpeshtësi relativisht të lartë dhe ku ka një numër më të vogël kontejnerësh se në fshatrat e tjerë. Mund të hamendësohet se numri i kontejnerëve është i pamjaftueshëm për sasinë

e prodhuar të mbetjeve në këto fshatra ose shpeshësia e grumbullimit është shumë e lartë dhe ata prodhojnë sasi më të vogël mbetjesh. Ja vlen që të shikohet më në detaje. Në rastin e fundit, mund të pakësohet shpeshësia e grumbullimit.

C.3 Kostoja mujore për shërbimin e plotë të grumbullimit të mbetjeve

- Paga bazë për ekipin e grumbullimit të mbetjeve; 1 shofer dhe 2 punëtorë, është 100,000 Lekë
- Kosto e karburantit për kompaktorin e grumbullimit është 90,759 Lekë (128 ton x 711 Lekë /ton)
- Kosto e karburantit për kamionçinën e grumbullimit është 18,600 Lekë
- Kështu, kosto e drejtpërdrejtë është 209,359 Lekë gjithsej. Pra, në muaj nevojiten 230,295 Lekë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve ku duhet të shtohet edhe 10% e koston jo të drejtpërdrejtë.

Tabela 17: Përmbledhësja e shpenzimeve që nevojiten për muajin

Pikat	Paga	Karburant për kompaktorin e grumbullimit	Karburant për kamionçinën	Gjithsej
Kosto të drejtpërdrejta (Lekë)	100,000	90,759	18,600	209,359
Kosto jo të drejtpërdrejta (faktori i korrektimit, 10% e koston së drejtpërdrejtë) (Lekë)	10,000	9,076	1,860	20,936
Shuma gjithsej (Lekë)				230,295

3.3.3 Faza 2, Përmirësimi i mënyrës së zbrazjes dhe ndarjes së mbetjeve bujqësore

A Tabela e përmbledhjes

Tabela 18: Përmbledhje e fazës 2

Faza 2 (Janar – Dhjetor, 2016)	
Titulli	Të krijojë një sistem të përshtatshëm zbrazjesh të pranuar dhe ndjekur nga qytetarët.
Zona e synuar	Barbullush, Rranxe, Bushat
Pikat e synuara	Në 3 fshatrat e mësipërm, pika zbrazjesh të përcaktuara për mbetjet bujqësore (4 vende)
Çështjet	Mënyra e papërshtatshme e zbrazjes nga banorët ka ulur efikasitetin e grumbullimit. Veçanërisht, problem serioz është zbrazja e mbetjeve të përgjithshme jashtë kazanëve dhe sasia e madhe e mbetjeve bujqësore rreth tyre.
Objektivat	1. Para së gjithash, të prezantojë një model të përshtatshëm të rregullave bazë të zbrazjes së mbetjeve për Nj.A Bushat me qëllim rritjen e bashkëpunimit të banorëve dhe mënyrën e zbrazjes së mbetjeve. Gjithashtu, aktiviteti do të përdoret për të shqyrtuar mundësinë e përmirësimit të efikasitetit të grumbullimit të mbetjeve. 2. Përveç kësaj, aktiviteti që përqendrohet në ndajë mbetjet bujqësore nga ato të përgjithshme duhet të jetë një shtesë që të gjejë një mënyrë për pakësimin e mbetjeve si në një periudhë afat-shkurtër ashtu edhe afat-gjatë
Synimet	1. Në Nj.A Bushat, pikat e zbrazjes për mbetjet bujqësore janë vendosur në vendet ku vërehen probleme. (Këto pika zbrazje janë pranë kontejnerëve bashkiakë.)

	2. Banorët ndjekin mënyrën e zbrazjes së mbetjeve të ndara ku 1) mbetjet e përgjithshme zbrazen brenda kontejnerëve, 2) mbetjet bujqësore do të zbrazen në vende të caktuara (mendohet të jetë në kontejnerë të mëdhenj) 3. Si pasojë do të përmirësohet efienca e grumbullimit të mbetjeve
Procedura	1. Të identifikojë veçanërisht vendet problematike në termat e mënyrës së zbrazjes dhe përzgjedhi pikat pilot. 2. Të hartojë metodën e përshtatshme të zbrazjes për mbetjet bujqësore (Pas studimit dhe diskutimeve, u vendos për këtë qëllim të zbatohet metoda e vendosjes së kontejnerëve të mëdhenj.) 3. Paralelisht me sa më sipër, të ketë qasje me banorët që do të mbulohen nga PP për takime, me qëllim shkëmbimin e mendimeve dhe njohjen me sistemin e ndarjes 4. Të fillojë sistemi i zbrazjes së ndarë të mbetjeve pasi të jenë bërë fizikisht pikat e zbrazjes 5. Për më tepër, të monitorojë progresin dhe gjendjen ndërkohë që bën në të njëjtën kohë edhe ndërgjegjësim
Vlerësimi	1. Janë ndërtuar pikat e zbrazjes të përcaktuara për mbetjet bujqësore 2. Banorët e ndjekin mënyrën e zbrazjes më vetë të mbetjeve bujqësore 3. Është nxjerrë efikasiteti dhe kosto mbi shërbimin e grumbullimit të ndarë për mbetjet bujqësore

B Gjendja e zbatimit

B.1 Gjendje tipike e mënyrës së zbrazjes së papërshtatshme



Figura 9: Gjendje tipike e mënyrës së zbrazjes së papërshtatshme

B.2 Aktivitete për njoftimin e banorëve përpara fillimit

	Do not discharge waste on the ground to keep clean environment! Zef Hila Mayor of Vau i Dejes Municipality Dear Citizen, Vau i Dejes municipality has decided to introduce new discharge rule as pilot project in order to keep clean environment and appropriate waste collection service. Please cooperate as per of below discharge rule. Please discharge separately agricultural waste from general household waste. March 2016 Large container to be discharged only "Agricultural" and "Green" Waste Regular container to be discharged only "Household" Waste THE PROJECT FOR THE SUPPORT OF WASTE MINIMIZATION AND 3R PROMOTION IN REPUBLIC OF ALBANIA
	Shpjegime mësueses së shkollës përballë vendit të PP

Vizitë në një shtëpi të zakonshme për ti shpjeguar rregullat e zbrazjes

Fletëpalosja me rregullat e zbrazjes

Figura 10: Aktivitete për ti shpjeguar banorëve

B.3 Gjendja pas fillimit

Vendi pilot i zbrazjes me kontejnerë	Ngritja e kontejnerëve të mëdhenj

	
Pas fillimit, kishte shumë mbetje të zbrazura në tokë	Pas fillimit, kishte shumë mbetje të zbrazura në tokë
	
Barbullush (PËRPARA)	Barbullush (PAS)
	
Rranxe (PËRPARA)	Rranxe (PAS)
	
Bushat Jug (PËRPARA)	Bushat Jug (PAS)



Figura 11: Gjendja pas fillimit të fazës 2

C Regjistrime të grumbullimit të mbetjeve

C.1 Regjistrime të kontejnerëve të mëdhenj

Tabela 19: Regjistrime të kontejnerëve të mëdhenj të mbetjeve bujqësore

Muaj, 2016	Numri i udhëtimeve	Pesha e përgjithshme e transportuar (kg)	Fshatrat e synuar
Mars	2	2,720	Barbullush, Rranxe (filluar në mes të muajit)
Prill	5	11,320	Barbullush, Rranxe
Maj	4	5,800	Barbullush, Rranxe
Qershor	4	7,400	Barbullush, Rranxe
Korrik	7	9,740	Barbullush, Rranxe
Gusht	8	9,520	Barbullush, Rranxe
Shtator	8	9,900	Barbullush, Rranxe
Tetor	8	9,140	Barbullush, Rranxe
Nëntor	9	15,503	Barbullush, Rranxe, Bushat
Dhjetor	7	7,770	Barbullush, Rranxe, Bushat
Mesatarja mujore	6.3	8,974	Mars, Nëntor dhe Dhjetor u përjashtuan nga llogaritja për shkak të paqëndrueshmërisë

3.3.4 Faza 3, Kompostimi në vend

A Tabela e Përmbledhjes

Tabela 20: Përmbledhje e fazës 3

Faza 3 (Shtator – Dhjetor, 2016)	
Titulli	Identifikimi i sfidave për vendosjen e metodës së përshtatshme për pakësimin e mbetjeve
Zona e synuar	Barbullush, Rranxe
Fusha e zbatimit	Familjet që kryejnë kompostim
Çështjet	U vëzhgua gjatë fazës 2 që zbrazeshin sasi të mëdha mbetjesh bujqësore dhe që shkaktonin probleme. Deri më tani bashkia transporton këto mbetje në landfill. Do të ishte shumë mirë sikur banorët të mos zbraznin mbetje bujqësore dhe të bënin vetëdepozitim nëpërmjet kompostimit.
Synimet	1. Skicimi i kompostimit brenda oborrit që praktikohet në zonë 2. Identifikimi i sfidave për të popullarizuar modelin e sipërpërmendur
Procedurat	1. Kontrolli i gjendjes së tanishme praktike të kompostimit nga banorët dhe inkurajimi për këtë proces nëpërmjet vizitave shtëpi më shtëpi 2. Vëzhgimi periodik i kompostimit në familjet që u përgjigjën që bëjnë kompostim 3. Skicimi i modelit të kompostimit që është më i mundshëm për tu bërë, bazuar në vëzhgimin e sipërpërmendur 4. Identifikimi i sfidave dhe mundësisë për tu zgjeruar më tej bazuar në rezultatet e intervistave të sipërpërmendura dhe diskutime të tjera
Vlerësimi	1. U intervistuan banorët lidhur me kompostimin brenda oborrit 2. U identifikuan familjet që kryejnë kompostim dhe u gjet model praktik 3. U identifikuan sfidat për përhapjen e modelit

B Përmbajtja

Siç shihet në fotot e mëposhtme, sasi të mëdha zbrazjesh të mbetjeve të gjelbra. Deri tani bashkia duhet ti transportojë dhe depozitojë në landfill ato. Por, do të ishte ideale sikur njerëzit të mos i zbraznin këto lloje mbetjesh por ti vetëdepozitonin, p.sh. ti kompostonin.



C Teoria e përgjithshme e kompostimit

	Kompostimi brenda oborrit	Kompostimi jashtë oborrit
Të përgjithshme	1. Kryhet në burimin e prodhimit (kryesisht shtëpi) të mbetjeve të synuara që zakonisht janë në shkallë të vogël në shumë vende. Në parim, duhet të bazohet në veprime vullnetare të qytetarëve në vend të veprimeve administrative të bashkisë.	1. Kryhet në një vend të caktuar kur bëhet në shkallë të madhe ku dërgohen vetëm mbetjet e synuara. Administrata e bashkisë e organizon operacionin.
Avantazhe	1. Barrë e vogël për financat e bashkisë në këtë operacion 2. Efektive pakësimi i sasisë së transportuar si edhe sasisë së depozituar përfundimisht	1. Shumë efikase në pakësimin e sasisë që dërgohet në landfill pasi bëhet trajtim intensiv
Disavantazhe	1. Është e kufizuar në përhapjen në gjithë shtëpitë kështu që pakësimi i sasisë që dërgohet në landfill është më pak efektiv 2. Kërkohe shumë angazhim nga Bashkia për ta përhapur	1. Jo efikas në pakësimin e sasisë që transportohet si edhe kërkon kosto shtesë për grumbullimin e ndarë 2. Operacioni është barrë për bashkinë 3. Duhet siguruar ndarja e mbetjeve të synuara

D Kompostimi në vend

PP përqendrohet në kompostimin brenda oborrit sepse kompostimi jashtë oborrit është barrë për Bashkinë dhe përsëri ka probleme me transportin e mbetjeve që duhet të pakësohen për tu grumbulluar

D.1 Shembull i mirë në fshatin Barbullush

	
27 Shtator	17 Tetor
	
11 Nëntor	15 Nëntor
	
21 Nëntor	Mars 2017

D.2 Shembull i mirë në fshatin Rranxe 1

	
29 Shtator	17 Tetor, përzier me mbetje organike
	
11 Nëntor	13 Nëntor
	
25 Nëntor, përzier me mbetje plehu organik	4 Dhjetor

	
24 Dhjetor	13 Mars 2017. Gjithë komposti i hedhur në arë
	
PËRPARA dimrit (29 shtator 2016); rritja e misrit dhe perimeve	PAS dimrit (13 Mars 2017); mbetje bujqësore pas korrjes u kompostuan dhe mbuluan me dhe, duke filluar qarkullimin bujqësor.

D.3 Shembull i mirë në fshatin Rranxe 1

	
14 Qershor	17 Tetor

	
11 Nëntor	15 Nëntor, ana tjetër e kompostit
	
15 Nëntor	19 Nëntor
	
9 Dhjetor	13 Mars 2017

E Gjetje

Kompostimi brenda oborrit që u vëzhgua nëpërmjet PP është zbatim shumë i rëndësishëm praktik për pakësimin e mbetjeve ndërsa në Bushat zbrazen sasi shumë të mëdha mbetjesh organike. Por, deri tani, numri i njerëzve që kryejnë kompostim është shumë i kufizuar. Prandaj, përhapja më e madhe e këtij aktiviteti është një sfidë e pashmangshme për periudhën e mëpasshme.

Si zgjidhje, p.sh. bashkia merr masa për përjashtimin nga taksat për familjet që bëjnë kompostim ose autoritetet qendrore ndërmarrin nisma të kontrollojnë zbrazen e mbetjeve organike bujqësore në rang kombëtar.

3.3.5 Përfundime

A Përmbledhje përmbyllëse e PP

Faza 1	Faza 2	Faza 3
1. PP rriti shërbimin e grumbullimit të mbetjeve me kompaktor për 300 kontejnerët e vegjël. Më pas, shërbimi u vazhdua pas përfundimit të PP. Grumbullimi zakonisht kryhet një herë në javë për çdo kontejner. 2. Gjithsesi, PP zbuloi problemet lidhur me grumbullimin me kompaktor pasi sasi të mëdha mbetjesh (kryesisht organike) zbrazeshin jashtë kontejnerëve.	1. U vendosën më pas, kontejnerët e mëdhenj për mbetjet organike për zgjidhjen e problemit. PP vendosi të vëzhgojë edhe cilësinë e mbetjeve dhe nivelin e bashkëpunimit të banorëve me qëllim që të ndihmojë pakësimin e mbetjeve si hap tjetër. 2. Rezultoi se vendet mbahen pastër dhe efikasitet në grumbullimin e mbetjeve. Edhe pse problemet e Fazës 1 u rregulluan, Faza 2 zbuloi sfidën e radhës dhe nevojën e pakësimit të mbetjeve që do transportohen pasi bashkisë i duhet të transportojë sasi të mëdha mbetjesh organike të zbrazura.	1. Komposti jashtë oborrit nuk pakëson sasinë e mbetjeve që transportohen. Kjo është arsyeja pse kompostimi brenda oborrit i përshtatet bashkisë lidhur me transportin, pasi kompostimi brenda oborrit e ul sasinë e transportuar. 2. Prandaj PP u përqendrua te kompostimi brenda oborrit. Gjatë vëzhgimit të PP u panë disa metoda të mira praktike kompostimi. 3. PP tregoi që kompostimi është përfundimisht i nevojshëm të zgjerohet për efikasitetin e transportit të mbetjeve dhe promovimin e 3R. I kërkohet bashkisë dhe autoriteteve qendrore që të punojnë bashkë lidhur me këtë çështje.

Kategoria e mbetjeve	Kategoria e transportimit	2014 (Para PP)	2016 (Mes PP)	2018 (Shembulli në të ardhmen)
Mbetjet e përgjithshme të hamendësuar	Kompaktori i Bashkisë (PP1)	27.5 ton/muaj	127.7 ton/muaj	127.7 ton/muaj
	Kompaktori i Ndër Komunales	42.0 ton/muaj	0.0 ton/muaj	0.0 ton/muaj
Mbetjet bujqësore të hamendësuar në 2014	Kamionçina e Bashkisë	33.3 ton/muaj	16.7 ton/muaj	0.0 ton/muaj
	Kamioni i kontejnerëve të mëdhenj (PP2)	0	9.0 ton/muaj	25.7 ton/muaj
	Gjithsej	102.8 ton/muaj	153.4 ton/muaj	153.4 ton/muaj

PP1 shërbeu për njehsimin e sistemit të transportit dhe rritjes së sasisë së transportuar. PP2 shërbeu për të treguar efikasitetin e sistemit me kontejnerë të mëdhenj.

4 Aktivitetet Lidhur me Përfundimin 4 (Bashkia Cërrik)

4.1 Përmbledhje e PP

Në Nj.A Cërrik janë zbatuar 2 PP të mëposhtëm, me qëllim testimin e mundësive për promovimin e 3R-ve në Bashkinë Cërrik, që u përzgjedh si bashki pilot e shkallës së mesme.

- PP 1: Përmirësimi i sistemit të zbrazjes dhe grumbullimit për MNB në zonën rurale
- PP 2: Sistemi i grumbullimit të ndarë për të riciklueshmet nga burimi i prodhimit

4.1.1 Sfondi i PP

Në zonën rurale të Nj.A Cërrik, ka shtëpi dhe ndërtesa të shpërndara në zonë dhe mjeti i grumbullimit e ka të vështirë të hyjë në brendësi të lagjes. Ka pika grumbullimi prej betoni në rrugët hyrëse të lagjes nga rruga kryesore dhe grumbullimi i mbetjeve kryhej në mënyrë jo eficiente me karrocë me kalë. Për më tepër, në këto pika mbetjet zbrazeshin edhe nga njerëz të tjerë jo banorë të lagjes dhe këto mbetje shpërhapen rreth tyre.

Nga ana tjetër, ish Bashkia Cërrik përdorte një copë toke bujqësore në zonën e qytetit si venddepozitim përfundimtar, por duke marrë parasysh ndikimin në mjedisin përreth, Bashkia e re Cërrik e ndryshoi atë me një venddepozitim në Nj.A Mollas pranë shtratit të lumit. Megjithatë, për këtë venddepozitim nuk është marrë ndonjë masë për ndikimin në mjedis. Gjithashtu, ekziston edhe një problem i largësisë së madhe nga Nj.A Cërrik (10 km larg). Në rrethana të tilla, është nevojë urgjente zbatimi i menaxhimit të sigurt dhe eficient të mbetjeve duke pakësuar sasinë e depozituar të mbetjeve sa më shumë të jetë e mundur.

4.1.2 Përmbledhje e PP

A PP për përmirësimin e sistemit të zbrazjes dhe grumbullimit për MNB në zonën rurale

Ka ndodhur një përmirësim i grumbullimit të mbetjeve në zonën rurale sipas tre hapave të mëposhtëm:

- Hapi i parë: U prezantua sistemi i grumbullimit derë më derë në zonën e Projektit Pilot (PP) në një pjesë të Fermës në Lagjen 3, për të përmirësuar sistemin e mëparshëm të grumbullimit ku mbetjet zbrazeshin në pikat me platforma betoni dhe grumbulloheshin me karrocë me kalë. PP filloi në 18 Shkurt 2016.
- Hapi i dytë: U zgjerua grumbullimi derë më derë në një zonë tjetër të PP në Lagjen 3 Fermë ku ofrohej shërbimi i grumbullimit me sistem kontejnerësh. Sistemi i grumbullimit derë më derë u zgjerua në zonën e re nga 14 Prilli 2016.
- Hapi i tretë: Sistemi i grumbullimit derë më derë u zgjerua në zonën e Kantierit në Lagjen 3 ku ofrohej sistemi i grumbullimit me kontejnerë, nga Gushti 2016.




Figura 12: Zgjerimi i zonës së PP për përmirësimin e sistemit të zbrazjes dhe grumbullimit

Më poshtë tregohet përmbledhja e PP për Përmirësimin e sistemit të zbrazjes dhe grumbullimit për MNB në zonën rurale.

A.1 Hapi i parë: Plani i Mëparshëm i PP

Tabela 21: PP për përmirësimin e sistemit të zbrazjes dhe grumbullimit për MNB në zonën rurale (Hapi i parë)

Pikat	Përmbajtja
1.1 Përmbledhja e PP	- Prishja e pikave të zbrazjes prej platformash betoni dhe fillimi i grumbullimit derë më derë. - Prezantimi i grumbullimit të ndarë të materialit të riciklueshëm pas konfirmimit të pranimi nga komuniteti të grumbullimit derë më derë.
1.2 Zona e synuar	Lagja 3 (një pjesë e Fermës)
1.3 Sistemi i menaxhimit për grumbullimin	- Menaxhimi nga Bashkia - Kamioni i grumbullimit (nga bashkia) me qendër zëri
1.4 Sistemi i zbrazjes dhe grumbullimit	- Koha e grumbullimit: 30 min. para ose me mbërritjen e mjetit të grumbullimit - Programi i grumbullimit: duke filluar nga ora 7:00 - Vendi i zbrazjes/grumbullimit të mbetjeve: mbetjet lihen përpara shtëpisë ose zbrazen drejtpërdrejtë në mjetin e grumbullimit.

	Klasifikimi i grumbullimit dhe programi 【deri Mars 2016】 <table><tr><td>Klasifikimi</td><td>Hënë</td><td>Martë</td><td>Mërkurë</td><td>Enjte</td><td>Premte</td><td>Shtunë</td><td>Diel</td></tr><tr><td>Të pa-riciklueshme</td><td>✓</td><td>✓</td><td>✓</td><td>✓</td><td>✓</td><td>✓</td><td></td></tr></table> 【pas Prill 2016】 <table><tr><td>Klasifikimi</td><td>Hënë</td><td>Martë</td><td>Mërkurë</td><td>Enjte</td><td>Premte</td><td>Shtunë</td><td>Diel</td></tr><tr><td>Të pa-riciklueshme</td><td>✓</td><td>✓</td><td></td><td>✓</td><td>✓</td><td>✓</td><td></td></tr><tr><td>Të riciklueshme</td><td></td><td></td><td>✓</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr></table>	Klasifikimi	Hënë	Martë	Mërkurë	Enjte	Premte	Shtunë	Diel	Të pa-riciklueshme	✓	✓	✓	✓	✓	✓		Klasifikimi	Hënë	Martë	Mërkurë	Enjte	Premte	Shtunë	Diel	Të pa-riciklueshme	✓	✓		✓	✓	✓		Të riciklueshme			✓				
Klasifikimi	Hënë	Martë	Mërkurë	Enjte	Premte	Shtunë	Diel																																		
Të pa-riciklueshme	✓	✓	✓	✓	✓	✓																																			
Klasifikimi	Hënë	Martë	Mërkurë	Enjte	Premte	Shtunë	Diel																																		
Të pa-riciklueshme	✓	✓		✓	✓	✓																																			
Të riciklueshme			✓																																						
1.5 Kontejnerët për zbrazje	Në parim, të çdo lloji (qese plastike, kuti kartoni, thasë, kova, etj.)																																								
1.6 Rritja e ndërgjegjësimit / udhëzimi / monitorimi	- Përpara fillimit të grumbullimit: Shpjegimi qytetarëve të zonës së synuar nëpërmjet fletëpalosjeve (shtëpi më shtëpi) - Pas fillimit të grumbullimit: rritja e ndërgjegjësimit në varësi të gjendjes																																								

A.2 Hapi i dytë: Zgjerimi i PP për gjithë zonën e Fermës

Tabela 22: PP për përmirësimin e sistemit të zbrazjes dhe grumbullimit për MNB në zonën rurale (Hapi i dytë)

Pikat	Përmbajtja
1.1 Përmbledhja e PP	- Hegja e kontejnerëve të vendosur në zonën e Fermës dhe fillimi i grumbullimit derë më derë - Prezantimi i grumbullimit të ndarë të materialit të riciklueshëm në të njëjtën kohë me fillimin e grumbullimit derë më derë.
1.2 Zona e synuar	Gjithë zona e Fermës në Lagjen 3
1.3 Sistemi i menaxhimit për grumbullimin	E njëjtë si në hapin e parë
1.4 Sistemi i zbrazjes dhe grumbullimit	E njëjtë si në hapin e parë
1.5 Kontejnerët për zbrazje	E njëjtë si në hapin e parë
1.6 Rritja e ndërgjegjësimit / udhëzimi / monitorimi	E njëjtë si në hapin e parë

A.3 Hapi i tretë: Zgjerimi i PP në gjithë zonën Fermës dhe Kantierit dhe përmirësimi i sistemit të zbrazjes dhe grumbullimit

Është e varfër gjendja e pjesëmarrjes së banorëve për ndarje/grumbullim të riciklueshmeve në Lagjen 3, zona Kantier dhe Shelg (rruga D). Arsyeja është se ofrohen dy sisteme grumbullimi në këto zona, një është sistemi i grumbullimit me kontejner për mbetjet e përgjithshme dhe tjetri sistemi i grumbullimit me muzikë për të riciklueshmet. Kjo i ngatërron njerëzit.

Për të shmangur këtë ngatërresë, bashkia ndryshoi sistemin në zonën e Kantierit nga grumbullimi me kontejner në grumbullimin derë më derë ashtu siç ofrohet në zonën e

Fermës;

- Do të ulet konsumi i karburantit duke pakësuar shpeshtësinë e grumbullimit, që do të thotë kombinimi i rrugës C dhe zonës së Kantierit në të njëjtën ditë grumbullimi.
- Për ditën e grumbullimit të riciklueshmeve u vendos të jetë e njëjtë me atë të grumbullimit të mbetjeve të përgjithshme. Gjithsesi, të riciklueshmet do vendosen më vete nga mbetjet e përgjithshme në kosha të veçantë të vendosur në mjetin e grumbullimit. Nevojitet të sqarohen qytetarët si të ndajnë mbetjet e përgjithshme nga të riciklueshmet. Gjithashtu, rekomandohet që të monitorohet sjellja e banorëve për këtë sistem grumbullimi.
- Do të shpërndahen fletëpalosje për banorët për të arritur bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e tyre për sistemin e ri të grumbullimit.

Tabela 23: PP për përmirësimin e sistemit të zbrazjes dhe grumbullimit për MNB në zonën rurale (Hapi i tretë)

Pikat	Përmbajtja																								
1.1 Përmbledhja e PP	• Heqja e kontejnerëve në Kantier dhe fillimi i grumbullimit derë më derë. • Për të pakësuar konsumin e karburantit, shërbimi i grumbullimit ofrohet në të njëjtën ditë si në Fermë edhe në Kantier dhe koha e transportit pakësohet. • Grumbullimi i ndarë i të riciklueshmeve bëhet në të njëjtën ditë me të pa riciklueshmet dhe nuk ka më një ditë të veçantë për të riciklueshmet. • Të riciklueshmet e mbledhura janë vendosur më vete, në koshat me rrota, që janë në kamion.																								
1.2 Zona e synuar	Gjithë zona e Fermës dhe Kantierit në Lagjen 3																								
1.3 Sistemi i menaxhimit për grumbullimin	• E njëjtë si në hapin e parë																								
1.4 Sistemi i zbrazjes dhe grumbullimit	【Pas Gusht 2016】 <table><tr><th>Klasifikimi</th><th>Hën</th><th>Mar</th><th>Mër</th><th>Enj</th><th>Pre</th><th>Shtu</th><th>Die</th></tr><tr><td>Të pa-riciklueshme</td><td>✓</td><td></td><td>✓</td><td></td><td>✓</td><td></td><td></td></tr><tr><td>Të riciklueshme</td><td>✓</td><td></td><td>✓</td><td></td><td>✓</td><td></td><td></td></tr></table>	Klasifikimi	Hën	Mar	Mër	Enj	Pre	Shtu	Die	Të pa-riciklueshme	✓		✓		✓			Të riciklueshme	✓		✓		✓		
Klasifikimi	Hën	Mar	Mër	Enj	Pre	Shtu	Die																		
Të pa-riciklueshme	✓		✓		✓																				
Të riciklueshme	✓		✓		✓																				
1.5 Kontejnerët për zbrazje	• E njëjtë si në hapin e parë																								
1.6 Rritja e ndërgjegjësimit / udhëzimi / monitorimi	• E njëjtë si në hapin e parë																								

B PP për sistemin e grumbullimit të ndarë të materialit të riciklueshëm nga burimi i prodhimit

Sistemi i grumbullimit të ndarë të riciklueshmeve do të përmirësohet sipas dy hapave të mëposhtëm:

- Hapi i parë: PP për grumbullimin e ndarë të riciklueshmeve do të zbatohet në gjithë Cërrikun nga 4 Prilli, 2016.
- Hapi i dytë: U pa se ndërgjegjësimi i banorëve ishte i ulët për ndarjen e të

riciklueshme në Lagjen 1, 2 (rruga A dhe B), për shkak të ofrimit të dy sistemeve të grumbullimit në këto zona, një me kontejnerë për mbetjet e përgjithshme dhe tjetri me muzikë për të riciklueshmet. Përmirësimi i mëposhtëm do të propozohet për pas Grushtit 2016;

- Do të ndërpritet përkohësisht ofrimi i shërbimit të grumbullimit të ndarë të riciklueshme në gjithë Lagjen 1, 2 (rruga A dhe B).
- Sistemi i ri ndarje/grumbullim për të riciklueshmet, duke marrë parasysh rrugën e grumbullimit, pikat dhe kohën e grumbullimit do të fillojë në një bllok të përqendruar A me 250 familje dhe 10 pallate.
- Në zonën rurale, është ndërprerë dita e grumbullimit vetëm të riciklueshme dhe si të riciklueshmet edhe mbetjet e përgjithshme grumbullohen në të njëjtën ditë dhe të riciklueshmet janë vendosur në koshat e caktuar në mjetin e grumbullimit.




Figura 13: Ndryshimi i zonës e sistemit për grumbullimin e ndarë për të riciklueshmet
Më poshtë tregohet përmbledhja e PP për sistemin e grumbullimit të ndarë të riciklueshme nga burimi.

B.1 Hapi i parë: Plani i mëparshëm i PP

Tabela 24: PP për sistemin e grumbullimit të ndarë të riciklueshme nga burimi i prodhimit në hapin e parë

Pikat	Përmbajtja
2.1 Zona e synuar	• Gjithë zona urbane e Cërrikut (Lagja 1, 2, 3)

Pikat	Përmbajtja							
2.2 Sistemi i zbatimit	- Menaxhohet nga Bashkia - Caktimi i 2 punëtorëve (1 shofer + 1 punëtor)							
2.3 Të riciklueshmet e synuara	PET, plastikë e fortë dhe e butë, hekur / kanoçe alumini, metal tjetër							
2.4 Sistemi i zbrazjes të riciklueshmeve	- Kontejnerët e zbrazjes: Në parim, të çdo lloji (qese plastike, etj.) - Metoda e zbrazjes: Nxjerrja jashtë me mbërritjen e mjetit të grumbullimit me muzikë. - Koha e zbrazjes: Mëngjesin e ditës së caktuar të javës për zonën - Vendi i zbrazjes: në parim drejtpërdrejt në mjetin e grumbullimit.							
2.5 Sistemi i grumbullimit të riciklueshmeve	- Pikat e grumbullimit: pranë kontejnerëve të vendosur për grumbullimin e mbetjeve, pranë kryqëzimeve dhe hyrjeve të pallateve nga rrugë të asfaltuara. - Sistemi i grumbullimit me muzikë: Mjeti i grumbullimit vjen me muzikë dhe njoftimin për grumbullimin e të riciklueshmeve dhe ndalon në vendet e caktuara si pika grumbullimi për të mbledhur të riciklueshmet e nxjerra nga banorët dhe dyqanet. - Shpeshtësia e grumbullimit: Një herë/javë - Ndarja e të riciklueshmeve do të bëhet pas grumbullimit nga familjet. - Programi i grumbullimit për çdo zonë							
	zona	Hën	Mar	Mër	Enj	Pre	Sht	Die
	A: Lagja 1, 2 Perëndim	✓						
	B: Lagja 1, 2 Lindje		✓					
	C: Lagja 3 Fermë			✓				
D: Lagja 3 Kantier, Shelg					✓			
2.6 Pajisjet e grumbullimit	- kamionçinë (2t) - qendër zëri, thes pëlhurë kërpi për grumbullimin e të riciklueshmeve, etj.							
2.7 Magazinimi të riciklueshmeve	Magazinimi / magazina (me hapësirë për magazinim)							
2.8 Të ardhura / shpenzime si pasojë e grumbullimit të ndarë të riciklueshmeve	- Të ardhurat: $\Sigma[(\text{sasia e të riciklueshmeve}) \times (\text{norma njësi})]$ - Shpenzimet: roga për punëtorët e grumbullimit, karburant dhe mirëmbajtje për mjetin/et e grumbullimit - Menaxhimi dhe përdorimi i fitimit nga shitja e mbetjeve të riciklueshme të grumbulluara							
2.9 Rritja e ndërgjegjësimi t / udhëzimi / monitorimi	- Përpara fillimit të grumbullimit: Shpjegimi sistemit me nëpërmjet shpërndarjes së fletëpalosjeve ose çdo mjeti tjetër duke bërë vizita në çdo shtëpi. - Pas fillimit: Aktivitete periodike ndërgjegjësimi (Raportimi i rezultateve të monitorimit, sasia e ricikluar, të ardhurat dhe fakte të tjera qytetarëve)							

B.2 Hapi i dytë: Rishikimi i zonës së zbatimit dhe sistemit

Tabela 25: PP për sistemin e grumbullimit të ndarë të riciklueshmeve nga burimi i prodhimit në hapin e dytë

Pikat	Përmbajtja
2.1 Zona e synuar	- Në zonën e synuar urbane për ndarje/grumbullim për të riciklueshme është filluar në Bllokun A me 250 familje dhe 10 pallate. - Në zonën rurale, gjithë Ferma dhe Kantieri në Lagjen 3 vazhdohet në zonën e grumbullimit për ndarje/grumbullim për të riciklueshme.
2.2 Sistemi i zbatimit	Sistem i njëjtë si në hapin e parë

Pikat	Përmbajtja							
2.3 Të riciklueshmet e synuara	• Sistem i njëjtë si në hapin e parë							
2.4 Sistemi i zbrazjes të riciklueshmeve	• Sistem i njëjtë si në hapin e parë							
2.5 Sistemi i grumbullimit të riciklueshmeve	• Sistem i njëjtë si në hapin e parë							
2.6 Programi i grumbullimit	Zona	Hën	Mar	Mër	Enj	Pre	Sht	Die
	Lagja 1, 2 (Blloku A)		✓					
	Lagja 3 Fermë, Kantier	✓		✓		✓		
2.7 Pajisjet e grumbullimit	• Sistem i njëjtë si në hapin e parë							
2.8 Magazinimi i të riciklueshmeve	• Sistem i njëjtë si në hapin e parë							
2.9 Të ardhura / shpenzime si pasojë e grumbullimit të ndarë të riciklueshmeve	• Sistem i njëjtë si në hapin e parë							
2.10 Rritja e ndërgjegjësimit / udhëzimi / monitorimi	• Sistem i njëjtë si në hapin e parë							

4.2 Rezultatet e PP

4.2.1 PP për përmirësimin e sistemit të zbrazjes dhe grumbullimit për të MNB në zonën rurale

Ndikimet e pritshme, metoda dhe indikatorët e vlerësimit për përmirësimin e PP të zbrazjes dhe grumbullimit tregohen si më poshtë;

A Ndikimet e pritshme

- Të përmirësojë cilësinë e shërbimit të grumbullimit me ofrimin e shërbimit të grumbullimit në datë dhe orë të caktuar.
- Përmirësimi i mënyrës së zbrazjes sipas rregullave të zbrazjes
- Do të përmirësohet gjendja e mbetjeve të shpërhapura.

B Metoda e vlerësimit

- Vëzhgimi i monitorimit
- Vëzhgimi nëpërmjet pyetësorëve

C Indikatorët e vlerësimit

Tabela 26: Indikatorët e vlerësimit

Ndikimet e pritshme	Indikatorët e vlerësimit
1. Të përmirësojë cilësinë e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve me ofrimin e shërbimit në ditë dhe orë të caktuar.	- Të masë orën e fillimit, përfundimit të shërbimit të grumbullimit si dhe kohën e grumbullimit në çdo pikë nëpërmjet monitorimit. - Shkallën e kënaqësisë së banorëve nëpërmjet vëzhgimit me pyetësorë.
2. Të përmirësojë mënyrën e zbrazjes sipas rregullave të zbrazjes	Të numërojë sa qese zbrazje janë ndarë në rregull dhe sa jo, nëpërmjet monitorimit.
3. Do të përmirësohet gjendja me mbetjet e shpërhapura.	- Vëzhgimi me sy të lirë për gjendjen e ish vendeve të zbrazjes me platforma betoni për të identifikuar zbrazje të papërshtatshme nëpërmjet monitorimit - Shkallën e kënaqësisë së banorëve për mbetjet e shpërhapura nëpërmjet intervistave publike

D Rezultatet e PP

D.1 Për të përmirësuar cilësinë e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve me ofrimin e shërbimit të grumbullimit në një ditë dhe kohë të caktuar

D.1.1 Ofrimi i grumbullimit në orë të caktuar

Ka dy lloje banesash në zonën e PP. Një është që i zbraz mbetjet përpara shtëpisë përpara mbërritjes së mjetit të grumbullimit. Tjetër janë shtëpitë që i zbrazin mbetjet në pikën e grumbullimit për shkak të rrugës së ngushtë dhe pamundësisë për të hyrë aty mjeti i grumbullimit. Për këtë arsye grumbullimi derë më derë nevojitet të ketë një shërbim në një orë të caktuar.

Siç shihet në Figurë grumbullimi fillon pothuajse në 7:00 dhe shërbimi ofrohet pothuajse në të njëjtin orar në çdo zonë për gjithë ditët e grumbullimit. Kur ofrohet një shërbim i tillë i përpiktë grumbullimi, atëherë arrihet të fitohet besimi i banorëve. Nga data 14 Prill 2016 është zgjeruar zona e grumbullimit derë më derë.

Në hapin e dytë u zgjerua zona e grumbullimit nga data 4 Prill 2016. Shërbimi i grumbullimit u ofrua në orare të caktuara. Nga Gushti, zona e grumbullimit u zgjerua si hap i tretë dhe për më tepër shpeshësia e grumbullimit u pakësua nga 5 herë në 3 herë në javë. Për shkak të kësaj, koha e punës së grumbullimit është më e gjatë se më parë dhe ishte pak e vështirë të ofrohej shërbimi në oraret e caktuara. Megjithatë, pas Tetorit, pasi u fiksua ofrimi i shërbimit të grumbullimit 3 herë në javë si një sistem grumbullimi, u mundësua ofrimi i shërbimit në orar të përcaktuar.




Figura 14: Koha e grumbullimit

D.1.2 Kënaqësia e banorëve për shërbimin e grumbullimit të ofruar

U përzgjedhën për vëzhgimin nëpërmjet pyetësorëve familje nga çdo zonë e zgjeruar sipas hapave, me qëllim për të kuptuar ecurinë e përmirësimit të gjendjes.

Në fillim, u bë pyetja lidhur me shpeshhtësinë e zbrazjes së mbetjeve të grumbullimit derë më derë. Përqindja e familjeve që i zbrazin mbetjet pothuajse çdo ditë grumbullimi ishte 100% gjatë hapit të parë dhe të dytë dhe 85% në zonat e hapit të tretë.

Më pas, u bë pyetja nëse jeni të kënaqur me grumbullimin derë më derë apo jo dhe 97.5 % e përgjigjeve ishte shumë të kënaqur ose të kënaqur.

Si një arsye kënaqësie e grumbullimit derë më derë, 67.5% e përgjigjeve ishte se pika e zbrazjes së mbetjeve ishte më afër se më parë dhe 20% u përgjigjën se shpeshhtësia e grumbullimit dhe orari ishte i saktë, ndërsa 12.5% e përgjigjeve të banorëve të zonës së hapit të tretë ishte se ishin pakësuar mbetjet e shpërhapura nëpër territor.

Nga ana tjetër, si arsye të pakënaqësisë së shërbimit të grumbullimit derë më derë, 62.5% e përgjigjeve ishte se koha e zbrazjes së mbetjeve dhe ditët e grumbullimit ishin të kufizuara. Ndërsa, 15% u përgjigjën mbi shpërhapjen e mbetjeve nga qentë dhe 10% u përgjigjën për shkak të pamundësisë së zbrazjes të mbetjeve të kopshtit që prodhohen herë pas here nga familjet.

Sa më sipër, sistemi i prezantuar i grumbullimit derë më derë në zonën rurale për të përmirësuar shërbimin e grumbullimit është njohur si i pranueshëm pavarësisht kufizimeve të orareve dhe numrit të ditëve.




Figura 15: Ndryshimi i numrit të familjeve që zbrazin mbetjet te shërbimi i grumbullimit derë më derë

D.2 Përmirësimi i mënyrës së duhur të zbrazjes sipas rregullit të zbrazjes

D.2.1 Përmirësimi i mënyrës së zbrazjes

Në Figura 16 tregohet numri i familjeve në zonën e PP që i zbrazin mbetjet përpara mbërritjes së mjetit të grumbullimit ose në të njëjtën kohë. Për shkak të saktësisë së mbërritjes së mjetit, banorët janë në gjendje të dallojnë vetë kohën e grumbullimit të mbetjeve. Si pasojë, është rritur numri i familjeve që i zbrazin mbetjet përpara mbërritjes së mjetit të grumbullimit.

Në figurat më poshtë tregohet numri i familjeve që i zbrazin mbetjet në zonën e zgjeruar të PP në Fermë dhe Kantier. Njësoj si në zonën ku u zbatua PP që në fillim, është rritur numri i familjeve në të dyja zonat e zgjeruara, që i zbrazin mbetjet përpara mbërritjes së mjetit të grumbullimit.




Figura 16: Ndryshimi i numrit të familjeve që zbrazin mbetjet te shërbimi i grumbullimit derë më derë në një pjesë të zonës së Fermës ku filloi të zbatohej PP




Figura 17: Ndryshimi i numrit të familjeve që zbrazin mbetjet te shërbimi i grumbullimit derë më derë në zonën e Fermës ku u zgjerua PP




Figura 18: Ndryshimi i numrit të familjeve që zbrazin mbetjet te shërbimi i grumbullimit derë më derë në zonën e Kantierit ku u zgjerua PP

D.2.2 Përmirësimi i efijencës së grumbullimit

a Përmirësimi i efijencës së grumbullimit nga kalimi i grumbullimit me karrocë me kalë në pikat e grumbullimit me platforma betoni në grumbullimin derë më derë me qendër zëri

Grumbullimi derë më derë në PP është sistemi i grumbullimit ku mbetjet e zbrazura gjatë rrugës që bën mjeti i grumbullimit grumbullohen nga ai ndërsa ecën ngadalë ose ndalon në pika grumbullimi të përcaktuara. Prandaj, u hamendësua që efijenca e grumbullimit derë më derë nuk është përmirësuar aq shumë nga grumbullimi i mëparshëm me karrocë me kalë, që ofronte grumbullimin e mbetjeve me krahë nga pikat e zbrazjes me platforma betoni.

Gjithsesi, grumbullimi derë më derë doli që ishte sa 2/3 e kohës së grumbullimit me karrocë me kalë dhe shkurtonte kohën me afërsisht një orë krahasuar me grumbullimin e mëparshëm.




Figura 19: Efiçenca e grumbullimit

b Luhatjet e efiçencës së grumbullimit nga rishikimi i shpeshtësisë së grumbullimit

Në hapat e parë dhe të dytë, për shkak se shërbimi i grumbullimit ofrohej pothuajse në orare të sakta, u përmirësua mënyra e zbrazjes përpara mbërritjes së mjetit të grumbullimit. Si pasojë, u shkurtua koha e nevojshme e grumbullimit të mbetjeve.

Siç u përmend më sipër, nga Gushti, u zgjerua zona e grumbullimit në hapin e tretë që solli edhe pakësimin e shpeshtësisë së grumbullimit nga 5 herë në 3 herë në javë. Për shkak të kësaj, koha e punës së grumbullimit është zgjatur në shumë dhe është pak e vështirë të ofrohej shërbim në orar të saktë. Gjithsesi, pas Tetorit, u arrit të ofrohej shërbim grumbullimi në orar të saktë pas përmirësimit të rendimentit të grumbullimit të punëtorëve dhe të kuptimit nga banorët të grumbullimit 3 herë/javë.




Figura 20: Koha e nevojshme e grumbullimit të mbetjeve

D.3 Do të përmirësohet gjendja e mbetjeve rreth kazanëve

Si hap i parë, u synua prishja e pikave të zbrazjes me platforma betoni dhe përmirësimi i gjendjes rreth tyre. Si rezultat i prishjes së platformave të betonit dhe ndryshimit të sistemit të zbrazjes dhe grumbullimit në sistem grumbullimi derë më derë me qendër zëri, gjendja e

mbetjeve të shpërndara u përmirësua përjashtuar pak ditë pas prezantimit të sistemit të ri, që u panë pak mbetje në vendet ku kishin qenë platformat e betonit.

Si hap i dytë, grumbullimi derë më derë u zgjerua në gjithë zonën e Fermës, si pasojë, u hoqën kontejnerët bashkiak të vendosur në zonë. Fillimisht, në gjendjen kur banorët nuk kishin përvojë me sistemin e ri të grumbullimit të mbetjeve u vërejt se ata i zbraznin mbetjet në vendet ku kishin qenë më parë kontejnerët bashkiakë, dhe kishte sasi të vogël mbetjesh.

Gjithsesi, si hap i tretë, grumbullimi derë më derë u zgjerua në gjithë zonën e Kantierit dhe po në të njëjtën kohë shpeshtësia e grumbullimit u ul nga 5 në 3 herë (grumbullim i alternuar) në javë. Pas këtij ndryshimi, u rritën zbrazjet e papërshtatshme në vendet ku kishin qenë kontejnerët bashkiakë dhe punëtorët i grumbullonin ato vazhdimisht. Një nga arsyt mendohet të ketë qenë vështirësia e mbajtjes së mbetjeve të prodhuara në shtëpi deri në ditën tjetër të grumbullimit.

U hartuan këto kundërmasa, por që nuk sollën përmirësimin e gjendjes.

- Modifikimi i rrugës së grumbullimit për të kaluar në rrugica të ngushta sa më shumë të jetë e mundur për të ofruar grumbullim derë më derë
- Ndërgjegjësimi i banorëve
- Ndërgjegjësimi i nxënësve të zonës dhe shpërndarja e fletëpalosjeve prindërve të tyre

Për shkak se zbrazjet e paligjshme janë të kufizuara në rrugën kryesore, sistemi i grumbullimit këtu u kthye në sistem grumbullimi me kontejnerë njësoj si për rrugët e tjera kryesore. Gjithsesi, sistemi i grumbullimit brenda zonës ofrohet në vazhdim derë më derë, siç u përcaktua nga PP.

Për vëzhgimin e opinionit publik në Shtator 2016, u bë pyetja “E ndieni se zona juaj është më e pastër pas ofrimit të grumbullimit derë më derë?”. Rezultati: 80% e banorëve që ju ofrua grumbullimi derë më derë në Hapin 1 u përgjigjën “Po”; 60% në Hapin 2 dhe 2, 95% në Hapin 3. Gjithsej 82.5% e banorëve u përgjigjën “Po”.

D.4 Vlerësimi i koston

U vlerësua në 4 hapa kosto e shërbimit të grumbullimit derë më derë. Përkatesisht, gjendja e zbrazjes/grumbullimit derë më derë dhe kosto njësi për grumbullimin në çdo hap përmbledhen më poshtë si dhe kushtet e vlerësimit dhe metodat e detajuara për llogaritjen e çdo kostoje.

Në Hapin 1 (1), kosto ishte më e lartë se hapat e tjerë për shkak të marrjes me qira të mjetit. Dhe në hapin 1 (1) dhe (2), kosto ishte e lartë për shkak të numrit të kufizuar të shtëpive, rreth 100 njësi, që më përpara përdornin pikate zbrazjes me platforma betoni.

Në hapat 2 dhe 3, kosto njësi u ul. Shkak ishte rritja e numrit të shtëpive të synuara që u ofrohej grumbullimi derë më derë, pavarësisht rritjes së koston të transportit që shoqëroi ndryshimi i venddepozitimit³. Kosto njësi për hapin 3 ishte 4,798 lekë/ton dhe pothuajse dyfish krahasuar me 2,416 lekë/ton llogaritur me të dhënat financiare të bashkisë, u qartësua se kosto njësi për PP është më e shtrenjtë se kosto e tanishme e grumbullimit në Bashkinë Cërrik.

³ Për shkak se venddepozitimi i mëparshëm ishte brenda zonës së ish Bashkisë Cërrik, nuk kishte ndonjë kosto transporti. Megjithatë, venddepozitimi i ri ndodhet rreth 10 km larg nga zona e qytetit.

Tabela 27: Gjendja e zbrazjes, grumbullimit dhe transportit të mbetjeve dhe rezultatet e koston njësi për çdo hap

Hapat dhe periudha		Gjendja e zbrazjes, grumbullimit dhe transportit të mbetjeve	Kosto njësi (lekë/ton)
Hapi i parë (1)	18 Shkurt – 29 Shkurt 2016	- Zona e grumbullimit ishte zona fillestare e PP - Venddepozitimi ndodhet brenda Nj.A Cërrik - Mjeti grumbullimit pronë e Bashkisë	10.142
Hapi i parë (2)	1 Mars – 13 Prill 2016	- Zona e grumbullimit ishte zona fillestare e PP - Venddepozitimi ndodhet brenda Nj.A Cërrik - Mjeti grumbullimit pronë e Bashkisë	8,492
Hapi i dytë	14 Prill – 31 Korrik 2016	- Zona e grumbullimit ishte gjithë zona e Fermës - Venddepozitimi ndodhet në Nj.A Gostimë - Mjeti grumbullimit pronë e Bashkisë	6,457
Hapi i tretë	1 Gusht – 30 Nëntor 2016	- Zona e grumbullimit ishte gjithë zona e Fermës dhe Kantierit - Venddepozitimi ndodhet në Nj.A Gostimë - Mjeti grumbullimit pronë e Bashkisë	4,798

Tabela 28: Kushtet e përdorura për të llogaritur koston e zbrazjes, grumbullimit dhe transportit

Pikat	Kushtet		Burimi
Çmimi njësi i karburantit	148.58	lekë/litër	633,056 lekë / 4,260.64 litër (Vlera e tanishme nga Prill – Nëntor 2016)
Konsumi i karburantit	0.82	km/litër	410 km / 500 litër (Vlera e tanishme Tetor 2016)
Kosto njësi punës (Shofer)	30,000	lekë/muaj	
Kosto njësi punës (Punëtor)	20,000	lekë/muaj	
Orët e punës në ditë	7	orë/ditë	
Ditët e punës në muaj	22	ditë/muaj	
Distanca grumbullimit dhe transportit (hapi i parë)	11	km	Distancë e matur
Distanca grumbullimit dhe transportit (hapi i dytë)	27	km	Distancë e matur
Distanca grumbullimit dhe transportit (hapi i tretë)	30	km	Distancë e matur
Sasia mbetjeve grumbulluar (hapi i parë)	0.276	ton/ditë	Vlerësimi bazuar në rrymën e mbetjeve
Sasia mbetjeve grumbulluar (hapi i dytë)	2.010	ton/ditë	Vlerësimi bazuar në rrymën e mbetjeve
Sasia mbetjeve grumbulluar (hapi i tretë)	2.531	ton/ditë	Vlerësimi bazuar në rrymën e mbetjeve

Tabela 29: Metoda e vlerësimit të koston dhe rezultatet për zbrazjen, grumbullimin dhe transportin e mbetjeve në çdo hap

Pikat	18 Shkurt – 29 Shkurt	1 Mars – 13 Prill	14 Prill – 31 Korrik	1 Gusht – 30 Nëntor
1. Kosto				
a. Kosto e punës	2,726	22,560	87,699	116,403
- Shoferi	$(30,000 \text{ lekë/muaj}) \times (1 \text{ person}) \times (2.12 \text{ orë} / 7.0 \text{ orë/ditë}) \times (10 \text{ ditë} / 22 \text{ ditë}) \text{ muaj} = 0$	$(30,000 \text{ lekë/muaj}) \times (1 \text{ person}) \times (1.88 \text{ orë} / 7.0 \text{ orë/ditë}) \times (37 \text{ ditë} / 22 \text{ ditë}) \text{ muaj} = 13,536$	$(30,000 \text{ lekë/muaj}) \times (1 \text{ person}) \times (2.85 \text{ orë} / 7.0 \text{ orë/ditë}) \times (79 \text{ ditë} / 22 \text{ ditë}) \text{ muaj} = 43,849$	$(30,000 \text{ lekë/muaj}) \times (1 \text{ person}) \times (4.83 \text{ orë} / 7.0 \text{ orë/ditë}) \times (53 \text{ ditë} / 22 \text{ ditë}) \text{ muaj} = 49,887$
- Punëtorët	$(20,000 \text{ lekë/muaj}) \times (1 \text{ person}) \times (2.12 \text{ orë} / 7.0 \text{ orë/ditë}) \times (10 \text{ ditë} / 22 \text{ ditë}) \text{ muaj} = 2,726$	$(20,000 \text{ lekë/muaj}) \times (1 \text{ person}) \times (1.88 \text{ orë} / 7.0 \text{ orë/ditë}) \times (37 \text{ ditë} / 22 \text{ ditë}) \text{ muaj} = 9,024$	$(20,000 \text{ lekë/muaj}) \times (1.5 \text{ person}) \times (2.85 \text{ orë} / 7.0 \text{ orë/ditë}) \times (79 \text{ ditë} / 22 \text{ ditë}) \text{ muaj} = 43,849$	$(20,000 \text{ lekë/muaj}) \times (2 \text{ person}) \times (4.83 \text{ orë} / 7.0 \text{ orë/ditë}) \times (53 \text{ ditë} / 22 \text{ ditë}) \text{ muaj} = 66,516$
b. Karburant	$(3,000 \text{ lekë/ditë}) \times 10 \text{ ditë} = 30,000$	$(11 \text{ km/ditë}) \times (37 \text{ ditë}) / (0.82 \text{ km} / \text{litër}) \times (148,580 \text{ lekë/litër}) = 73,746$	$(27 \text{ km/ditë}) \times (79 \text{ ditë}) / (0.82 \text{ km} / \text{litër}) \times (148,580 \text{ lekë/litër}) = 386,489$	$(30 \text{ km/ditë}) \times (53 \text{ ditë}) / (0.82 \text{ km} / \text{litër}) \times (148,580 \text{ lekë/litër}) = 288,100$
c. Mirëmbajtje	-	$(\text{Kosto e karburantit}) \times (5\%) = 73,148 \times 0.05 = 3,687$	$(\text{Kosto e karburantit}) \times (5\%) = 383,355 \times 0.05 = 19,324$	$(\text{Kosto e karburantit}) \times (5\%) = 237,238 \times 0.05 = 14,405$
d. Ndërgjegjësim	845	3,098	20,306	23,531
e. Kosto gjithsej	33,571	103,091	513,818	442,439
2. Sasia e grumbulluar mbetjeve (ton)	3.31	12.14	79.57	92.21
3. Sasia kosto / të riciklueshme (lekë/kg)	10,142	8,492	6,457	4,798

E Sugjerime për vazhdimësinë dhe zgjerimin e PP në Bashkinë Cërrik

- Si sistem grumbullimi në zonën rurale, është verifikuar që sistemi i grumbullimit derë më derë me qendër zëri kontribuon në pastrimin e zonës. Për shkak se ka zona të tjera në Nj.A me kushte të njëjta me zonën e PP, sistemi i grumbullimit derë më derë do të zgjerohet në këto zona me eksperiencën nga PP.
- Gjithsesi, janë parë mbetje të zbrazura në mënyrë të papërshtatshme në vendet ku më parë kanë qenë kontejnerët bashkiakë, përgjatë rrugës kryesore në zonën e Fermës të cilët u hoqën pas fillimit të PP. Gjendja u mbajt nën monitorim gjatë muajit Gusht. Bëhet

fjalë për të njëjtën kohë kur shpeshtësia e grumbullimit u ndryshua nga 5 herë në 3 herë në javë (pas grumbullimit të përditshëm). U morën masa të ndryshme për zbrazjet e papërshtatshme, gjithsesi gjendja nuk u përmirësua. Është parë i vështirë ndryshimi i zakonit që do të mundësonte mbajtjen e mbetjeve të prodhuara për më shumë se një ditë në shtëpi. Në rastin e zvogëlimit të shpeshtësisë së grumbullimit, nevojitet një prezantim i kujdesshëm pas konfirmimit që është vendosur grumbullimi derë më derë.

- Për shkak se në zonën rurale ka shumë rrugë të ngushta dhe me baltë, mjetet e vogla dhe të mesme janë më të përshtatshme për ofrimin e shërbimit të grumbullimit dhe, nëse mjeti i grumbullimit pëson defekt dhe ndërpritet shërbimi i grumbullimit derë më derë humbet besueshmëria e banorëve të shërbimit. Prandaj, mirëmbajtja e përditshme e mjetit është mëse e domosdoshme.
- Grumbullimi taksave përfshirë taksën e mbetjeve nga familjet dhe bizneset është e domosdoshme për të pasur një menaxhim të shëndetshëm administrimi. Kosto njësi për grumbullimin derë më derë llogaritet rreth 2 herë më e lartë se kosto e tanishme njësi për MMN. Gjithsesi, për shkak se taksa është shumë e ulët, 700 lekë/vit, është e nevojshme të rritet ajo në mënyrë të përshtatshme ose të rritet baza e pagesave të taksës. Besimi i banorëve për shërbimin e grumbullimit është rritur nga shërbimi i kënaqshëm i grumbullimit i ofruar. Kështu që, tashmë kuptohet që pagesa e taksës është e domosdoshme për menaxhimin e duhur të MMN.
- Me prezantimin e grumbullimit derë më derë, është e qartë që duhet marrë në shqyrtim edhe mundësia e një sistemi tjetër për mbetjet e ndryshme nga ato bashkiake dhe mbetjet voluminoze.

F Mundësia për ta zbatuar në qytetet e tjera

Shumë bashki në Shqipëri kanë shumë zona rurale, me shtëpi private dhe zonë të gjerë grumbullimi. Për këtë arsye, është e vështirë vendosja e kontejnerëve duke marrë parasysh shpërndarjen e shtëpive. Gjithsesi, sistemi i grumbullimit derë më derë i planifikuar me kujdes, me rrugët dhe pikat e grumbullimit për zonat ku nuk mund të hyjë mjeti dhe qendër zëri është efikas për përmirësimin e efikasitetit të grumbullimit dhe mënyrën e zbrazjes për banorët, cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe parandalimin e shpërhapjes së mbetjeve nëpër zonë.

Gjithsesi, për zbatimin e sistemit të grumbullimit duhen marrë parasysh sa më poshtë:

- Për shkak se është i domosdoshëm bashkëpunimi dhe mirëkuptimi i qytetarëve për prezantimin e sistemit të grumbullimit derë më derë, janë të rëndësishme fushatat e ndërgjegjësimit përpara fillimit si edhe gjatë ecurisë së procesit.
- Me qëllim parandalimin e ndërprerjes së shërbimit të grumbullimit, duhet vendosur sistemi i përshtatshëm periodik i mirëmbajtjes për mjetet e grumbullimit.
- Zvogëlimi i shpeshtësisë së grumbullimit është efikas në zvogëlimin e kostos së MMN. Gjithsesi, është i nevojshëm prezantimi me kujdes kur bëhet fjalë që të bëhet traditë mbajtja në shtëpi e mbetjeve deri ditën tjetër të grumbullimit dhe ndalimi i zbrazjeve të papërshtatshme.

4.2.2 PP për sistemin e grumbullimit të ndarë të materialit të riciklueshëm në burimin e prodhimit

Më poshtë tregohen ndikimet e pritshme, metoda e vlerësimit dhe indikatorët e vlerësimit për

PP të grumbullimit të ndarë të materialit të riciklueshëm;

A Ndikimet e pritshme

- Të promovojë tek banorët të jenë më të vetëdijshëm të pakësojnë dhe riciklojnë mbetjet
- Të kuptohet nga banorët menaxhimi i mbetjeve bashkiake nëpërmjet veprimeve që kontribuojnë në përmirësimin e mjedisit
- Mundëson pakësimin e sasisë së mbetjeve që grumbullohen dhe dërgohen në landfill
- Ndhmon në përmirësimin e gjendjes së landfillit

B Metoda e vlerësimit

- Vëzhgimi i monitorimit
- Vëzhgimi nëpërmjet pyetësorëve

C Indikatorët e vlerësimit

Tabela 30: Indikatorët e vlerësimit

Ndikimet e pritshme	Indikatorët e vlerësimit
1. Të promovojë tek banorët të jenë më të vetëdijshëm të pakësojnë dhe riciklojnë mbetjet	• Të masë peshën e të riciklueshmeve për çdo kategori nëpërmjet monitorimit • Të vëzhgojë ndryshimin e mendimit mbi reduktimin dhe riciklimin si dhe shkallën e bashkëpunimit për PP nga intervistat publike
2. Të kuptohet nga banorët menaxhimi i mbetjeve bashkiake nëpërmjet veprimeve që kontribuojnë në përmirësimin e mjedisit	• Të informojë banorët mbi rezultatet e PP si: sasia e të riciklueshmeve të grumbulluara dhe të ardhurat nga shitja
3. Mundëson pakësimin e sasisë së mbetjeve që grumbullohen dhe dërgohen në landfill	• Të masë peshën e të riciklueshmeve të mbledhura për çdo kategori nga monitorimi
4. Ndhmon në përmirësimin e gjendjes së landfillit	• Të masë peshën e të riciklueshmeve të mbledhura për çdo kategori nga monitorimi

D Rezultatet e PP

Rezultatet e monitorimit të PP dhe rezultatet e vëzhgimit të opinionit publik që janë një nga indikatorët e vlerësimit janë përmbledhur si më poshtë përpara se të vlerësohet ndikimi;

D.1 Numri i familjeve që ndajnë dhe zbrazin material të riciklueshëm

Ndryshimi i numrit të familjeve që i zbrazin të riciklueshmet të shërbimi i grumbullimit gjatë muajve Prill – Qershor tregohet në Figurën 1-10. Numri i familjeve që zbrazin ditën e mërkurë është shumë më i madh se ai i ditëve të tjera. Zona e grumbullimit të riciklueshmeve të mërkurë është rruga C: Lagja 3 Fermë ku u ndryshua sistemi grumbullimit në derë më derë dhe kjo ditë u la vetëm si ditë për grumbullimin e të riciklueshmeve.

Në Prill, numri i familjeve pjesëmarrëse në PP ishte 146, më i lartë krahasuar me muajt e tjerë. Megjithatë në Maj dhe Qershor, ai u ul përkatësisht në 117 dhe 102 familje. Numri gjithsej i familjeve pjesëmarrëse ishte 365 për të tre muajt dhe 67% e familjeve pjesëmarrëse është

gjatë rrugës C.




Figura 21: Ndryshimi i numrit të familjeve që zbrazin material të riciklueshëm në shërbimin e grumbullimit

Siç u përmend më sipër, nga Gushti si hap i dytë, metoda e grumbullimit të të riciklueshmeve u ndryshua si vijon;

- I gjithë grumbullimi i ndarë i të riciklueshmeve në Lagjen 1, 2 (rruga A dhe B) do të ndërpritet përkohësisht për to ofruar shërbim në të njëjtën kohë.
- Sistemi i ri i ndarjes/grumbullimit për të riciklueshmet duke marrë parasysh rrugën, pikat e grumbullimit dhe kohën do të fillojë në bllokun e përqendruar A me 250 familje dhe 10 pallate.
- Në zonën rurale, grumbullimi i ndarë i të riciklueshmeve është në të njëjtën ditë me të pa riciklueshmet, pra nuk ka më ditë më vete. Të riciklueshmet e grumbulluara ndahen në koshat me rrota të vendosura në karrocërinë e mjetit të grumbullimit, enkas për këtë punë.

Tabela 31: Ndryshimi i numrit të familjeve që zbrazin material të riciklueshëm në shërbimin e grumbullimit gjatë hapit të dytë (Njësia : familje)

Muaji	Numri i familjeve që zbrazin material të riciklueshëm	
	Bloku A në zonën urbane	Fermë dhe Kantier në zonën rurale
Gusht	36	64
Shator	69	62
Tetor	56	12
Nëntor	36	7
Gjithsej	197	145

D.2 Sasia e grumbulluar e materialit të riciklueshëm

Sasitë më të mëdha të grumbulluara të të riciklueshmeve janë në Prill dhe më pas kanë vazhduar në rënie deri në Nëntor 2016. Sasia gjithsej është 263.5 kg dhe sasia mesatare është 1.09 kg/ditë për tetë muaj.

Ndërmjet të riciklueshmeve të synuara, shishet PET dhe plastika e fortë zinin më shumë se 90%, ose 242.1 kg e të riciklueshmeve të grumbulluara.




Figura 22: Sasia mujore e grumbulluar e materialit të riciklueshëm




Figura 23: Sasia e grumbulluar sipas llojit të materialit të riciklueshëm

Krahasimi ndërmjet sasisë së prodhuar të të riciklueshmeve bazuar në VSPM të kryer në Cërrik dhe sasisë së tanishme të ndarjes dhe grumbullimit të vëzhguar gjatë PP tregohen në tabelën më poshtë. Sasia gjithsej e prodhimit të të riciklueshmeve është 660 kg/ditë, gjithsesi sasia e zbrazur gjatë PP është 1.09 kg/ditë. Është e barasvlershme me vetëm 0.17% e sasisë së prodhuar.

Arsyeja pse ndërgjegjësimi i qytetarëve është i ulët për riciklimin e mbetjeve si dhe sistemin e grumbullimit mund të shpjegohen sa më poshtë vijo;

- Në zonën e qytetit, sistemi i grumbullimit të riciklueshmeve u bë me qendër zëri ku mjeti i grumbullimit ndalonte në pika të caktuara dhe kur dëgjonin muzikën, banorët nxirrnin të riciklueshmet. Në të njëjtën kohë dhe zonë, ofrohej edhe sistemi grumbullimit me kontejnerë. Në qytet ku ka shumë pallate dhe sistem grumbullimi me kontejnerë dhe qytetarët mund të zbrazin kur të duan, grumbullimi i ndarë i të riciklueshmeve me qendër zëri mendohet të jetë i vështirë për tu zbatuar.

- Në zonën e Fermës ku u zbatua fillimisht grumbullimi derë më derë, dita e grumbullimit të të riciklueshmeve ishte e ndryshme nga dita e grumbullimit të mbetjeve të përgjithshme. Nga zona u morën sasi të mëposhtme të riciklueshmeve që u ndanë nga banorët. Pas Gushtit 2016, për të përmirësuar efikasitetin e grumbullimit, dita e grumbullimit të riciklueshmeve ishte e njëjtë me ditën e grumbullimit të mbetjeve të përgjithshme, dhe si pasojë, sasia e të riciklueshmeve u zvogëlua. Megjithatë zvogëlimi i koston është i rëndësishëm për MMN, është efikase të caktohet ditë e ndryshme për grumbullimin e të riciklueshmeve nga mbetjet e përgjithshme për të vendosur sistemin e riciklimit në burimin e prodhimit.

Tabela 32: Sasia e prodhuar e llogaritur e materialit të riciklueshëm dhe sasia e tanishme e grumbulluar e materialit të riciklueshëm

Të riciklueshmet e synuara të grumbulluara në PP	Llogaritja e sasisë së prodhuar (kg/ditë)	Sasia e tanishme e ndarë/grumbulluar (kg/ditë)	Norma e zbrazjes (%)
Shishe PET	160	0.61	0.38%
Plastikë e fortë	70	0.32	0.46%
Plastikë tjetër	320	0.08	0.03%
Hekur	0	0.02	-
Alumin	20	0.01	0.02%
Tjetër	90	0.06	0.07%
Gjithsej	660	1.09	0.17%

D.3 Të ardhurat nga shitjet e materialit të riciklueshëm

Të riciklueshmet e grumbulluara dhe magazinuara gjatë PP ju shitën një blerësi në Elbasan më 24 nëntor 2016. Çmimi njësi për shitjen ishte 15.0 lekë/kg, sasia e shitur gjithsej e të riciklueshmeve ishte 250 kg dhe të ardhurat gjithsej 3,700 lekë. Bashkia vendosi që këto të ardhura do të përdoren për mirëmbajtje për pikat e zbrazjeve të paligjshme në zonën e Fermës.

D.4 Shqyrtimi koston për materialet e riciklueshme të grumbulluara më vete

U shqyrtua kosto për grumbullimin e ndarë të riciklueshmeve sipas dy periudhave ku ishte e ndryshme sistemi i zbrazjes dhe grumbullimit. Në tabelën më poshtë jepet gjendja e zbrazjes dhe grumbullimit të riciklueshmeve në çdo periudhë dhe rezultatet e koston njësi, kushtet e llogaritjes si dhe rezultatet e detajuara.

Për shkak se në periudhën e parë, zonë e synuar ka qenë gjithë ish bashkia Cërrik, efienca e grumbullimit ishte e ulët dhe kosto njësi e lartë. Në periudhën e dytë, ku zona e grumbullimit ishte e kufizuar, koha dhe distanca e grumbullimit u zvogëluan, kosto njësi u rrit krahasuar me periudhën e parë. Kosto njësi për grumbullimin e të riciklueshmeve ishte 900 - 1,500 lekë/kg, gjithsesi, çmimi shitjes njësi ishte vetëm 15 lekë/kg. Prandaj, është e vështirë të vazhdohet grumbullimi i ndarë që merr 60 në 100 herë kosto të momentit.

Tabela 33: Gjendja e zbrazjes së të riciklueshmeve, grumbullimi dhe transporti dhe rezultatet e koston njësi për çdo hap

Hapat dhe periudha	Gjendja e zbrazjes, grumbullimit dhe transportit të mbetjeve	Kosto njësi (lekë/ton)
1. 4 Prill – 31 Korrik 2016	- E gjithë ish Bashkia Cërrik (Lagja 1, 2, 3) - Mjeti ndalon në pikat e grumbullimit me muzikë dhe të riciklueshmet e nxjerra nga banorët grumbullohen. - Shpeshtësia e grumbullimit: një herë në javë	1,445
2. 1 Gusht – 30 Nëntor 2016	- Blloku i kufizuar A në Lagjen 1, 2 - Zona Fermë dhe Kantier në Lagjen 3 - Mjeti ndalon në pikat e grumbullimit me muzikë dhe të riciklueshmet e nxjerra nga banorët grumbullohen. - Shpeshtësia e grumbullimit: një herë në javë	925

Tabela 34: Kushtet e përdorura për të llogaritur koston për zbrazje, grumbullim dhe transport

Pikat	Kushtet		Burimi
Çmimi njësi i karburantit	148.58	leke/litër	633,056leke/4,260.64litter (Vlera për Prill - Nëntor 2016)
Konsumi i karburantit	0.82	km/litër	410km/500litër (Vlera për Tetor 2016)
Kosto njësi e punës (Shofer)	30,000	lekë/muaj	
Kosto njësi e punës (Punëtor)	20,000	lekë/muaj	
Orët e punës në ditë	7	orë/ditë	
Orët e punës në muaj	22	ditë/muaj	
Grumbullimi dhe distanca e transportit (hapi i parë)	9.7	km	Distancë e matur
Grumbullimi dhe distanca e transportit (hapi i dytë)	5	km	Distancë e matur
Sasia e të riciklueshmeve të grumbulluara (hapi i parë)	180	kg	Peshë e matur
Sasia e të riciklueshmeve të grumbulluara (hapi i dytë)	80	kg	Peshë e matur

Tabela 35: Metoda e llogaritjes së koston dhe rezultatet për zbrazjet e të riciklueshmeve, grumbullimi dhe transporti në hapin e parë

Pikat	Llogaritjet	Kosto
1. Kosto	-	
a. Kosto e punës		35,341
- Shofer	$(30,000 \text{ lekë/muaj}) \times (1 \text{ person}) \times (1.73 \text{ orë}/7.00 \text{ orë/ditë}) \times (63 \text{ ditë}/22 \text{ ditë/muaj})$	21,205
- Punëtorë	$(20,000 \text{ lekë/muaj}) \times (1 \text{ person}) \times (1.73 \text{ orë}/7.00 \text{ orë/ditë}) \times (63 \text{ ditë}/22 \text{ ditë/muaj})$	14,137
b. Karburant	$(9.7 \text{ km/ditë}) \times (63 \text{ ditë}) / (0.82 \text{ km /litër}) \times (148.580 \text{ Lekë/litër})$	110,728
c. Mirëmbajtja	$(\text{Kosto e karburantit}) \times (5\%) = 110,728 \times 0.05$	5,536
d. Ndërgjegjësimi		108,518
e. Kosto gjithsej	-	260,123

Pikat	Llogaritjet	Kosto
2. Sasia e grumbulluar e të riciklueshmeve (kg)	-	180
3. Kosto / sasia e të riciklueshmeve (leke/kg)	-	1,445

Tabela 36: Metoda e llogaritjes së koston dhe rezultatet për zbrazjet e të riciklueshmeve, grumbullimi dhe transporti në hapin e dytë

Pikat	Llogaritjet	Kosto
1. Kosto	-	
a. Kosto e punës	-	8,669
- Shofer	$(30,000 \text{ lekë/muaj}) \times (1 \text{ person}) \times (1.48 \text{ orë}/7.0 \text{ orë/ditë}) \times (18 \text{ ditë}/22 \text{ ditë}) \text{ muaj}$	5,201
- Punëtorë	$(20,000 \text{ lekë/muaj}) \times (1 \text{ person}) \times (1.48 \text{ orë}/7.0 \text{ orë/ditë}) \times (18 \text{ d}/22 \text{ d}) \text{ muaj}$	3,467
b. Karburant	$(5 \text{ km/ditë}) \times (25 \text{ ditë}) / (0.82 \text{ km/litër}) \times (148.580 \text{ Lekë/litër})$	16,308
c. Mirëmbajtja	$(\text{Kosto e karburantit}) \times (5\%) = 16,308 \times 0.05$	815
d. Ndërgjegjësimi		48,230
e. Kosto gjithsej	-	74,022
2. Sasia e grumbulluar e të riciklueshmeve (kg)	-	80
3. Kosto / sasia e të riciklueshmeve (leke/kg)	-	925

E Sugjerime për vazhdimësinë dhe zgjerimin e PP në Bashkinë Cërrik

- U pa se operacioni i grumbullimit të ndarë të riciklueshmeve ka kosto të konsiderueshme. Vështirë se mund të vazhdohet me gjendjen e tanishme financiare të bashkisë.
- Nuk rezultoi në mbledhje sasi të konsiderueshme të riciklueshme që të pakësonte sasinë e dërguar në landfill për zbutjen e ndikimit në mjedis dhe për të mbuluar koston e transportit, për shkak se qytetarët në përgjithësi nuk kanë qenë bashkëpunues në zbrazjen e ndarë.
- Gjithsesi, PP në zonën e Fermës tregoi se është efikas prezantimi i sistemit të grumbullimit derë më derë për mbetjet e përgjithshme përpara fillimit të grumbullimit të ndarë të të riciklueshmeve. Gjithashtu, sugjerohet që grumbullimi i mbetjeve të përgjithshme të jetë më ditë të veçantë nga grumbullimi i të riciklueshmeve, edhe pse kërkon një kosto pak më të madhe. Grumbullimi në të njëjtën ditë i të riciklueshmeve me mbetjet e përgjithshme duket ti dekurajojë qytetarët për ndarjen e të riciklueshmeve në shtëpi dhe kërkon punë shtesë nga punëtorët e grumbullimit për ndarjen gjatë procesit të grumbullimit.
- Në zonën urbane, veçanërisht në atë me pallate, grumbullimi me qendër zëri vetëm i të riciklueshmeve nuk duket të jetë efikas, kur mbetjet e përgjithshme mund të zbrazen në çdo kohë në kontejnerët bashkiak të vendosur në lagje. Për më tepër, kishte mendime që nuk ishte e arsyeshme të prisje që njerëzit, që jetojnë në pallate të dilnin nga shtëpitë vetëm për të zbrazur të riciklueshmet me të dëgjuar muzikën e mjetit të grumbullimit.
- Kur të kryhet grumbullimi i ndarë i të riciklueshmeve me bashkëpunimin e banorëve dhe sasi të mjaftueshme materiali të riciklueshëm të grumbulluar, grumbullimi i ndarë kontribuon në pakësimin e ndikimit që shkakton në mjedis landfilli dhe çon drejt zvogëlimit të koston së transportit të mbetjeve të grumbulluara në landfillin e ardhshëm rajonal.

F Mundësia për ta zbatuar në qytetet e tjera

- Nevojitet kosto e konsiderueshme për zbatimin e grumbullimit të ndarë të riciklueshmeve. Është e parakohshme për bashkitë në Shqipëri ta prezantojnë atë me gjendjen e tanishme financiare që kanë.
- Megjithatë, prezantimi i grumbullimit derë më derë për mbetjet e përgjithshme dhe ndryshimi i një dite vetëm për grumbullimin e të riciklueshmeve në zonat rurale duket lehtësisht i kuptueshëm për banorët dhe ata mund të ndajnë lehtësisht të riciklueshmet dhe kjo mund të çojë në grumbullimin e një sasive të caktuar të riciklueshmesh. Më pas, kur të prezantohet grumbullimi i ndarë i të riciklueshmeve, rekomandohet të bëhet hap pas hapi.
- Në anën tjetër, në zonën urbane, veçanërisht në zonën me pallate, është e vështirë të grumbullosh të riciklueshme me qendër zëri ndërkohë që mbetjet e përgjithshme zbrazen në çdo kohë në kontejnerët bashkiakë të vendosur në zonë.
- Njësoj si sugjerimi për Bashkinë Cërrik, kur të zbatohet grumbullimi i ndarë i të riciklueshmeve me bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e banorëve dhe të ketë sasi materiali të riciklueshëm, grumbullimi i ndarë kontribuon në zvogëlimin e ndikimit që ka në mjedis landfilli dhe çon drejt zvogëlimit të kostos së transportit të mbetjeve të grumbulluara drejt landfillit të ardhshëm rajonal.
- Në PP të Bashkisë Cërrik u pa se përmirësimi i sistemit të zbrazjes/grumbullimit të mbetjeve është përparësi përpara prezantimit të ndarje/grumbullim të riciklueshmesh. Po ashtu, në bashkitë ku nuk kryhet menaxhimi i duhur i mbetjeve të ngurta, rekomandohet të përmirësohet ky menaxhim përpara ndarje/grumbullim të riciklueshmeve.

4.3 Shtojcë

4.3.1 Foto mbi gjendjen e zbatimit

A PP mbi përmirësimin e sistemit të zbrazjes/grumbullimit në zonën rurale



	Prishja e pikave të zbrazjes me platforma betoni (8 pika) me fillimin e grumbullimit derë më derë. (Shkurt 2016)
	Përpara fillimit të PP, rritja ndërgjegjësimit / shpjegimi mbi PP u bë duke shpërndarë fletëpalosje (Mars 2016)
	Puna e grumbullimit të mbetjeve me mjetin ku është vendosur sistemi zanor

	Koha dhe vendi i zbrazjes (2): zbrazje në mjetin e grumbullimit
	Koha dhe vendi i zbrazjes (1): në parim përpara shtëpisë që përkon me rrugën e grumbullimit dhe përpara se të vijë mjeti
	Nuk vërehen zbrazje të papërshtatshme në vendet ku më parë kishte platforma betoni, tashmë të prishura. (Tetor 2016)

	Nga Gushti 2016, zona e grumbullimit u zgjerua dhe në të njëjtën kohë, u ndryshua shpeshësia e grumbullimit. Rezultoi, me rritjen e zbrazjeve në mënyrë të papërshtatshme në vendet ku kishte më parë kontejnerë. (Nëntor 2016)
---	--

B PP mbi sistemin e ndarjes/grumbullimit për materialet e riciklueshme në burimin e prodhimit

	Pamje nga grumbullimi i të riciklueshmeve (Qershor 2016)
	Në rastet kur mbetjet e përgjithshme zbrazen në ditën e grumbullimit të të riciklueshmeve, ato nuk grumbullohen dhe mbi qese vendoset një njoftim. (Qershor 2016)

	Mbledhja e njëkohshme e mbetjeve të përgjithshme dhe të riciklueshme ka filluar në kontejnerë me rrota për të riciklueshmet në kamion e grumbullimit. (Gusht 2016)
	Zona e grumbullimit të materialit të riciklueshëm në zonën urbane u rishikua në Bllokun A. (Gusht 2016)
	Gjatë peshimit të materialit të riciklueshëm të grumbulluar në magazinë (2 Prill 2016)



Të riciklueshmet e magazinuara pas fillimit të PP ju shitën një ricikluesi në Elbasan (Nëntor 2016)

4.3.2 Fletëpalosje për ndërgjegjësimin

A Fletëpalosje për përmirësimin e sistemit të zbrazjes/grumbullimit



Bashkia e Përnikut
Ndërkohë në grumbullimin e mbetjeve



Nga data **18 Shkurt 2016**, shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të vij pranë rruçës tuaj gjatë periudhës të caktuar kohore.

Ju lutem zbrazni mbetjet pranë shërbimit të grumbullimit.
MOS PËRDORNI pikat e zbrazjes përgjatë rrugës

1

Ku të zbrazni?



MOS zbrazni në asnjë lagje tjetër.
Pikat aktuale të zbrazjes prej betoni do të prishen pas Marsit 2016 dhe nuk do të jenë më pika të ligjshme të zbrazjes së mbetjeve.

Nga
18 Shkurti 2016



Në pikat e zbrazjes në zonën tuaj të caktuar nga Bashkia.

2

Kur të zbrazni?

: - :

Kur të dëgjoni 🎵 muzikën 🎵 nga mjeti i grumbullimit në zonën tuaj.

Nga e HËNA deri të SHTUNËN.
(NUK OFROHET SHËRBIM TË DIELAVE)

Në rast se ju e humbisni shërbimin, ju lutem prisni deri në ditën e ardhshme të grumbullimit.
MOS i lini mbetjet në rrugë pasi largohet mjeti i grumbullimit.



3 Si të zbrazi?

Vendosini të gjitha mbetjet në çdo lloj konteneri
(qeska plastike / kosha / kuti / etj...)

MOS i zbrazi mbetjet në tokë

Nga Prilli 2016, grumbullimi i ndarë i mbetjeve të riciklueshme do të fillojë në të gjithë zonën e ish Bashkisë Cërrik. Orari i grumbullimit do të rishikohet dhe njëherë. Ju lutem shikoni për informacione të mëtejshme që do ofrohen nga Bashkia.

Nëse mjeti i grumbullimit nuk vjen në orar, ose në qoftë se ju hasni në ndonjë problem në grumbullimin e mbetjeve,
Ju lutem informoni Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Bashkia Cërrik :
Drejtori : Z.Qerim Baku
Numri i telefonit: 068 207 9646



B Fletëpalosje për sistemin e ndarjes/grumbullimit në burimin e prodhimit



Bashkia e Cërrikut
Ndryshime në grumbullimin e mbetjeve



Grumbullimi i ndarë i mbetjeve të riciklueshme do të fillojë në gjithë zonën e ish bashkisë Cërrik nga Prilli i 2016 për të realizuar pakësimin e sasisë së mbetjeve të depozituara dhe ruajtjen e mjedisit në vendin e depozitimit. Ju lutem ndani mbetjet e riciklueshme nga ato jo-të riciklueshme dhe zbrazini ato te shërbimi i grumbullimit.

1 Kush janë mbetjet e riciklueshme?

- Shishet PET
- Plastikë e forte dhe e butë
- Metalike dhe alumini



2 Si dhe ku ti zbrazim mbetjet e riciklueshme?

Makina e grumbullimit vjen duke luajtur muzikë dhe ndalon pranë zonës tuaj. Kur dëgjoni muzikën ju lutemi nxirni mbetjet e riciklueshme dhe zbrazini drejtpërdrejtë te shërbimi i grumbullimit. Mund të përdoret çdo ambalazh zbrazje si, qese plastike, thes dhe kuti kartoni.



3

Kur të zbrazni mbetjet e riciklueshme?

Lagja 1, 2: E hënë dhe e Martë në mëngjes

Lagja 3 Fermë: E mërkurë në mëngjes

Shpeshtësia e grumbullimit në zonën ku ofrohet grumbullimi derë më derë do të ndryshojë si më poshtë;

	Hën	Mar	Mër	Enj	Pre	Sht
Jo-të riciklueshme	✓	✓		✓	✓	✓
Të riciklueshme			✓			

Lagja 3 Kantier dhe Shelg: E premte në mëngjes

Dita juaj e javës për grumbullim:

- ☐ E hënë
- ☐ E martë
- ☐ E mërkurë
- ☐ E premte

Gjërat që duhet të keni parasysh para ?

4

Shpëlaj me ujë.



Kanaçet e ushqimit duhen zbrazur nga mbetjet dhe të lahen.



Ju lutem, mos zbrazni mbetjet e riciklueshme pis dhe te shërbimi i zakonshëm i grumbullimit të mbetjeve

Nëse harroni të zbrazni mbetjet e riciklueshme në ditën e përcaktuar, ju lutem mbajeni atë deri në ditën tjetër të grumbullimit.

Nëse mjeti i grumbullimit nuk vjen në orar, ose në qoftë se ju hasni në ndonjë problem në grumbullimin e mbetjeve,
Ju lutem informoni **Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Bashkia Cërrik** :
Numri i telefonit: 068 207 9646



5 Aktivitetet Lidhur me Përfundimin 5

5.1 Përmbledhje e PP në Bashkinë Tiranë

5.1.1 Formulimi i Projektit Pilot

Përpara Korrikut 2015, mundësitë për të zbatuar “Projektin Pilot për Ndarjen e Mbetjeve të Vlefshme” dhe “Projektin Pilot për Zgjerimin e Shërbimit të Grumbullimit të Mbetjeve” u ekzaminuan bazuar në rezultatin e një seri sondazheve bazë. Si rezultat i tij, u vendos për t’u fokusuar në “Projektin Pilot për Ndarjen e Mbetjeve të Vlefshme” dhe ramë dakord që shkollat do të jenë pika e hyrjes për shpалosjen e aktiviteteve.

A Projekt Pilot për Ndarjen e Mbetjeve të Vlefshme

Bazuar në vëzhgimin e riciklimit dhe vëzhgimin e gjendjes së tanishme për shërbimet e grumbullimit të mbetjeve, vihet re se një rrjedhë e mbetjeve të vlefshme është tashmë e krijuar, ku mbetjet e vlefshme të zbrazura në kontejnerë grumbullohen përgjithësisht nga grumbulluesit e mbetjeve (WP) dhe shiten tek tregtarët (ricikluesit), dhe është konsideruar shumë e komplikuar për të ndryshuar këtë sistem ekzistues. Prandaj, u vendos për të futur ndarjen e mbetjeve në burimet e zbrazjes për të promovuar riciklimin, pa e ndryshuar shumë sistemin e tanishëm.

Faktet e mëposhtme janë gjetur përmes vëzhgimeve mbi gjendjen e tanishme:

- Aktualisht, këta WP dhe tregtarë merren kryesisht me shishet PET, paketime plastike (të butë dhe të fortë), kanaçe alumini, dhe metale të tjera;
- Ka disa që tregtojnë letër dhe karton;
- Ata zakonisht punojnë në mënyrë individuale dhe sasia e të vlefshmeve të grumbulluara nga çdo WP është e kufizuar. Prandaj, ata kanë tendencë për t’u marrë vetëm me mbetjet që tregtohen me çmim të shtrenjtë.

Duke pasur parasysh situatën e tillë, planifikimi i Projektit Pilot 3R për bashkinë Tiranë fokusohet në mbetje të tilla që WP dhe ricikluesit në shkallë të vogël merren. EEJ ka paraqitur tre opsionet e listuara më poshtë në bashki, në mënyrë që të vendosë në politikën për trajtimin e mbetjeve të ndara të vlefshme. Opsioni më i mirë do të përzgjidhet për zbatim pas diskutimit me Bashkinë e Tiranës.

Tabela 37: Krahësimi i mënyrave të trajtimit të mbetjeve të vlefshme

	Opsioni A	Opsioni B	Opsioni C
	Për të vënë të ndara të riciklueshmet, krahas kontejnerit në mënyrë që të jetë grumbullim miqësor për grumbulluesit e mbetjeve	Për të shitur të riciklueshmet tek tregtarët e riciklimit të tilla si grumbulluesit që mbledhin nga grumbulluesit e mbetjeve	Për të lejuar grumbulluesit e autorizuar për të grumbulluar të riciklueshme pa kthim të depozitave (Pa pagesë)

	Opsioni A	Opsioni B	Opsioni C
Avantazhet	- Nuk ndërhyr në rrjedhën e tanishme të riciklueshmeve që grumbulluesit e mbetjeve (njerëzit romë) të nxjerrin shpenzimet e jetesës nga këto grumbullime të riciklueshmesh. - Mënyrë e thjeshtë pa ndryshim të rëndësishëm të sistemit të tanishëm në të cilin është e nevojshme vetëm "ndarja". Zbrazja në kontejner si zakonisht, por të ndara.	- Në dukje inkurajon njerëzit për të ndarë, në mënyrë që zbrazësit mund të fitojë kthim të caktuar nga puna e tyre e ndarjes. - Është më e mundshme të jetë një mënyrë e zakonshme dhe e natyrshme në drejtim të gjendjes së tanishme dhe mentalitetin e njerëzve në mënyrë që të jetë më e lehtë për të bindur njerëzit.	- Do i afrohej konceptit "ndotësi duhet të paguajë për depozitimin" në mënyrë që të forcojë përgjegjësinë sociale të zbrazësve të mbetjeve. - Do të jetë më i zbatueshëm për stilin e avancuar urban pasi e kërkon standardet e BE-së.
Disavantazhet	- Mund të shkaktojë probleme të mëtejshme edhe nëse ky opsion pengon përkohësisht heqjen e mundësve për të ardhurat e tyre. Për shembull, fërkimi i tyre i brendshëm mund të ndodhë nëse të riciklueshmet duhet të organizohen në rrjedhën e riciklimit. - Motivimi i njerëzve të cilët kanë për ti ndarë.	- Kërkon depozitimin e sasive të caktuara të mbetjeve të riciklueshme në çdo vend për një periudhë të caktuar në mënyrë që të bëjë grumbullimin efikas nga grumbulluesit. Hapësira, pajisjet dhe mjetet e menaxhimit janë të nevojshme. - Mundësia për të kërcënuar jetët e rrezikuara sociale.	- Edhe pse mund të mos jetë aq e vështirë sa opsioni B, ajo kërkon sasi të caktuar të mbetjeve të riciklueshme për efikasitetin e grumbullimit. - Mundësia për të kërcënuar jetët e rrezikuara sociale. - Motivimi i njerëzve të cilët kanë për ti ndarë.

B Projekt Pilot për Zgjerimin e Shërbimit të Grumbullimit të Mbetjeve

Sipas “vëzhgimit të gjendjes së tanishme për grumbullimin e mbetjeve”, zona më e madhe e Bashkisë së Tiranës është e pajisur me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, por ka disa zona pa shërbim duke përfshirë zonën e Laprakës dhe të tjera. Duke kërkuar masat për të siguruar shërbimin e grumbullimit të mbetjeve në zona të tilla, do të përgatitet një bazë për reduktimin e mbetjeve dhe promovimin e riciklimit në bashki në tërësi. Prandaj, një projekt pilot, në të cilin zgjerimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve do të synohet si një hap që paraprin grumbullimin e ndarë të mbetjeve të riciklueshme në të njëjtat vende si projekti pilot i lartpërmendur, për ndarjen e mbetjeve të vlefshme, u shqyrtua për zbatim të mundshëm.




Figura 24: Mbulimi i shërbimit të Grumbullimit të Mbetjeve në zonën e Laprakës (rreze 200m nga çdo kontejner)

C Projekt Pilot për Grumbullimin e Ndarë të Riciklueshmeve në Shkolla

U bë e qartë që menaxhimi i mbetjeve të ngurta të Tiranës do të bëhej i integruar për të përfshirë njësitë administrative përreth pas reformës territoriale të planifikuar në Korrik 2015, dhe bashkia po merrej me kontratat për grumbullimin e mbetjeve bashkiake duke zgjatur ato ekzistueset, dhe duke marrë parasysh ndryshimet e mundshme të përmbajtjeve të kontratës që do të bëhen pas reformës. Prandaj, duhet të hiqej dorë nga “projekti pilot për zgjerimin e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve” i lartpërmendur, dhe u vendos që të përqendrohet në “ndarjen e mbetjeve të vlefshme.”

Si një metodë e zbatimit të tij, duke pasur parasysh kërkesën nga ana e bashkisë së Tiranës për të ushtruar veprimtari mjedisore në shkolla, u ra dakord për të zbatuar aktivitetin e ndarjes brenda shkollave duke synuar nxënësit në fazën e parë të projektit pilot, dhe zhvillimin e tij për komunitetin duke filluar me prindërit e tyre në fazën e dytë, siç tregohet në figurën e mëposhtme.




Figura 25: Koncepti i hapave për shpalosjen e grumbullimit të ndarë të riciklueshmeve i bazuar në shkolla në bashkinë Tiranë

5.1.2 Ndikimet e Reformës Territoriale dhe zgjedhjet lokale në zbatimin e PP

Bashkia Tiranë, duke qenë kryeqytet dhe duke pasur zonën më të madhe dhe sistemin administrativ, u ndikua nga disa lëvizje politike dhe mori kohë më të gjatë për të përfunduar konfigurimin administrativ pas reformës territoriale dhe zgjedhjeve lokale në Korrik 2015 ndër tre bashkitë pilote të Projektit. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Publik në Bashkinë Tiranë, u emërua në Shtator 2015, por diskutimi zyrtar me të për projektet pilote duhet të priste emërimin zyrtar të Drejtorit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake, në Janar 2016. Stafi në terren për PP nuk ishte emëruar deri atëherë, për më tepër, Projekti nuk mund të krijonte kontakte me shkollat që do zgjidheshin për PP deri atëherë. Vetëm në Janar 2016 puna në terren mund të fillonte fizikisht.

5.1.3 Përmbledhje e PP në Bashkinë Tiranë

Tabela e mëposhtme tregon përmbledhjen e planifikuar të PP të rënë dakord me anën e bashkisë Tiranë në Janar 2016.

PP në Bashkinë Tiranë	
Zona e synuar	Zona e Laprakës në NjA Tiranë
Synimi	5 shkolla publike + 2 shkolla private, në total 7 shkolla, me një total rreth 2000 nxënës (nxënës nga fillorja deri në të mesme)
Parimet Bazë	1. Duke synuar zonën e Laprakës, në të cilën gjendet mjedis jetese me zona tipike urbane dhe zona të reja të zhvilluara së fundmi nga migrimet nga komunat përreth, PP synon të paraqes një propozim për zgjidhje 3R të zbatueshme dhe në zona të tjera të Tiranës. 2. Me anë të përdorimit të shkollave si një vend i shkëmbimeve sociale për komunitetin, synohet komunikimi dhe krijimi i konceptit 3R jo vetëm shkollat, por edhe në komunitetet përreth. 3. Në aktivitetin e riciklimit në shkolla, me qëllim që të bëhet një eksperiencë e suksesshme, nga mbetjet e prodhuara në shkolla do të synohen mbetjet e riciklueshme mbi bazë të së cilave është krijuar tashme tregu i të riciklueshmeve.

	4. Me zgjerimin e aktivitetit të riciklimit për komunitetet përreth, synohet jo vetëm zgjerimi i aktivitetit, por për t'ju përgjigjur nevojave të banorëve në shkallë më të gjerë, ndaj metodat do të diskutohen dhe vendosen së bashku me komunitetet dhe bashkinë.
Përmbledhje e PP	Faza 1: Zbrazja dhe grumbullimi i të riciklueshmeve në shkollë. Faza 2: Zgjerim i aktivitetit të zbrazjes/grumbullimit të ndarë i të riciklueshmeve në komunitetin përreth shkollave.

Përmbajtjet e secilës fazë janë përshkruar në seksionet e mëposhtme.

A Faza 1: Zbrazja dhe grumbullimi i të riciklueshmeve në shkollë

A.1 Përmbledhje e Fazës 1

Faza 1 (Janar, 2016 ~ Dhjetor, 2016)	
Objektivat	Krijimi i mënyrës së duhur për zbrazjen e ndarë të mbetjeve të riciklueshmeve. Të kuptuarit e gjendjes së të riciklueshmeve të prodhuara në zonën e synuar dhe vendosja e komunikimit ndërmjet banorëve.
Zona e synuar	7 shkollë në zonën e Laprakës
Fushëveprimi i synuar	Rreth 2000 nxënës dhe studentë, familjet e tyre, mësuesit.
Të riciklueshmet e synuara	Shishe PET, plastikë e lehtë, kanaçe alumini të prodhuara brenda shkollave të synuara.
Çështjet	- Të gjitha mbetjet nga shkollat zbrazen në kontejnerët e zonës, dhe mbetjet e riciklueshme janë të gjitha të përziera dhe zbrazen së bashku me mbetjet e tjera bashkiake. - Ricikluesit (WP⁴⁴) mbledhin mbetjet e riciklueshme duke përzgjedhur materialin e dëshiruar, dhe shkaktojnë shpërndarje të mbetjeve të tjera përreth kontejnerëve. - Jo të gjitha mbetjet e riciklueshme ndahen sipas mënyrës së sipër përmendur ndaj mbetjet që transportohen në venddepozitim përfshijnë një sasi të caktuar të mbetjeve të riciklueshme. - Aktivitetet e riciklimit të kryera deri tani në shkollë nuk mund të vendosin një marrëdhënie të mirë bashkëpunimi me grumbulluesit (ricikluesit) ndaj kanë qenë të pasuksesshme.
Qëllimi	- Nga mbetjet e riciklueshme të prodhuara në shkollë, shishet PET, plastika e lehtë, kanaçet e aluminit, do të zbrazen në mënyrë të ndarë dhe do të grumbullohen në bashkëpunim me ricikluesit aktiv në zonë. - Nxënësit dhe studentët në shkollë do të përjetojnë dhe të ndjejnë efektin e ndarjes të mbetjeve të riciklueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë. - Kjo eksperiencë e nxënësve dhe studentëve më tej do të ndahet me anëtarët e familjarët dhe komunitetin përreth.
Procedura:	- Diskutim dhe vendim mbi metodën dhe rregullat e zbrazjes së ndarë në çdo shkollë. - Diskutim dhe vendim mbi programin dhe rregullat e grumbullimit me ricikluesit. - Përgatitja e kontejnerëve për shkollat. - Informimi i familjarëve dhe fqinjëve mbi aktivitetet e kryera nga nxënësit dhe studentët në shkollë - Fillimi i zbrazjes/grumbullimit të ndarë dhe monitorimi nga nxënësit (sasia, mënyra, dhe financa), dhe monitorimi i çdo shkolle nga Bashkia dhe Projekti. - Raportim mbi ecurinë nga ana e nxënësve dhe studentëve të prindërve

⁴⁴ (WP) Grumbulluesit e materialeve të riciklueshme

	dhe fqinjët. 7. Do të konsiderohet mundësia e zgjerimit të aktiviteteve në shkolla të tjera në zonë.
Rolet dhe përgjegjësitë	【Bashkia Tiranë】 ● Komunikim, koordinim dhe realizim i diskutimeve përgatitore me secilën shkollë të synuar dhe Drejtorinë e Arsimit. ● Përditësim informacioni rreth gjendjes në nivel bashkie lidhur me grumbullimin e diferencuar (formalizimin e ricikluesve, kontratë me ofruesit e shërbimeve, si dhe çështje të tjera lidhur me të) ● Vazhdimësi të ofrimit të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve bashkiake, siç është. ● Monitorim i aktiviteteve në çdo shkollë. ● Sigurim i materialeve që lidhen me rritjen e ndërgjegjësimit. 【Shkollat e synuara】 ● Sigurim i hapësirës për vendosjen e kontejnerit/ve për mbetjet e riciklueshme. ● Kontaktim me ricikluesit kur të jetë i nevojshëm grumbullimi. ● Sigurimi i kohës për nxënësit dhe studentët të marrin pjesë në aktivitete (informim mbi rregullat, përfshirje në zhvillimin e materialeve për rritjen e ndërgjegjësimit, pjesëmarrje në raportimin e ecursisë, etj.) ● Mbështetje nga mësuesit ndaj aktiviteteve monitoruese që do të kryhet nga nxënësit dhe studentët. ● Menaxhim i të ardhurave nga shitja e të riciklueshmeve. ● Komunikim dhe sigurimi i mjediseve për takim me prindërit 【EEJ】 ● Kosto për kontejnerët e mbetjeve të riciklueshme për çdo shkollë. ● Kosto për materialet për rritjen e ndërgjegjësimit ● Kosto për takimet e raportimit në çdo shkollë ● Asistencë për përgatitjen e takimeve me çdo shkollë ● Diskutim me ricikluesit për bashkëpunim ● Monitorimi i çdo shkollë ● Pjesëmarrje në diskutimet me shkollat dhe banorët e zonës
Tregues të vlerësimit	1. Vazhdimësia e zbrazjes/grumbullimit të ndarë të mbetjeve të riciklueshme në shkolla. 2. Banorët e komunitetit përreth janë në dijeni të aktivitetit riciklues të kryer në shkollë.

A.2 Ecuria e aktiviteteve

A.2.1 Hartimi i metodës së zbatimit

a Vëzhgimi i sasisë së mbetjeve të riciklueshme dhe rregullat për shitjen e të riciklueshmeve tek ricikluesit

Nga pesë shkollat, secila klasë nga klasa e dytë, e katërt, dhe e tetë në shkollën 28 Nëntori, si një përfaqësues i shkollës fillore (klasat nga e 1 në të 9), dhe secila klasë nga klasa e 10, 11 dhe 12 të shkollës Aleks Buda, si një përfaqësues i shkollës së mesme, u përzgjedhën si klasa shembuj dhe u zhvillua vëzhgimi i sasisë së mbetjeve të riciklueshme. Ata grumbulluan mbetjet e riciklueshme për një javë në secilën klasë për të hetuar sasinë mesatare të mbetjeve të riciklueshme të zbrazura në një shkollë në zonën e Laprakës.

Metoda, ecuria dhe rezultatet e vëzhgimit janë si më poshtë.

VPSM në Shkollë (Vëzhgimi i Përbërjes dhe Sasisë së Mbetjeve) @ Shkollë 28 Nëntori

- Objektivat e Vëzhgimit
Të kuptojë skemën efikase (Shpeshësinë e grumbullimit, metodën e magazinimit, madhësinë e kontejnerëve, etj...) të ndarjes/grumbullimit të materialit të riciklueshëm që do zbatohet në shkollë.
- Informacioni i nxjerrë nga Vëzhgimi
 - Do të kuptohet sasia e materialit të riciklueshëm (shishe PET, plastikë e butë, kanoçe alumini) të zbrazur nga shkollë.
 - Nxënësit do të enë të vetëdijshëm për sasinë e materialit të riciklueshëm që zbrazin çdo ditë.
- Periudha e Vëzhgimit
 - E martë, 16 Shkurt deri E martë, 23 shkurt
- Numri i klasave që do të vëzhgohen
 - 1 klasë nga klasat e 1^{ra} ~ 2^{ta} (Numri i nxënësve të klasës së përzgjedhur: _____)
 - 1 klasë nga klasat e 3^{ta} ~ 6^{ta} (Numri i nxënësve të klasës së përzgjedhur: _____)
 - 1 klasë nga klasat e 7^{ta} ~ 9^{ta} (Numri i nxënësve të klasës së përzgjedhur: _____)
 - Gjithsej 3 klasa për shkollë

2016/2/12

JICA 3R Project / Bashkia Tiranë

1

VPSM në Shkollë (Vëzhgimi i Përbërjes dhe Sasisë së Mbetjeve)
@ Shkollë 28 Nëntori

- Si ta kryejmë
 - 1. Çdo klasë e përzgjedhur do të pajiset me disa qese plastike
 - 2. Nxënësit në klasat e përzgjedhura do të zbrazin mbetjet e synuara (të riciklueshme) në qeset e ofruara për një javë (5 ditë javë).
 - 3. Nxënësit do të mësohen në atë se çfarë duhet ndarë dhe si të zbrazen nga ekipi i projektit* në ditën e parë (16 Shkurt).
 - 4. Pas grumbullimit të materialit të riciklueshëm për 1 javë, "VPSM" do të kryhet nga Ekipi i Projektit, ose nxënësit e klasës së përzgjedhur (E mërkurë, 24 shkurt).
 - 5. Materialet e riciklueshme të grumbulluara do të shiten (ose do të jepen falas) të ricikluesit.
→ Shkollë duhet të marrë parasysh & vendosë si të menaxhojë paratë nga shitja.
 - 6. Rezultatet e vëzhgimit do të ndahen me gjithë nxënësit kur të fillojë aktiviteti i riciklimit në Mars.

- Çfarë duhet ndarë:

- Shishe PET
- Plastikë e butë*
- Kanoçe alumini

} Së bashku në një qese



(Kur qesja mbushet plot, lidhet fort gryka dhe përdoret qesja tjetër.)

- Si duhet të zbrazen
 - Çdo përmbajtje e shishes, kanoçes, etj. duhet të zbrazen tërësisht përpara zbrazjes. (Nuk ka nevojë të lahen.)
 - Mbetje të tjera zbrazen në kontejnerët e zakonshëm të mbetjeve ashtu siç veprohet deri më tani.

2016/2/12

JICA 3R Project / Bashkia Tiranë

2

VPSM në Shkollë (Vëzhgimi i Përbërjes dhe Sasisë së Mbetjeve)
@ Shkollë 28 Nëntor

- Magazinimi & Grumbullimi i materialit të riciklueshëm të ndarë
 - Ekipi i projektit do të vijë dhe do të grumbullojë qeset në ditën e fundit (E martë, 23 Shkurt)
 - Ju lutem mbani qeset e mbyllura në çdo klasë.
 - Në rast të mbajtjes së qeseve në mjedise të ndryshme nga ato të klasës së synuar,
 - Ju lutem mbajni në mjedise të mbyllura që materialet e riciklueshme të grumbulluara do të jenë të paprekura deri ditën e fundit të vëzhgimit.
 - Ju lutem sigurohuni që qeset të dallohen nga klasa në klasë.
- Matja e Materialit të Riciklueshëm të Grumbulluar
 - Nëse shkolla mund të na ofrojë hapësirë? (Çdo vend me një hapësirë 10 x 15 m, me çati)
 - Nëse po, projekti do vendosë fletën plastike, ku materiali i riciklueshëm i grumbulluar do të ndahet në çdo kategori.
 - Për çdo klasë të përzgjedhur, materiali i riciklueshëm i grumbulluar do të klasifikohet (p.sh. PET, plastikë e butë, alumin).
 - Çdo kategori e materialit të riciklueshëm do peshohet dhe matet për vëllimin.
 - Ekipi i Projektit do të llogarisë sasinë mesatare të materialit të riciklueshëm të zbrazur për nxënës.



VPSM në Shkollë (Vëzhgimi i Përbërjes dhe Sasisë së Mbetjeve)
@ Shkollë 28 Nëntor

- Prezantimi i Rezultateve
 - Rezultatet do të ndahen me gjithë klasat si edhe gjithë shkollat e tjera që marrin pjesë në projektin pilot kur të prezantohet aktiviteti i riciklimit me nxënës.
 - Opsioni 1: Nga nxënësit → Asambleja e nxënësve? Me fillimin e aktivitetit në mars.
 - Opsioni 2: Nga Posterit në çdo klasë
- Materialet që do të përgatiten nga Projekti
 - Qese plastike mbetjesh (në një ngjyrë, 5 qese për klasë = 15 qese për shkollë)
 - Etiketa ngjitëse për çdo qese = 5 ngjitëse për klasë = 15 ngjitëse për shkollë (për të shkruar emrin e klasës në çdo qese)
 - Doreza plastike për nxënësit që do të marrin pjesë në peshimin e mbetjeve të riciklueshme
 - Shtrojë plastike (në rast të kryerjes së klasifikimit në shkollë) 10 x 10 metra
 - 3 kova plastike
 - Peshore

JICA 3R Project / Bashkia Tiranë

Figura 26: Shpjegim mbi metodën e Vëzhgimit të Sasisë së Mbetjeve të Riciklueshme



Figura 27: Ecuria e vëzhgimit të sasisë së mbetjeve të riciklueshme




Figura 28: Rezultatet e Vëzhgimit të Sasisë së Mbetjeve të Riciklueshme në 2 shkolla

b Metoda e zbrazjes dhe shitjes në shkollë

Si rezultat i studimit të sasisë së mbetjeve të riciklueshme në dy shkolla, një shkollë fillore do zbrazte 174ml (8.54g)/ditë për një student dhe 191l për një ditë shkolle, e cila do mbushte një thes me kapacitet 1000l për rreth një javë. Numri i ditëve të nevojshme për të mbushur një thes ishte llogaritur në bazë të numrit të tyre të studentëve në lidhje me secilën nga tre shkolla e tjera, dhe çdo shkollë pritej të mbushte një thes për një ose dy javë. Shkolla e mesme do zbrazte 44l/ditë për shkollë dhe kërkon plot 4 javë për të mbushur thesin, por studentët dhe mësuesit sëbashku thanë se do konsumonin më shumë pije dhe gjenerojnë më shumë mbetje pasi të ngrohet” (studimi u zhvillua ne Shkurt). Kështu që, i njëjti thes 1000l si në shkollën fillore u përgatit për shkollën e mesme.

Pa siguruar një nivel të caktuar të frekuencave për të riciklueshmet që do të mbledhen nga një shkollë, të riciklueshmet që nxënësit do grumbullonin do lireshin të mbledhura në shkollë dhe studentët mund të merrni përshtypjen se “përpyekjet për grumbullimin e ndarë nuk paguhen”. Prandaj, Projekti arriti në përfundimin se më shumë se një thes me kapacitet prej 1000l mund të mos jetë i nevojshëm për çdo shkollë dhe vendosi për të instaluar një thes të vetëm pa ruajtjen e ndarë të riciklueshmeve sipas llojeve të tyre në mënyrë që të grumbullohej me frekuencë të mjaftueshme nga një riciklues.

c Metoda e zbrazjes

- Koshat e riciklimit janë të vendosur në çdo kat, ose në çdo klasë nëse është e nevojshme, dhe çdo nxënës zbraz të riciklueshmet e synuara në koshat e caktuar çdo herë zbrazjeje.
- Të riciklueshmet e mbledhura në koshat e riciklimit zhvendosen në thesin e grumbullimit nga nxënësit ose stafi i pastrimit të shkollës çdo ditë. Duke bërë kështu, mbetet jo të riciklueshme hiqen.
- Kur thesi i grumbullimit është pothuajse plot, stafi i monitorimit (ose vetë shkolla) kontakton me grumbulluesin që bashkëpunon për grumbullim (shitje). (është mirë koordinimi së bashku me shkollat e tjera, kur kontaktohet grumbulluesi, në mënyrë që grumbullimi të zhvillohet në një udhëtim.)
- Thesi i grumbullimit është mirë të ruhet në një vend që nuk e kap shiu dhe të jetë lehtësisht i arritshëm.

d Metoda e grumbullimit

- Thesi i grumbullimit i mbushur me të riciklueshme i dorëzohet grumbulluesit, dhe shkolla merr një thes bosh zëvendësues nga grumbulluesi. Stafi monitorues shoqëron grumbulluesin për të regjistruar peshën, merr paratë e shitjes së secilës shkollë dhe ju a jep shkollave.
- Regjistrimi i shitjeve nuk ruhet vetëm në formën e faturës së grumbulluesit (e cila në shumë raste përfshin vetëm sasinë e përgjithshme), por edhe në një format regjistrimi në të cilin shënohen respektivisht peshat e secilës kategori të riciklueshmesh.
- Sugjerohet që disa studentë përfaqësues të shoqërojnë procesin e shitjes së parë. Nëpërmjet këtij procesi, nxënësit do të mësojnë më drejtpërdrejt dhe gjallërisht se cilat lloje mbetjesh të riciklueshme mund të tregtohen, dhe ata do e ndajnë këtë informacion me nxënësit e tjerë. Kjo do e ngrejë nivelin e ndërgjegjësimit ndërmjet nxënësve.
- Pasi është vendosur një cikël grumbullimi, frekuenca e grumbullimit nga shkollat mund të programohet më rregullisht si, një herë në muaj për të gjitha shkollat, për koordinim më të lehtë ndërmjet shkollave dhe grumbulluesit(ve). Pasi grumbullimi mund të rregullohet dhe është vendosur komunikimi ndërmjet shkollave dhe grumbulluesit, stafi monitorues i bashkisë mund të hiqet nga terreni, dhe shkollat mund të vazhdojnë vetë. (Megjithatë mund të jetë vazhdimisht i nevojshëm kontrolli nëse sistemi dhe rregullat e vendosura po funksionojnë apo jo.)

A.2.2 Shpjegimi i metodës dhe kërkesa për bashkëpunim të shkollave

EEJ, sëbashku me bashkinë Tiranë, shpjeguan PP dhe metodën e zbrazjes së ndarë tek mësuesit e pesë shkollave të synuara në Mars 2016, me sigurimin e një materiali ndërgjegjësimi, i cili ka qenë i përgatitur paraprakisht për çdo klasë nga një grup. Mësuesve ju kërkuar bashkëpunimi i tyre për shpjegimin e aktivitetit nxënësve të tyre, përpara fillimit të

vërtetë të aktivitetit në secilën shkollë duke përdorur materialin e parapërgatitur.

Pas fillimit të PP, kosha grumbullimi, postera për ndërgjegjësim, thasë për grumbullim, dhe skeleti për thasët u përgatitën. Në 29 Mars 2016, shkolla e mesme Aleks Buda, një nga pesë shkollat pilote, filloi grumbullimin e ndarë të riciklueshmeve, dhe katër shkollat e tjera filluan aktivitetin pas vendosjes së këtyre materialeve gjatë vijimit të Prillit.

	
Thesi i grumbullimit dhe skeleti i tij i vendosur në secilën shkollë.	Poster për ndërgjegjësim.
	
Koshat e grumbullimit të vendosur në ndërtesën e shkollës.	

PSE 3R?



Çfarë po ndodh në Tiranë?

- Çdo ditë, rreth 500 ton mbetje zbrazen në Landfillin e Sharrës.  X 50
- Çdo ditë, çdo person zbraz rreth 360g mbetje.
- Landfilli i Sharrës NUK do të zgjerohet. Ai ka limitin e tij!! 

Çfarë mund të bëjmë ne tani?



• Çfarë NUK duhet të ndahet

1. Fletë Alumini
2. Letër
3. Plastikë
4. Shishe qelqi ndryshe nga Suko dhe Bitter
5. Mbetje ushqimi

Këto janë "të riciklueshme" = Këto mund të përdoren si materiale në disa vende. Por! fatkeqësisht, nuk ka fabrikë afër në këtë lagje që përdor këto materiale ose blejë lehtë ato dhe asnjë nuk i grumbullon.

Në mund të RIPËRDORIM or REDUKTOJME duke i refuzuar ato: (duke mos i pranuar ato, duke mos blerë gjëra me material mbështjellës të panevojshëm, duke i rivendësuar me gjëra të tjera të riciklueshme).

Çfarë janë 3 "R"?

- Reduktim: për të prodhuar dhe zbrazur më pak mbetje.
- Ripërdorim: për të përdorur më shumë se një herë përpara zbrazjes.
- Riciklim: për të përdorur materialin përsëri në një formë tjetër.

- Ndër mbetjet e zbrazura çdo ditë nga shtëpitë tona, rreth 85% shkon në landfill, dhe vetëm 15% grumbullohet për riciklim.



Koha për ti Ndarë, për ti Reduktuar & Ricikluar!!

• Çfarë duhet të ndahet



• Ti do të zbrazësh





Rolet tuaja

- ! Zbrazini **të ndara** dhe siç duhet **çdo herë**.
- ! Mësoni njëri-tjetrin si ti ndani.
- ! Gjithashtu, mendoni dhe provoni të pakësoni edhe mbetjet e tjera.
- ! Tregojni familjes tuaj rreth ndarjes.

Duke filluar nga

A.2.3 Ecuria në secilën shkollë

Ecuria e punës në secilën shkollë është si në vazhdim. Megjithëse ato ndodhen në një zonë të Laprakës, secila nga pesë shkollat ka diferenca në lloje dhe sasi të ushqimit dhe pijeve të cilat konsumohen nga nxënësit e tyre, dhe për këtë arsye mënyrat e përfshirjes së nxënësve ndryshojnë nga njëra-tjetra. Në fund të Prillit, secila shkollë formoi një grup mjedisor i cili do veprojë si një lider i aktivitetit të PP në secilën shkollë. Grupet në të gjitha shkollat me përjashtim të një shkolle që përbëhet nga disa përfaqësues nga çdo klasë (me përjashtim të klasave fillore). Grupi në shkollën tjetër ka nxënës vetëm nga klasa e gjashtë dhe e nëntë dhe si rezultat, shkolla si një e tërë është përfshirë në aktivitet në mënyrë jo bindëse dhe nuk është familjarizuar me rregullat e ndarjes së kënaqshme. Shkolla mezi arriti të mbushë thesin vetëm një herë deri në fund të vitit akademik, ndërkohë që koshat e “mbetjeve të zakonshme” në shkollë përmbajnë ende shumë mbetje të riciklueshme të synuara, të zbrazura në to.

Tabela 38: Grupi Mjedisor i formuar në secilën shkollë

Shkolla	Aleks Buda	28 Nëntori	Ahmet Gashi	Gjergj Fishta	Skënder Luarasi
Klasat	Klasat 10-12	Klasat 1-9	Klasat 1-9	Klasat 1-9	Klasat 1-9
Nr. Nxënësve	583	1094	847	598	440
Grupi Mjedisor i formuar	Po	Po	Po	Po	Po
Klasat pjesëmarrëse	Përfaqësuesit nga të gjitha klasat (10,11,12) dhe shokët e tyre	Përfaqësues nga klasa 3-9	Përfaqësues nga klasa 6 dhe 9	Përfaqësues nga klasa 3-9	Senatorët dhe përfaqësues nga çdo klasë.

Shkolla	Aleks Buda	28 Nëntori	Ahmet Gashi	Gjergj Fishta	Skënder Luarasi
Karakteristikat	U mësojnë rregullat shokëve të klasës, monitorojnë shitjen, kërkojnë bashkëpunimin e banorëve dhe lokaleve.	U formua një grup për një ndërtesë shkollore; 2 grupe në total.			

Projekti ka punësuar një asistent në terren për të qenë afër shkollave në mënyrë të vazhdueshme, për rritjen e ndërgjegjësimit dhe monitorimin e ecures së aktivitetit në secilën shkollë. Asistenti vizitoi shkollat në bazë ditore dhe jep udhëzime për mënyrën e duhur të zbrazjes së të riciklueshmeve dhe monitorimin.

Në fillim të PP, koshat e riciklimit të vendosura në të gjitha shkollat përmbanin shumë mbetje të pa-synuara. Këto mbetje të pa-synuara përfshinin disa të riciklueshme (letër, qese të lehta, copa plastike, etj), por siç u përmend më parë, nuk janë gjetur tregtarë për këto materiale dhe nuk janë synuar në këtë PP. Prandaj, asistenti në terren ka dhënë udhëzimet në stafin e shkollës dhe tek nxënësit për të ndarë vetëm të riciklueshme të tilla, përfshirë kanaçe alumini, shishe dhe shishe PET, që janë të synuara në PP.

Si mënyrë e aktivitetit ndërgjegjësues, rreth 20 nxënës, përfaqësues të mbledhur për të hetuar përmbajtjen e thesit dhe koshave të riciklimit të shkollës, rreth një gjysmë muaji pas fillimit të aktivitetit, dhe matën peshën e tyre dhe sasinë. Si rezultat i matjes, më shumë se 90% e përmbajtjes ishin mbetje të pa synuara. Bazuar në këtë rezultat, një diskutim u kryer me nxënësit pjesëmarrës dhe ata vunë në dukje nivelin e ulët të ndërgjegjësimit në mbarë shkollën. Ata propozuan të organizonin diskutime në secilën klasë për të përmirësuar ndërgjegjësimin.

Rezultati i grumbullimit deri në mes të Qershorit 2016 është përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 39: Rezultati i grumbullimit të riciklueshmeve deri në fund të vitit akademik në mes të Qershorit

			Materialet e Riciklueshme të Grumbulluara													
School			PET			Alumin			Glass bottels (Bitter & Suko)			Others			Total sales	
		Date	weight (kg)	leke	(@ leke)	weight (kg)	leke	(@ leke)	Piece	leke	(@ leke)	kinds	weight (kg)	leke	(@ leke)	Leke
Aleks Buda	1	10.05.2016	6.6	130	20	9	720	80		0				0		850
	2	30.05.2016	16	400	25	9	810	90	20	40	2			0		1250
	3	22.06.2016	37	740	20	4	360	90	33	50	1.5			0		1150
28 Nentori	1	06.05.2016	12	240	20	3.2	260	80	40	40	1	glass jar	24	120	5	660
	2	30.05.2016	47	1180	25	6	540	90	25	75	3			0		1795
Gergi Fishta	1	06.05.2016	12	240	20	2.8	220	80		0		iron	4	80	20	540
Skender Luarasi	1	19.05.2016	16	400	25	14	1260	90	300	450	1.5	other bottle	4	32	8	2142
Ahmet Gashi	1	22.06.2016	21	420	20	3	270	90	20	30	1.5			0		720



Mënyra e zbrazjes së të riciklueshmeve në thes në shkollën 28 Nëntori. Në çdo klasë, të riciklueshmet mbledhen në qeska plastike të vogla dhe më pas zbrazjes në thes.

Të riciklueshmet e grumbulluara në thes në shkollën 28 Nëntori. Disa kanaçe alumini të sjella nga shtëpitë (birrë dhe për ushqim) përfshiheshin, por të riciklueshme që nuk synoheshin gjenden rrallë.

Figura 29: Gjendja e zbrazjes dhe grumbullimit të ndarë të riciklueshmeve në shkolla

Shkolla e Mesme Aleks Buda dhe Shkolla Skënder Luarasi kërkuar bashkëpunim nga lokalet e lagjes që në hapat fillestare të aktivitetit, e cila rezultoi me sasi të mëdha të kanaçeve të aluminit në këto shkolla.

Në rrjedhën e aktivitetit, ricikluesi i cili shprehu gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar me Projektin, u përball me vështirësi financiare në biznesin e tij, dhe Projekti u përball me disa probleme si mosardhja e ricikluesit në ditën e grumbullimit dhe mos pagesa mbi shitjen nga shkollat. Në këtë PP, ka disa riciklues të tjerë aktive në zonën e synuar dhe gjetja e një ricikluesi tjetër ishte lehtësisht e mundur. Megjithatë, një riciklues konsiderohet shpesh i pasigurtë financiarisht dhe ky problem ka treguar një sfidë kur konsideron zbatimin e aktiviteteve të ngjashme në zona të tjera.

Për më tepër, një nga këto shkolla gjeti një riciklues që ndodhej mbrapa shkollës. Shkollat negocionin direkt me ta dhe nxënësit shtynin skeletin e tyre të grumbullimit për tek ricikluesi për të shitur të riciklueshmet e tyre të grumbulluara. Kjo metodë lejon shkollën të jetë e pavarur nga bashkia dhe marrëveshja e projektit dhe rregullojnë shitjen e tyre në kohën e duhur, dhe kështu mund të konsiderohet si më i qëndrueshëm. Megjithatë është shumë e rrallë për të gjetur një shkollë me kushte kaq të përshtatshme për grumbullimin e të riciklueshmeve.

Gjithashtu, është e nevojshme për një riciklues që të ketë një ose më shumë grumbullues të drejtpërdrejtë të punësuar (jo vetëm duke blerë nga grumbulluesit e pavarur) dhe të kenë mënyrën e tyre të transportit, si psh. një kamion ose një motoçikletë me një karrocë, në mënyrë që të krijojë një bashkëpunim të qëndrueshëm për shkollën, bazuar në grumbullimin e të riciklueshmeve si në këtë aktivitet.

A.2.4 Pyetësor për nxënësit dhe prindërit e tyre

Pyetësori për nxënësit dhe prindërit e tyre në shkollat e synuara u shpërndanë nga java e fundit e Majit 2016. Megjithatë, dy nga pesë shkollat e synuara patën vështirësi në mbajtjen e pyetësorit në mes të detyrave konfuze e kaotike të fundvitit dhe nuk mundëm të mbledhnim

përgjigje të vlefshme nga prindërit dhe në një prej tyre nuk mundëm të mblidhnim as përgjigjet e vlefshme nga nxënësit.

Bazuar në rezultatin e përmbledhur nga përgjigjet e vlefshme të nxënësve të grumbulluara nga 4 shkolla, nxënësit e njohin grumbullimin e ndarë të riciklueshmeve në shkollat e tyre më shumë se 80% në secilën shkollë (Q3. a: “E di (aktivitetin) shumë mirë dhe unë i ndjek rregullat”), por përqindja e nxënësve të cilët kuptojnë saktë tre llojet e të riciklueshmeve të synuara (Q.4) është vetëm rreth 20%. Kjo do të thotë se ka konfuzion mbi rregullat, ndoshta të shkaktuara nga diferenca e llojit të mbetjeve të riciklueshme që zbrazen nëpër shkolla në masë (letër, plastika të tilla si qese të lehta dhe të tjera). Mundësia e riciklimit të mbetjeve të tilla do të kërkohet në mënyrë të vazhdueshme.

Nivelet e të kuptuarit në lidhje me destinacionin e mbetjeve të riciklueshme të mbledhura ndryshojnë ndërmjet shkollave (Q8. b) është e saktë). Kur krahasojmë këtë rezultat me vëzhgimet e deritanishme, shkollat me normën më të lartë të përgjigjeve të sakta për këtë pyetje duket se ndajnë të riciklueshmet e synuara në mënyrë të saktë.

Në anën tjetër, në pyetësin e prindërve, prindërit u dukën të ishin mbështetës për aktivitetin e riciklimit në përgjithësi, dhe në disa raste është gjetur se prindërit udhëzojnë fëmijët e tyre për të ndarë të riciklueshmet e synuar edhe në shtëpinë e tyre. Prindërit gjithashtu kishin pritshmëri relativisht të lartë për zbatimin e të njëjtës veprimtari në komunitetin e tyre, por kërkesa e tyre për riciklimin e plastikës të cilat nuk janë të synuara në shkolla, u duk të ishte e lartë. Rreth 70% e tyre ranë dakord për të shfrytëzuar shkollat si bazë për aktivitetin e riciklimit të komunitetit.

Pyetësi dhe rezultatet e tij tregohen në faqet e mëposhtme.

a Pyetësor për Nxënësit



Projekti Mbështetje për Minimizimin e Mbetjeve dhe Promovimin 3R
në Republikën e Shqipërisë
Aktiviteti i Riciklimit në Shkollat e Laprakës, Bashkia Tiranë



PYETËSORI I NXËNËSVE

Emri i shkollës: _____

Klasa: _____

Ju lutem përgjigjuni secilës pyetje duke vendosur (✓) në përgjigjen e përshtatshme.

Q.1. 3R përfshin shkronjat e para të fjalëve që fillojnë me "R". A e dini cilin rregull të marrim parasysh në praktikë?

- ____ a. ① Redukto, ② Ripërdor, ③ Riciklo
____ b. ① Riciklo, ② Ripërdor, ③ Redukto
____ c. ① Ripërdor, ② Riciklo, ③ Redukto

Q.2. Cfarë materialesh "të riciklueshme" prodhoni më shumë në shkollën tuaj?

- ____ a. Shishe PET
____ b. Qese Plastike
____ c. Shishe Suko apo Bitter
____ d. Letër
____ e. Kanoçe Alumini

Q.3. A e dini se shkolla juaj po kryen ndarjen e materialit të riciklueshëm? (Përzgjidh vetëm një nga përgjigjet më të përshtatshme.)

- ____ a. Po, e di shumë mirë dhe do të ndjek rregullat.
____ b. Po, e di njëkohësisht di edhe rregullat, por i ndjek ato ndonjëherë.
____ c. Po, e di njëkohësisht di edhe rregullat, por nuk i ndjek ato asnjëherë.
____ d. Jo, nuk e dija.

Q.4. A e dini se cili nga materialet e mëposhtme ndahen për tu ricikluar në shkollën tuaj? Zgjidh gjithë të mundshmet.

- ____ a. Shishe PET
____ b. Qese plastike
____ c. Shishe Suko apo Bitter
____ d. Letër
____ e. Kanoçe alumini

Q.5. Cfarë mendoni mbi rregullat e ndarjes? (Shënoni gjithë përgjigjet e mundshme.)

- ____ a. Rregullat janë shumë të ndërlikuara.
____ b. Rregullat nuk janë praktikë.
____ c. Nuk i di rregullat.
____ d. Janë të lehtë për tu ndjekur.
____ e. Tjetër: (Lutem përshkruani: _____)

Q.6. Çfarë mendoni mbi aktivitetin e ndarjes? ☐ a. Ja vlen të vazhdohet siç është. ☐ b. Ja vlen të vazhdohet por në një mënyrë tjetër. ☐ c. Nuk e kuptoj pse duhet bërë. Q.7. Çfarë aspekti të grumbullimit të ndarë të materialit të riciklueshëm e gjeni me kuptim? ☐ a. Pakëson sasinë e mbetjeve në shkollë. ☐ b. Ndihmon pastrimin e mjedisit të shkollës tonë. ☐ c. Ndihmon pakësimin e konsumimit të burimeve natyrore në botë. ☐ d. Na siguron disa të ardhura për një projekt të shkollës. ☐ e. Më ndihmon të pakësoj sasinë e mbetjeve të zbrazura nga shtëpia ime. Q.8. A e dini se çfarë ndodh me materialin e riciklueshëm që grumbullohet në shkollën tuaj? ☐ a. Zbrazen kur vjen kamioni i grumbullimit të mbetjeve. ☐ b. Shiten te një grumbullues për riciklim. ☐ c. Zbrazen në kontejnerët jashtë shkollës, nga ku i marrin ricikluesit. ☐ d. Nuk e kam idenë çfarë ndodh me to. Q.9. Në cilën lëndë flisni mbi "riciklimin" më së shumti në klasë? ☐ a. Biologji ☐ b. Edukatë Qytetare ☐ c. Dituri Natyre ☐ d. Tjetër (Lutem specifiko: _____) Q.10. A diskutoni me familjen (vëllezër, motra, prindër, gjyshër apo çdo pjesëtar tjetër që jeton me ju) mbi ndarjen e materialit të riciklueshëm në shkollën tuaj? ☐ a. Po, flas me familjarët e mi shumë shpesh. → Ju lutemi vazhdoni tek Q.11 ☐ b. Po, kam folur një apo dy herë. → Ju lutemi vazhdoni tek Q.11. ☐ c. Jo, nuk kam folur me familjarët e mi. → Ju lutemi vazhdoni tek Q.13. Q.11. Cilat ishin reagimet e anëtarëve të familjes tuaj kur i folët mbi aktivitetin e ndarjes së mbetjeve në shkollë? ☐ a. Ishin shumë të interesuar dhe donin të dinin më shumë. → Ju lutemi vazhdoni tek Q.12 ☐ b. Ishin të interesuar por nuk diskutuan më shumë. → Ju lutemi vazhdoni tek Q.13 ☐ c. Nuk janë të interesuar. → Ju lutemi vazhdoni tek Q.13

Q.12. Ju lutem përshkruani më specifikisht mbi çfarë janë të interesuar familjarët e tu,

→ Ju lutem vazhdoni tek Q.13.

Q.13. A jeni të kujdesshëm ku ti zbrazni këto materiale të riciklueshme që prodhoni jashtë shkollës?

- ☐ a. Po, jam i kujdesshëm dhe përpiqem ti sjell në shkollë për riciklim.
- ☐ b. Po, jam i kujdesshëm, por nuk e di ku ti zbraz ato.
- ☐ c. Jo, nuk e vras mendjen.

Faleminderit shumë për bashkëpunimin tuaj.

Ndani *në burim* dhe ricikloni!!

b Rezultati i Vëzhgimit me Nxënësit

Q.1

Shkolla	a	b	c	(N/A)	Totali (Nr. i Nxënësve)
28 Nëntori	36.5	51.5	5.8	6.2	100.0 (274)
Aleks Buda	50.3	30.5	17.8	1.5	100.0 (197)
Ahmet Gashi	40.2	46.4	11.3	2.1	100.0 (97)
Gjergj Fishta	7.3	89.9	1.7	1.1	100.0 (179)
Totali	33.6	54.5	8.7	3.2	100.0 (747)

Q.2

Shkolla	a	b	c	d	e	Totali (Nr. i Nxënësve)
28 Nëntori	26.9	15.6	20.1	41.9	35.1	(353)
Aleks Buda	31.5	19.3	13.2	55.3	68.0	(197)
Ahmet Gashi	20.6	28.0	19.4	34.3	22.3	(175)
Gjergj Fishta	33.2	10.8	22.4	43.0	41.3	(223)
Totali	28.2	17.5	19.1	43.6	41.0	(948)

Q.3

Shkolla	a	b	c	d	(N/A)	Totali (Nr. i Nxënësve)
28 Nëntori	78.8	15.7	1.8	2.6	1.1	100.0 (274)
Aleks Buda	79.2	14.7	3.0	2.0	1.0	100.0 (197)
Ahmet Gashi	93.8	4.1	1.0	1.0	0.0	100.0 (97)
Gjergj Fishta	85.5	8.9	3.9	0.6	1.1	100.0 (179)
Totali	82.5	12.3	2.5	1.7	0.9	100.0 (747)

Q.4

Shkolla	Gabim	Saktë	Totali (Nr. i Nxënësve)
28 Nëntori	78.5	21.5	100.0 (274)
Aleks Buda	81.2	18.8	100.0 (197)
Ahmet Gashi	74.2	25.8	100.0 (97)
Gjergj Fishta	45.3	54.7	100.0 (179)
Totali	70.7	29.3	100.0 (747)

Q.5

Shkolla	a	b	c	d	e	(N/A)	Totali (Nr. i Nxënësve)
28 Nëntori	4.4	1.5	3.6	86.1	1.5	2.9	100.0 (274)
Aleks Buda	4.1	1.5	3.6	87.3	2.5	1.0	100.0 (197)
Ahmet Gashi	14.4	5.2	2.1	75.3	3.1	0.0	100.0 (97)
Gjergj Fishta	6.1	3.9	1.1	83.2	2.2	3.4	100.0 (179)
Totali	6.0	2.5	2.8	84.3	2.1	2.1	100.0 (747)

Q.6

Shkolla	a	b	c	(N/A)	Totali (Nr. i Nxënësve)
28 Nëntori	87.2	9.1	1.8	1.8	100.0 (274)
Aleks Buda	90.9	4.6	3.6	1.0	100.0 (197)
Ahmet Gashi	88.7	8.2	0.0	3.1	100.0 (97)
Gjergj Fishta	91.1	6.7	2.2	0.0	100.0 (179)
Totali	89.3	7.2	2.1	1.3	100.0 (747)

Q.7

Shkolla	a	b	c	d	e	Totali (Nr. Nxënësve)
28 Nëntori	31.0	66.4	6.9	9.1	1.8	(274)
Aleks Buda	23.9	71.1	10.2	23.9	1.0	(197)
Ahmet Gashi	40.2	42.3	13.4	34.0	3.1	(97)
Gjergj Fishta	16.2	39.7	9.5	59.8	1.1	(179)
Totali	26.8	58.1	9.2	28.4	1.6	(747)

Q.8

Shkolla	a	b	c	d	(N/A)	Totali (Nr. Nxënësve)
28 Nëntori	14.6	32.1	31.0	17.9	4.4	100.0 (274)
Aleks Buda	5.6	61.4	11.2	19.3	2.5	100.0 (197)
Ahmet Gashi	17.5	43.3	11.3	20.6	7.2	100.0 (97)
Gjergj Fishta	4.5	79.3	10.1	4.5	1.7	100.0 (179)
Totali	10.2	52.6	18.2	15.4	3.6	100.0 (747)

Q.9

Shkolla	a	b	c	d	(N/A)	Totali (Nr. Nxënësve)
28 Nëntori	32.5	32.8	24.8	5.5	4.4	100.0 (274)
Aleks Buda	37.1	32.5	7.6	20.8	2.0	100.0 (197)
Ahmet Gashi	50.5	25.8	14.4	5.2	4.1	100.0 (97)
Gjergj Fishta	60.9	3.9	27.4	6.7	1.1	100.0 (179)
Totali	42.8	24.9	19.5	9.8	2.9	100.0 (747)

Q.10

Shkolla	a	b	c	(N/A)	Totali (Nr. Nxënësve)
28 Nëntori	55.1	31.8	10.6	2.6	100.0 (274)
Aleks Buda	37.6	40.6	20.3	1.5	100.0 (197)
Ahmet Gashi	50.5	40.2	4.1	5.2	100.0 (97)
Gjergj Fishta	50.3	40.8	7.3	1.7	100.0 (179)
Totali	48.7	37.3	11.5	2.4	100.0 (747)

Q.11

Shkolla	a	b	c	(N/A)	Totali (Nr. Nxënësve)
28 Nëntori	53.6	35.4	2.9	8.0	100.0 (274)
Aleks Buda	34.0	45.7	6.6	13.7	100.0 (197)
Ahmet Gashi	56.7	35.1	3.1	5.2	100.0 (97)
Gjergj Fishta	44.1	45.8	5.6	4.5	100.0 (179)
Totali	46.6	40.6	4.6	8.3	100.0 (747)

Q.13

Shkolla	a	b	c	(N/A)	Totali (Nr. Nxënësve)
28 Nëntori	76.6	13.1	7.3	2.9	100.0 (274)
Aleks Buda	70.1	18.3	9.1	2.5	100.0 (197)
Ahmet Gashi	85.6	10.3	2.1	2.1	100.0 (97)
Gjergj Fishta	87.2	6.1	3.4	3.4	100.0 (179)
Totali	78.6	12.4	6.2	2.8	100.0 (747)

c Pyetësor për Prindërit

	Projekti Mbështetje për Minimizimin e Mbetjeve dhe Promovimin e 3R-ve në Republikën e Shqipërisë Aktiviteti i Riciklimit në Shkollat e Laprakës, Bashkia Tiranë	
PYETËSOR PËR PRINDËRIT Shkolla _____ Klasa e fëmijës tuaj _____		
Ju lutemi përgjigjuni pyetjeve duke i shënuar me (✓).		
Q.1. A e dini se shkolla e fëmijës juaj po realizon ndarjen e materialit të riciklueshëm? _____ a. Po. _____ b. Jo. → Ju lutem vazhdoni te Q. 3		
Q.2. Si u informuat mbi aktivitetin e riciklimit në shkollë? _____ a. Më tregoi rreth tij fëmija im. _____ b. Nga mësuesi i fëmijës tim. _____ c. E dëgjova nga prindërit e tjerë.		
Q.3. Ndarja e materialit të riciklueshëm po zhvillohet si një provë për të pakësuar sasinë e mbetjeve që zbrazet në kontejnerët bashkiak dhe më pas transportohet në Landfill. A keni diskutuar ndonjëherë me fëmijën tuaj mbi pakësimin e mbetjeve? _____ a. Po, madje dhe me herët se të fillonte aktiviteti në shkollë. _____ b. Po, pasi filloi aktiviteti i ndarjes në shkollë, ne kemi folur për të. _____ c. Jo, ne nuk kemi folur kurrë për të.		
